

Faruk Begolli was born on January 25, 1944 in the town of Peja, Kosovo.

He received a Bachelor's Degree in Acting from the School of Drama in Belgrade, Serbia. He has appeared in over seventy movies and television series of varying genres making him one of the most famous actors in the former Yugoslavia.

Faruk Begolli is responsible for creating Acting as a major in the Department of Dramatic Arts in the School of Arts in Prishtina, Kosovo.

He has held the position of director of the "Dodona" Theater in Prishtina for almost ten years where he produced over twenty plays. In addition, Faruk Begolli has also headed The Society of Film Actors of the former Yugoslavia and The Society of Theater Actors in the region of Kosovo.

He has received awards and recognition from both the former Yugoslavia and the region of Kosovo for his work in the dramatic arts. Faruk Begolli was Acting Professor in the School of Acting at the University of Prishtina.

Faruk Begolli is now, without a doubt, one of the most emblematic figures of Kosovar film and theater.

Faruk Begolli died in the age of 63, on August 23st 2007, in Prishtina.

Faruk Begolli u lind ne Pejë, më 25.01.1944.

Studimet për aktrim i kreu në Fakultetin e Dramës, në Beograd. Ka luajtur në mbi 70 filma e drama televizive, metrazhesh e zhanresh të ndryshëm, duke u bërë kështu njëri prej aktorëve më të popullarizuar në ish-Jugosllavi. Për një kohë ka drejtuar edhe Shoqatën e Artistëve të Filmit të ish-Jugosllavisë.

Për gati dhjetë vite ka qenë drejtor i Teatrit "Dodona" në Prishtinë, ku ka bërë regjinë e mbi 20 shfaqjeve teatrore.

Është themelues i Drejtimit të Aktrimit në kuadër të Degës së Arteve Dramatike, në Fakultetin e Arteve, në Prishtinë.

Për punën e tij si aktor është nderuar me mirënjohje të shumta, në kohën e ish-Jugosllavisë e, poashtu, ka marrë çmime e mirënjohje të ndryshme kombëtare.



Ka punuar si pedagog i lëndës së aktrimit në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës.

Ka qenë kryetar i Shoqatës së Krijuesve të Teatrit të Kosovës, por mbas një kohe të shkurtër, ka dhënë dorëheqje nga ky post.

Faruk Begolli tashmë është padyshim një prej figurave më emblematike të artit filmik dhe teatror kosovar.

Faruk Begolli ka vdekur në moshën 63 vjeçare, më 23 Gusht 2007, në Prishtinë.

FARUK BEGOULLI



Jeton Neziraj

Jeton Neziraj

FARUK BEGOLLI

inTegra

Prishtinë, Tetor 2013

AUTOR:

Jeton Neziraj

REDAKSIA:

Fadil Hysaj

Shkëlzen Maliqi

Melehate Qena

Armond Morina

Ekrem Kryeziu

DREJTOR EKZEKUTIV:

Kushtrim Koliqi

KOORDINATOR I PROJEKTIT:

Besart Sllamniku

LEKTOR:

Bekim Lumi

KORREKTOR:

Arian Krasniqi

DIZAJNI DHE FAQOSJA:

Buqë Osmani

SHTYPI:

KOHA Print

BOTUES:

Integra

BASHKËPUNËTORË:

Fatos Berisha

Ilir Bokshi

Liridon Cahani

Arzana Kraja

Njomza Luci

Fatmir Spahiu

Gresa Pallaska

Ilire Vinca

Edona Reshitaj

„Natyra jeme asht e tillë... Tash po m`pyesin: ‘A po mërzitesh që ke mbetë këtu, n`shpi...?’ E unë qe katërdhetë vjet kështu rroj; dal prej shpisë e shkoj n`Dodonë, atje e pi kafën, tallem... Shkoj masandej në kafe, i lexoj tana gazetën, rri me shokë, kthehem rishtas n`shpi, ha, lexoj a nuk lexoj, shoh filma... Vetmi nuk kam unë... As kuptimin e fjalës ‘vetmi’ nuk e di. Se nuk jam vetëm kurrë. Kështu që, unë jam përgatitë që 40 vjet për me ndejtë tash shtritë n`krevet... Edhe mos me m`kërcitë... Seriozisht...”

A handwritten signature in black ink on a light-colored background. The signature is written in a cursive, flowing style. It starts with a large, rounded 'B' followed by 'regull'. The final part of the signature is a long, sweeping stroke that ends in a small upward tick mark.



sh ah

Unë lëviz një gur të bardhë,
Ai lëviz një gur të zi.
Unë e vë në jetë një ëndërr,
Ai ma gllabëron me një luftë.
M'í sulmon egër mushkëritë,
Dhe plot një vit i dergjur n'spital
Mendohem për një kombinim të shkëlqyer,
Dhe arrij t'í fitoj një gur të zi.
Ai lëvizë një fatkeqësi
Dhe më kërcënon me kancer
(që duket si një kryq).
I vë përballë fytyrës një libër
Dhe e detyroj që të tërhiqet.
Arrij që t'í fitoj disa pjesë,
Por nga ky stërmundim i jashtëzakonshëm
Gjysma e jetës sime më doli jashtë përdorimit.
Do të të jap një shah, dhe do të humbasësh optimizmin
më tha ai me kërcënim.
S' dua t'í ia di fare, tallem unë,
Do të bëj rokadë me ndjenjat.

Pas kurrizit gruaja, fëmijët,
Dielli, hëna dhe të tjerët që ndjekin lojën,
Dridhen nga tmerrri sa herë që bëj një lëvizje shahu.

Ndez cigaren
Dhe vazhdoj lojën.

(Marin Soresku)

PERMBAJUTJA
PERMBAJUTJA
PERMBAJUTJA

PËRMBAJTJA

RRËFIMI I ARTISTIT TË MADH	10
DITËT E PLEQËRISË SË HERSHME	12
FËMIJËRIA	22
JETA N'BEOGRAD	34
SHIKIMI NË BEBËZËN E DIELLIT	44
PROFESORI	60
TEATRI	68
MBRET NË NJË MBRETËRI TË VOGËL-TEATRI "DODONA"	76
LUFTA	84
FRYMËZIM PËR ARTISTËT E RINJ	90
FILMOGRAFIA	92
BURIMET E LITERATURËS DHE INTERVISTAT	100

II
RRRÉEFIMM
IARTISTITIT
TE MADH





Janë disa njerëz për të cilët, kur lindin, kur krijojnë diçka, mënyra se si jetojnë, apo mënyra se si ndryshojnë diçka në hapësirën ku ndodhen, të duket fascinante, të duket si një lloj mrekullie e jashtëzakonshme. Artistët si Faruk Begolli janë të rrallë. Lindin rrallë. Dhe lindin me një mision në këtë botë. Njerëzimi gjen tek ata grimca nga fshehtësitë e jetës dhe botës, gjen pikëpyetjet për dilemat e kohës, zbulon traumat e popullit të ndrydhura diku thellë në të kaluarën e tij, zbulon të shkuarën dhe të ardhmen.

Ne, që kemi jetuar në këtë kohë me Faruk Begollin, duhet të kemi qenë vërtetë me fat. Të gjithë ne. Edhe ata që e kanë parë vetëm një film ku ka luajtur Begolli, ata që kanë jetuar në një qytet ku ka jetuar Begolli, ata që kanë lexuar në gazetë emrin e Begollit apo ata që e kanë takuar në rrugë dhe në kafene, ata që e kanë pasur profesor, ata që e kanë parë në skenë, në kinema apo në televizion, ata që e kanë parë duke vozitur makinën e tij, ata që kanë luajtur bashkë me të në film apo në teatër, të gjithë këta janë me fat.

Jeta dhe mënyra se si e ka jetuar jetën. Puna dhe mënyra se si ka punuar. Krijimi dhe mënyra se si ka krijuar. Janë të pazakonshme. Janë fascinuese.

Ky libër është një udhëtim i shkurtë nëpër jetën e Faruk Begollit si artist dhe si njeri. Një udhëtim që, në mënyrë të sqartë, rrokë peisazhet e një jete tragjike por edhe krenare. Imagjinoni një fëmijë të vogël që rritet fushave dhe arave të një fshati. Një fëmijë që jeton në një shtëpi i rrethuar me plot njerëz. Një fëmijë që mbas korrijeve del arave dhe mbledh kokrrat e mbetura të fasuleve për t'i shitur pastaj. Një fëmijë që, mbas disa viteve, aq mrekullisht, bëhet një yll filmi i adhuruar nga miliona e miliona njerëz.

Ky është rrëfimi i Faruk Begollit. Rrëfimi i artistit të madh.



DITËT E PLEQËRISË SË HERSHME

“

Kurrja nuk kam gabue për krejt atë që kam ba n'këtë jetë. Nuk më vjen aspak keq që nuk kam ba edhe ma shumë. Asgja nuk kam lanë mangut. Kam rrnue me kënaqësi. E tash, po pres. E çka po pres? Nuk po pres ma duertrokitje, as rezultate, as kritikë as... a? Po pres me pushue... Me ikë”.

Ditë vere. Planifikojmë të ikim diku jashtë Prishtinës dhe të ngujohemi në një kamp-shtëpizë. Përmenden Bjeshkët e Rugovës. Një javë ngujim. Ushqim dhe pije me vete, diktafonin dhe “muhabet” të shlrirë. Raki dhe meze, natyrisht. Këtë apo atë javë?

Një ditë tronditemi rrufeshëm nga lajmi se Faruk Begolli nuk po ndjehet mirë me shëndet. Shpresojmë se kjo do të kalojë shpejt dhe se plani për ta intervistuar do të realizohet, mu ashtu siç ishte menduar. Por, në ditët në vijim ecja e tij sikur po deformathej. Diçka “përbrenda” e ngacmonte.

“Ishiasi. E kam pasë edhe ma herët. Kështu e ka ky. M'lëshon për tokë. Herën e fundit m'pati dërmue”.

Bën vapë. Përmendet Ulqini.

“Po shkojmë n'Ulqin dhe atje e realizojmë intervistën. Hamë mish peshku edhe flasim”.

Pas disa ditësh, dikush duhej t'i ndihmonte për të ecur deri te kafeneja në qendër të qytetit, në këndin e tij të preferuar. “Po çuditëm se qysh munden njerëzit me ecë drejtë”, thoshte duke u tallë me ecjen e tij. Artistë të rinj dhe kolegë vinin radhazi, e rethonin tavolinën ku ishte i ulur ai. E pyesnin me droje për shëndetin e tij.

E ai tallej hapur me sëmundjen, e sfidonte atë me atë ironinë e tij të njohur. “Thellë e kam kësaj here”, thoshte. Madje, njëherë përmendi edhe kancerin. Të gjithë ne, që gjendeshim rreth tij, u stepëm.

“Publiku gjithmonë m’ka dashtë”

Shëndeti i tij tendosej. Duheshin bërë fotografime. Kontrolli i parë në Prishtinë doli alarmues dhe sugjeronte diçka të keqe. Në Shkup i bënë fotografime më të detajuara. “Filmi i zi” i rentgenit nxori në shesh qartë të zezën. Tronditje dhe pikëllim. Pëshpërimat e së keqes kaluan gojë më gojë, tek të gjithë. “A e dëgjove”? Rezultatet e atyre fotografimeve “vonohen” për Faruk Begollin. Vonohen shumë... Kush do të mund t’i tregonte se për çka ishte fjala? Ai priste edhe më tutje.

“Ta marr vesh çka po thonë fotografimet e, n`koftë kancer, po i grahi raki masandej”.

Fillon ta “planifikojë” ceremoninë e vet mortore. Kush do të lexojë poezi e kush do të mbajë fjalime. Njerëzit, që i rrinin pranë gjatë atyre ditëve, ndjeheshin në siklet nga humori i tij.

“Astrit, ti ke me e lexue letrën n`mbledhjen komemorative. Banu sa ma patetik, derdh lot, por mos u kthe me shikue kah fotografia jeme”.

Rezultatet e fotografimeve nuk kishin arritur ende. Gjendja i rëndohet.

“Zhag kam me shkue n`Ulqin. Atje kemi me e ba librin. Atje te Voja, pijmë raki, hamë peshk e flasim”.

Të gjithë ndjehemi të entuziazmuar me vullnetin dhe inkurajimin e tij, që puna rreth librit të mos ndalet. Begolli na tregon për një fletore me të dhëna e detaje nga e kaluara e tij, një fletore me shkrime nga gazetatat e hershme dhe foto të ruajtura dhe të koleksionuara nga ish-gruaja e tij, Zoja Begolli.

Alarmimet mjekësore dolën të sakta. Megjithatë, të gjithë shpresojmë dhe lutemi për të.

“M’kanë thanë se në internet e paskan gjetë që kam luejtë në rreth 70 filma. Këto të dhana mund te jepen në dy faqe. Pa pasë nevojë me e ngarkue librin me informata të thata. N’Ulqin mandej unë të tregoj barcoleta dhe histori që janë të lidhuna me xhirimet e filmave. Për shembull, me të tregue se, kur kam shkue për herë të parë në Festivalin e Filmit në Pulë, nuk kam ditë se si me i hangër ushqimet e detit. Peshk deri atëherë kisha pa vetëm në konserva. Ku e dijsa unë çka asht gaforrja e çka janë frutat e detit. Katundar i Baranit ma. E ata, kritikë e njerëz të filmit më thoshin: ‘Pse nuk po hani, zotni Faruk, hani!’. E unë, që në të vërtetë nuk dijsa se si duhet me i hangër ato ushqime, u thosha: ‘Nuk jam untë, nuk po m’hahet’. Eh, kësi lloj barcoletash kam me të tregue n’ Ulqin, e ti masandej i mbledhë edhe do tjera prej tjerëve dhe i kombinon. Ama, nëse ma sjellin fletoren prej Beogradi, atëhere e kam ma lehtë, sepse aty janë t’ shkrueme shumë detaje dhe ato kanë me m’ndihmue edhe mue e edhe ty. I thashë dje atij pronarit, që ia kam shitë banesën, me e nisë fletoren me postë. Besoj që ka me mbërri shpejt”.


Mbas një pritjeje të lodhshme për analizat nga Shkupi, që “nuk po vinin”, megjithatë vendosi të niset për në Ulqin. Në skenën verore të Ulqinit do të luhej edhe një prej komedive të tij. Në kufi, aktori Armond Morina, i cili po e voziste Begollin, kalon me “dredhi” rreshtin e gjatë të makinave. Deri tek kufiri malazias Armondit i kryente punë popullariteti, por jo më tutje. Para policëve kufitarë malazias, Begolli hapë ngadalë xhamin e dritares dhe zbulon fytyrën.

“Dobar dan, Gospodine Begolli...”, e përshëndesin policët që e po njihnin dhe mandej



nisin e ia kujtojnë filmat e tij të hershëm. I japin komplimente duke i thënë “nuk qenke plakur fare”. Pa dyshim, Begollit i bëhet qejfi. I pëlqen që shikuesit e mbajnë mend dhe ende e duan.

“Publiku gjithmonë m’ka dashtë”, thotë ai.



Rruga e gjatë me makinë deri në Ulqin e dërmon edhe më tepër, megjithëse nuk dorëzohet. Ulqini e pret i ngrysur. Valët e detit duken të acaruar. Nata e parë vërshohet nga një shi rrebesh që të kallë datën. Gjithçka duket e frikshme. Dhoma dhe hollit i hotelit bëhen vendet e vetme, ku Begolli mund të rrinte. Ecja i vështirësohet dhe ai tashmë mund të lëvizë vetëm duke u mbajtur për dikënd tjetër. Shkojmë dhe e vizitojmë radhazi në dhomën e hotelit. Ai rri i ngujuar aty dhe, vetëm herë pas here, zbret në hollin e hotelit, për të pirë kafe dhe për t’i lexuar gazetatat që ia sjellim. Pothuaj të gjithë njerëzit, që kalojnë andejpari, e njohin. E përshëndesin, kërkojnë të fotografohen me të.

Në Kalanë e Ulqinit, në njërin prej netëve të Festivalit Veror, shfaqet edhe njëra prej komedive të tij, të realizuara me studentë. Ia mësynë kalasë për të luajtur atje lart. Roli i tij në atë shfaqje është më tepër simbolik. Dy veta i ndihmojmë të ngjitet ngadalë gurëve të kalldrëmit që çojnë për te Kalaja. Ulet mes publikut të shumtë, i cili ka ardhur enkas për ta përcjellë shfaqjen. Njerëzit e shohin me admirim. Pas shfaqjes, përgjigjet në pyetjet e një gazetareje, e cila i kërkon mendimin rreth shfaqjes dhe rreth festivalit. Përgjigjet me një qartësi të jashtëzakonshme, duke mos dhënë asnjë shenjë lodhjeje ose dobësie. Fatkeqësisht, shëndeti i tij e pamundëson qëndrimin e mëtutjeshëm në Ulqin. Shtrëngohemi që të kthehemi në Prishtinë. As që bëhet fjalë për intervistën. Tregimi ynë po bëhej i ngjashëm me mitet antike, në të cilat njerëzit apo titanët ikin duke marrë me vete edhe pjesë të një sekreti të rëndësishëm.

Begolli tashmë zbret rrallë në qytet për kafe. As raki më nuk pi. “Rezultatet” nga klinika e Shkupit i “erdhën” vonë. Kërcënimit, që i vie nga kanceri, ai i përgjigjet me kërcënim edhe më të egër: “Le të vdes sa ma shpejtë”. I injoron kërkesat e mjekëve për terapi dhe për mjekim.

“Sa ma shpejt, aq ma mirë. Pshtim prej tij nuk ka, veç vonim”.

E kur të tjerët e përshëndesin me “mirupafshim”, ai ua kthen: “Shihemi n’Dragodan”, atje lart, në vendin ku ndodhen varrezat e Prishtinës.

Në vitin 2000, i pyetur nga një gazetë nëse ndonjëherë ka menduar për “pleqërinë e thellë”, Begolli qe përgjigjur se jo vetëm që nuk ka menduar, por as që dëshiron ta përjetojë pleqërinë e thellë.

“Thjesht, si të m’lëshon fuqia, dëshiroj me shkuje te Zoti, me dekë disi lehtë e bukur. Edhe me kaq jam i kënaqun me jetën teme, se realisht nuk kam pritë as kaq vjet jetë”.

Enver Petrovci konfirmon se Faruk Begolli nuk është frikësuar kurrë nga askush. Siç thotë ai, “Farukut kurrë nuk ia ka ndi për askënd dhe ai kurrë nuk asht frigue prej vdekjes”. Fadil Hysaj thotë që, në ballafaqim me sëmundjen, Faruk Begolli është triumfues.

“Është njeriu i vetëm që njoh, që me aq burrëri ballafaqohet me një mister, që është



“Thjesht, si
të më lëshoj
fuqia, dëshiroj
që të shkoj tek
Zoti, të vdes
disi lehtë e
bukur. Edhe
me kaq jam i
kënaqur me
jetën time, se
realisht nuk
kam pritur
as kaq
vjet jetë”

thjesht njëloj frike metafizike para diçkaje që nuk e njohim, që nuk e dimë. Në këtë rol ai është madhështor. Për mua këtu Faruk Begolli është triumfues. Mënyra se si e ka ‘pranuar’ sëmundjen e tij, mënyra se si komunikon me atë humor të hollë, pa asnjë ndryshim në timbër të zërit, është fascinuese”.

Herën e parë, kur e vizitua në shtëpinë e motrës së tij, ku edhe po qëndron, nuk e lajmëruam se po shkonim. Ne shumë mirë e dinim se, nëse do ta kishim pyetur, vështirë se do të na pranonte. Te dera na shikoi për disa sekonda ne heshtje, me një vështrim tejet qortues, por nuk foli. Në fakt, ne prisnim gjithçka, madje edhe të na përzinte, ashtu siç një ditë më parë e kishte përzënë një ish-studente të tij. Sapo ajo ishte shfaqur te pragu i derës, ky ia kishte bërë me dorë, si shenjë që të largohej. Të kota kishin qenë lutjet e saj. E kishte përzënë dhe pikë. Neve nuk na tha gjë në fillim, mandej pak më vonë nisi të na shajë që nuk e kishim thirrë, që ta pyesnim paraprakisht për vizitën. Minutat ecnin, ndërkohë që atmosfera nisi të relaksohej. Nuk po vendoste dot të vinte me ne për kafe. Po vij, tha njëherë, por pastaj, kur bëmë të niseshim, si me arrogancë, na u drejtua: “Hej, ecni more ju. Ta shoh ma vonë a po vij a jo. Nëse po, ju kallxoj”.

Daljet e tij nga shtëpia u rralluan gjithnjë e më tepër. E, prej sa kohësh, ai më nuk mund të dalë fare. I sfiduar nga dhimbjet dhe nga presioni i miqve, e sidomos i shokëve të studimeve, detyrohet të përfillë rekomandimet e mjekëve. Nisë të marrë kimioterapinë...

“Në fillim unë u dorëzova. Thashë ‘nuk po due me u marrë ma me këtë punë’, tu mendue që shkon kollaj. Po, dhimbke, dhimbke... E tash, shoqnia... Kanë marrë vesh këta t’Beogradit. Se unë nuk kam dashtë me ju tregue kurrë. Edhe, kështu, kanë marrë vesh e mbasandej krejt u lajmëruen. Prej klasës teme, t’vitet t’parë, shtatë veta me kancer. Prej Izraelit u lajmëruen një shoqe. Te tanë u mundojshin me m’bindë n’telefon: ‘Duhesh me ba qeta, duhesh me marrë ketë ilaç...’ Edhe më bindën. E tash m’thirrin rregullisht. M’bindën për këtë mut, kimioterapinë. Se kjo me t’shnosh nuk t’shnosh, po ta stopon pak, dhimbtë nuk ke. Ta ban këtë copë jetë ma kualitet. Veç ke me pritë. Por, të paktën kur po rri me ju, po rri e po kënaqem, po i lexoj gazetatat. Se unë nja një muej nuk jam çue hiç prej krevetit. S’kisha apetit, s’kisha kurrë hiç. Kesh dorëzue. Po s’vijke deka kurrqysh..

E, kjo asht veç vonim po... Qe, për momentin çohem, krejt i baj, rri, kur po m’dhemb, po marr do hapa, qeso... E, tash po zajbatem, po çohem e po eci, masandej po krenohem: ‘Eh, sot i kam ba tre hapa n’dhomë. M’asht kthye apetiti. Nji ditë due me ua lagë këtyne ‘anmiqve’. Po, due me u veshë, nuk e di a me i veshë pixhamat e portokallta a nji palë tjera, me e qitë nji krevet t’madh, si n’ato shfaqjet alternative. Edhe me dalë n’qytet, që njerëzit me thanë: ‘Kuku, nanën bre ia... S’po des ky mut”.

E vizitojmë kohë mbas kohe. E motra e tij, Aslihaja është kujdesur për të tërë këto vitet e fundit. Ajo, tash kur ai është i sëmurë, i rri pranë dhe kujdeset për të me shumë dashuri. Ajo pret vizitorët e rrallë, të cilët Begolli i pranon në dhomën e tij dhe u shërben me lëng ose kafe. Gjatë tërë kësaj kohe, Begolli ka pranuar shumë pak vizitorë.

Dhoma ku është i shtrirë është mjaft e terrshme. Përballë shtratit të madh është një televizor, të cilin ai gati vazhdimisht e mban ndezur.

Përfundimisht, vendosi të bashkëpunojë dhe të flasë. Ngadalë nis e rikthen memorien dhe përtyp kohën e kaluar, jetën e shkuar prej një artisti. Një herë dhe një kohë ishte



njëri prej yjeve kryesorë të kinematografisë në ish-Jugosllavi. Yll i adhuruar nga dhjetëra miliona njerëz në krejt ish-Jugosllavinë. Ishte ky, aktori sharmant, fama e të cilit vazhdoi të rrezatonte edhe te gjeneratat e mëvonshme. Nga shtrati, ku është i shtrirë, i cili, siç thotë ai, “i ngjan xhunglës”, Begolli për herë të parë shpalos të plotë jetën e vet. Një “makinë” e vogël te kryet ia regjistron fjalët, heshtjen, klithjet dhe frymëmarrjen.

“Tash po folim na, mbasi unë po des. A dojmë me e ba librin ‘deri sa ka qenë gjallë’ a si? Tash libri po bahet. Unë kam me dekë e ti henez e kryen. Janë dy mundësi: ‘Na e kemi ba deri sa ka qenë gjallë... Nuk kemi folë për këtë punë... ose, ia kemi nisë gjallë, e jemi ardhë tuj dekë... edhe ka dekë’. Këto janë shumë të randësishme. Mendo”.

Artisti dhe Njeriu. Faruk Begolli, ose “Çara”, si e kanë quajtur miqtë dhe shokët e tij. Artist i famshëm. Heroi ynë nga filmat e dikurshëm. Bandilli dhe partizani, për të cilin derdheshin lot kur e “vrisnin”, zakonisht në fund të filmit.

Një jetë prej artisti dhe bohemi. Artist, i cili jetën dhe filmin e ka marrë si lojë, si lojë të bukur, prej të cilës duhet të nxirret vetëm kënaqësi.

Orson Wells thotë se, janë disa njerëz që, thjesht, duket se kamera i do. Padyshim, një nga këta njerëz është Faruk Begolli.

Ka luajtur në rreth shtatëdhjetë filma artistikë metrazhesh të ndryshme dhe në dhjetëra shfaqje teatri. Revistat e atëhershme të ish-Jugosllavisë mbushnin ballinat me portretin e tij, e shpallnin mashkulli më i bukur në ish-Jugosllavi, i thurnin lavde dhe e ngjisin në qiell punën e tij si aktor. Publiku e adhuronte dhe vajzat e bukura “vdisnin” ta takonin. Brenda një dite merrte nga adhuruesit, siç thotë ai, “një thes me letra”. Në qytete të ndryshme krijoheshin klube të adhuruesve të filmave të tij.

Edhe sot, kur ka kaluar të 60-at, në fytyrë i është ruajtur i njëjti sharm i rinisë. Shtatëgjatë, kocka të zhvilluara dhe trup të drejtë pishë.



Orson Wells thotë se janë disa njerëz që, thjesht, duket se kamera i do.

Përmbi ballë i dallgëzojnë, si një mal i rrallë argjendi, flokët e tij të buta. Por, vitet, megjithatë, ngadalë ia kanë gllabëruar një pjesë të vogël të këtyre flokëve pa ia humbur shkëlqimin e sharmit të tij.

Sy nostalgjikë, gjithmonë të kthjellët e shkëlqyes. Vështrimi i tij plot kërshtëri, si një goditje thike, të shtangë, të “çarmatosë” plotësisht. Vështirë se mund ta gënjesht derisa të shikon në sy. Duket se e gjithë forca krijuese e këtij njeriu bashkohet në një pikë - sytë e tij. Ata sy janë arma e tij, si flokët e Samsonit.

Megjithatë, imazhi për ata që nuk e kanë takuar asnjëherë në afërsi, thyhet në çastin e parë. Arroganca e pritur, egërsia e imagjinuar në një takim të këtitillë, zbehet shpejt. Përpara dalin tjerë sy, tjetër buzëqeshje, tjetër ngjyrë e zërit. Shfaqet ai, Faruk Begolli, i vërteti.

Aktorja Melehate Qena thotë se Faruk Begolli edhe në jetë është sjellë sikur “Beg”, me madhështi. Dhe, sipas saj, mu kjo sjellje e tij ua ka krijuar përshtypjen të tjerëve se ai është “i paprekshëm”

“Ai, përkundrazi, është aq i brishtë, aq i pastër. Ndoshta kurrë në jetë nuk kam hasur njeri tjetër me këso virtyte. Dhe, nëse e njeh më mirë, e kupton që ai këto virtyte nuk i luan, por ato janë pjesë e jetës dhe e karakterit të tij, është natyra e tij”.


Kujtesa e Begollit është ende e freskët. Ai, me një forcë të çuditshme zhbiruese, kthehet lehtëzi në të kaluarën e tij, të cilën duket se e ruajtur si një mumie të paprekur në memorien e tij. Asgjë nuk ka humbur, asnjë detaj.

Faruk Begolli, njeriu i cili në vitet ‘70 – ‘80 konsiderohet të ketë pasur famë po aq sa Josip Broz Tito, sot në Kosovë konsiderohet si një prej figurave më emblematike të artit kosovar. Karriera e tij e bujshme prej artisti, kryesisht në filma, puna e jashtëzakonshme me studentë, i kanë dhënë atij me të drejtë reputacionin e një “institucioni më vete”. Aktor, profesor dhe drejtor i Teatrit “Dodona”.

“Nuk mundem me e nda punën në Dodonë, punën si profesor dhe punën si artist. Te tana këto kanë vlerë për mue. Se, krejt këto punë e plotësojnë njana – tjetrën”.

Begolli thotë të ketë pasur një princip në jetë, që punën e nisur ta çojë deri në fund. Prandaj, procesi, dhe sidomos fundi i tij, i ka sjellë atij kënaqësi të veçantë.

“Krejt çka kam ba, unë e kam ba pa mendue, pa naj plan paraprak. Edhe, krejt jeta jeme asht qashtu, pa plan. E kam ditë një parim n’jetë, e ai asht: filloja punës, e masandej e sheh se kah e çka. Dhe: me u krye puna. Pa marrë parasysh sakrificën, pa marrë parasysh rrethanat, puna me u krye. S’ka lidhje rezultati, s’ka lidhje kritika: puna me u krye. E, mundësisht, me u krye me kënaqësi”.



JETA PREJ BOHEMI

Një automobil i vjetër i markës së dikurshme jugosllave „Jugo“, me dyer që nuk i mbyllën dhe frena që duhesh me i shtypë fort për me pasë efekt. Me cigare “Drina” të Nishit, që pos tij rrallë se i pi njeri tjetër në Kosovë, me një gotë raki afër vetes, kur ulet në kafenetë e preferuara të tij, me gazetatat që i shfleton çdo ditë. Ky është Faruk Begolli. Është njeri, siç thotë, “kryesisht optimist”. Hidhërohet shpejt, por edhe shpejt i kalon.

Kur fillon të pijë Begolli, thonë disa miq të tij, duhesh me e pasë kohën e botës në dispozicion. Atij nuk i bëhet vonë, pos që qejfin ta çojë deri në fund; deri sa të soset krejt shishja e rakisë.

“Unë s`muj me thanë që kam afinitet me shkue n`galeri, por muj me thanë që kam afinitet me shkue n`kafe. Aty e ndiej veten mirë. Në galeri me shkue, isha shetitë pak, isha lodhë, kisha kqyrë piktura. Interessant. E në kafe, i di sendet, aty jam ekspert”.


Tavolina ku ulet për të pirë Begolli zakonisht është e rrethuar me njerëz tjerë, studentë apo kolegë të Begollit. Enver Petrovci thotë që Begolli është njeri që kurrë nuk i ka ruajtur paratë dhe se gjithmonë u ka paguar studentëve. Sipas tij, Begolli gjithmonë ka lënë përshtypje se ka shumë para. Fadil Hysaj mendon se Faruk Begolli është bohem, i cili ndjehet mirë me njerëz të tjerë rreth tij.

“Në atë tavolinë ku është Faruk Begolli askush nuk mund ta fusë dorën në xhep. Ai nuk lejon me pague dikush kur është ai aty. Se ai është Mbret i tavolinës. Ky ka qenë princip i tij jetësor. Ti je mysafir në tavolinën e tij. Ky është stili i jetës së tij, prej një bohemi, i cili ndjehet mirë me njerëz rreth tij. Begolli vërtetë është bohem”

Një pjesë e frymëzimit për shfaqjet Begollit i vjen në kohën kur sytë i janë zvogëluar nga rakia. Por, ngaqë e di mirë se dita e nesërme do t`ia fshijë edhe mendimet e ardhura gjatë dehjes, ai, zakonisht, gjen diku një copë letre dhe shkruan idetë (si skica) për shfaqjet, skenat, karakteret, apo gjëra të tjera që kanë të bëjnë me studentët. Kështu, në një copë gazete mund të gjesh fjali të “çoroditura” si “... me e ba një shfaqje: mashkujt flasin për femna e femnat për mashkuj... dhe me...”

“Kur punoj, edhe n`film e edhe n`teatër, madje edhe mësim kur jap, kur mbetem dikun, kur ngelem dhe nuk shoh zgjidhje, unë shkoj e pihem, vetëm. Bash pihem. E atëhere truni m`punon fantazi. Seriozisht. Edhe shumë ide m`dalin gjatë pijes. Edhe zakonisht i shkruiej, nëpër fleta, gazeta, se masandej t`nesërmen i harroj”.

Begolli, ka pasur një jetë intensive, sado që në vitet e fundit itinerari i tij ditor ka qenë zakonisht i njëjtë: shtëpi-Dodonë- fakultet- kafene-shtëpi. Këtë jete aktive, ku janë bashkuar puna e tij si artist dhe kënaqësia mbas pijeve dhe ndejave të gjata, Begolli e konsideron si çelës të suksesit të tij.



“Jam kanë
i pasun, por
kurrë nuk
kam mendue
n’pasuni”.

“Unë mendoj që, po të mos kisha jetue kështu si kam jetue, pra një jetë aktive me shokë dhe shoqe, unë nuk kisha mbërrë kurrë. Bash pse kam pi raki, bash pse kam ndejtë me shumë njerëz të profileve të ndryshme, pra mu kjo jetë, ta quejm boheme, m’ka begatue, mos me mbetë një ‘punëtor i dicipilnuem’. Po, bash ajo shoqni, bash ajo raki ma ka pasunue imagjinatën dhe m’ka motivue. Pra, pa atë pjesë të jetës sigurisht këtë pjesën tjetër si artist e kisha pasë shumë ma të vobektë, ose ndoshta nuk kish ekzistue fare. Pra, të dy pjesët e mia janë komplementare, e plotësojnë njana-tjetrën”.

Si artist filmi, Begolli dikur paguhej shumë mirë. Por, ai asnjëherë nuk ka menduar të kursente “para”, të ndërtonte shtëpi, të kishte banesë, ose së paku ta blinte një automobil të ri. Stili i tij i jetesës ka qenë dhe mbetet “sot për sot”. Krejt mjetet e fituara i ka shpenzuar me shokët dhe miqtë e tij. Në të vërtetë, siç thotë vetë ai: “Jam kanë i pasun, por kurrë nuk kam mendue n’pasuni”.

“Unë hala mendoj që jam i pasun. Krejt çka kam pasë i kam harxhue për dëshirat e mia. T’kisha dashtë me u pasunue, sot kisha pasë edhe shpi, edhe... Kisha pasë në bankë të holla. Se gjithmonë e kam marrë edhe filmin si lojë, edhe jetën si lojë; je këtu dhe shfrytëzoje. Pra, materialist nuk kam qenë asnjëherë dhe kurrë nuk kam mendue n’këto gjana. Por, asht fakt që kam fitue shumë dhe që kam pasë shumë, por asht fakt që tash nuk kam kurrë. Pra, t’kisha mendue n’atë drejtim, me u pasunue, tash me siguri e kisha pasë atë pasuni. Krejt çka kam ba e kam ba me kënaqësi edhe për kënaqësi”.

Edhe sot Begolli e ruan të plotë sensin për humor. Nga shtrati, në të cilin rri shtrirë, ai “lazdrohet” dhe kërkon respekt.

“Ju duhet me m’durue, se unë jam njeri i smutë, tuj dekë. Duheni me m’lazdrue, me ma ba rrafsh, me m’dashtë”.

Këto fjalë të thëna me humor, megjithatë fshehin një të vërtetë, atë që Begolli e kishte thënë në një intervistë në radio, në vitin 2004, në gjashtëdhjetë vjetorin e lindjes. Asnjëri prej institucioneve kosovare nuk qe interesuar t’ia uroj këtë përvjetor jubilar. Begolli, i emocionuar, por jo i pezmatuar, do të shpjegoj:

“Përderisa njerëzit janë gjallë, shoqnia jonë nuk u jep t’paktën një shpresë apo një konfirmim se ata janë gjallë dhe se për këtë vend kanë ba diçka. E, kur të vdesish, krejt televizionet, radiot, teatrot, institucionet kulturore dhe ato shtetnore, t’lavdojnë, por jo ma gjatë se një apo dy ditë. Kjo ngjan kur dikush vdes, ndërsa për së gjalli, nuk e di se pse, por nuk ju duen hiç, madje as nuk ju inkurajojnë për me qëndrue dhe me vazhdu e me punue edhe ma tutje”.

FËMIJËRIA

“

Ska ma bukur se kur vjen te bunari dhe pin prej kofes. Dielli t'përvëlon e uji asht i ftoftë... Qaq je i eçtuem... Pin edhe t'rrjedhë pak qafës... Si n'film, që thonë... Nëse pin tambël, atëherë duhet me të rrjedhë pak, ashtu që me u pa që po pin tambël... Shpirtin e kisha dhanë për me pi njëherë qashtu ujë n'bunar.”


Rrallë mund të gjinden njerëz që, me aq pasion, flasin për fëmijërinë e tyre, ashtu siç flet Faruk Begolli. Ai fëmijërinë e konsideron si pjesën më të bukur të jetës së vet, edhe pse, asokohe, jeta nuk duket të jetë treguar aq miqësore me të dhe me familjen e tij.

Ngjarja makabre e vrasjes së babait të tij nga partizanët, për të si fëmijë nuk duket të ketë bërë ndonjë trysni të jashtëzakonshme. Të paktën jo në atë fëmijëri të hershme. Mungesën e babait do të mundohen t'ia kompensojnë e ëma dhe motrat, të cilat bënin çmos që ai të rritej dhe të zhvillohej ashtu siç duhet.

Nëse ka diçka për të cilën Faruk Begolli nuk “përton” të flasë, kjo është fëmijëria e tij. Nga dhoma ku rri i shtrirë, ai flet me ton shumë nostalgjik për kujtimet e fëmijërisë së tij, për të cilat thotë se “janë pjesa ma e bukur e jetës time”! I rënduar nga sëmundja dhe i lodhur nga ditët e mërzitshme, ai u rikthehet kujtimeve të fëmijërisë, te jeta e tij në katund.

“Hapësina... hapësina asht liria... Në Baran, kur dilja nga shtëpia, përpara meje shtriheshin fusha e ara të pafund...”

Kjo ndjenjë entuziazmi për hapësirën duket t'i jetë sforcuar sidomos në çastet e rënda të sëmundjes, kur dhoma dhe ajo atmosferë zagushie i sjellin mëzri të pafund; si njeriu i etur, që, në ëndrrat e tij, sheh kroje me ujë të ftohtë dhe





lumenj që derdhen duke gurgulluar maleve. Ai vërtet ndien etje për atë kohë dhe për atë jetë, tash kur jeta e tij është kthyer në jetë-dhomë. Prandaj, edhe kur e kishte kuptuar nga se po vuante, kishte dashur të vdiste, sepse, siç thotë, “asht ma mirë me vdekë me shijen e mirë të jetës”.



Faruk Begolli kishte vetëm gjashtë muaj kur komunistët ia kishin vrarë babën, beun e njohur Sefedin Begolli, i cili, gjatë viteve 1920-1940, ishte një çifligar me nam dhe, në pronësi të tij, përveç dhjetëra shtëpive, kishte edhe qindra hektarë tokë në rrethinat e qytetit të Pejës. Pas një martese të dështuar me një baroneshë vjeneze, në moshën 60 vjeçare, Sefedin Begu ishte martuar me Elmaze Pashën, një grua që vinte nga një familje autoritative. Gruaja e dytë e Sefedin Begut, e ëma e Faruk Begollit, ishte e bija e Jashar Pashës, mbesë e atdhetarit të njohur shqiptar, Haxhi Zeka. Me gruan e dytë, Elmazen, Sefedin Begu kishte lindur shtatë fëmijë, katër nga të cilët kishin jetuar. Elmazja ishte një besimtare e devotshme muslimane.

Në vitin 1943, mbas bombardimit të Pejës nga gjermanët, në atë periudhë frike dhe ankthi, Elmazja, me të katër fëmijët, vajzat Nevruzen, Aslihanë dhe djemtë, Farukun e Adilin, kishte ikur nga shtëpia në Pejë dhe ishte vendosur në Baran, një katund në periferi të Pejës, ku kishin një rën nga shtëpitë e tyre, në të cilën po jetonin çifçinjë. Shtëpinë në Baran do ta ndajnë së bashku me familjarët e plakut Avdyl Gashi dhe të djalit të tij, Tafës, i cili edhe ishte i zoti i shtëpisë. Me ta, në vitet e ardhshme, Begollët do të jenë si anëtarë të një familjeje të ngushtë.



Komunistët, mbas ngadhënjimit në luftë, kishin filluar një fushatë që, asokohe, njihej si “reforma agrare”, e cila kishte të bënte me kolektivizimin dhe kooperativizmin, përmes të cilave tokat dhe pasuritë e bejlerëve dhe të shumë të tjerëve merreshin dhe i jepeshin shtetit. Ndaj bejlerëve dhe të ashtuquajturës “aristokracisë së degjeneruar”, siç e quanin komunistët, konform asaj filozofisë së tyre politike, kishin zhvilluar një fushatë të egër dhe çnjëzore, që kishte rezultuar me vrasje, djegie shtëpish dhe uzurpime pronash të një shkalle të gjerë. Babai i Faruk Begollit, Sefedini, si bej, natyrisht ishte cak i kësaj fushate shkatërruese.

“6 muaj i kam pasë kur, nana ime, vëllau Adili, dy motrat dhe unë, kemi shkue prej Pejës në katund me u mshefë prej bombardimeve... E tash, lufta, 44-shi e na kemi mbetë në katund në “liri”... ku kan fillue nacionalizimet, konfiskimet, burgimet... Babën e nxajnë, e vrapjnë, nana jeme nëpër hetime, burgje, polici... A e din, asht histori... E unë, si fëmijë, nuk i kam ditë këto sende... Pra, një kohë shumë e randë, e përgjakshme, e për mu, si fëmijë, shumë e kandshme... Se e ke qat hapësinë, qat liri... hala je fëmijë...”

...nji kohë
shumë e randë,
e përgjakshme,
e për mu, si
fëmijë, shumë
e kandshme...

VDEKJA E BABAIT

Njohuritë e Faruk Begollit për vrasjen e babait të tij janë disa nga versionet që ai i kishte dëgjuar shumë më vonë nga të afërmit e tij.

Në vjeshtën e vitit 1944, Sefedin Begu, mbasi kishte ndjerë rrezikun mbas ngadhënjimit të komunistëve, ishte larguar dhe kishte gjetur strehim në një shtëpi në fshatin Lumbardh. I zoti i asaj shtëpie kishte hapur një tunel të vogël poshtë oxhakut të dhomës së zjarrit dhe aty e kishte strehuar beun. Oxhaku pastaj ishte mbuluar me një pllakë metali dhe mbi të ishte vënë zjarri, që ndizej për nevoja të familjes.

Prej Baranit, ku ishin të vendosur përkohësisht, e ëma e Faruk Begollit disa herë, nëpër terr, e kishte vizituar burrin e saj, që po strehohej në fshatin Lumbardh. Por, jo gjatë, këto vizita ishin hetuar nga disa njerëz, të cilët, për t'i ikur presionit ose për të nxjerrë ndonjë përfitim, i kishin lajmëruar komunistët për vendndodhjen e mundshme të Sefedin Begut.

Mbasi ishte zbuluar vendqëndrimi i beut, komunistët kishin rrethuar fshatin dhe, mandej, kishin nisur një fushatë dhune dhe torturash mbi katundarët, të cilët ishin nxjerrë jashtë shtëpive të tyre dhe ishin lënë pa ushqim dhe pa ujë. Sipas një versioni, Sefedin Begu kishte vlarë veten, duke pirë helmin. Ndërsa, një plakë sklerotike, që si duket e kishte kuptuar që Sefedin Begu më nuk ishte i gjallë, dhe duke dashur t'u ndihmojë fshatarëve që po torturoheshin, kishte folur dhe kishte pyet me zë "çka u ba me Begun" dhe mandej kishte vrapuar në dhomën ku ndodhej i fshehur beu dhe kishte hapur rrasën e metalit që mbulonte gropën ku fshihej ai. Ky është një prej versioneve, ndërkohë që versioni tjetër thotë se, në të vërtetë, komunistët e kanë gjetur Sefedin Begun dhe mandej e kanë vlarë. Mbasi e kishin nxjerrë nga hapësira nën oxhak, e kishin hipur në një kamionetë, e kishin ulur në një karrige dhe mandej e kishin lidhur me litar në karrige, ia kishin vënë një cigare në gojë dhe pastaj me kamionetë kishin shëtitur rrugës kryesore të Pejës, duke kërcitur me daulle e duke brohoritur: „E kemi zënë Sefedin Begun, armikun më të madh të popullit. Hajde, shiheni e binduni"! Shumë njerëz nga Peja, përfshirë edhe të afërm të familjes Begolli, që kishin dalë në rrugë, e kishin parë „armikun“, madje disa prej tyre ishin detyruar nga partizanët të pështynin mbi kufomën e beut, të cilën, më pas, partizanët e kishin zhdukur. As asokohe e as më vonë, familjarët nuk ia dolën kurrë ta gjejnë varrin e Sefedin Begut.

Fshatarët që kishin strehuar beun ishin burgosur dhe kishin vuajtur vite të tëra nëpër burgjet dhe kazamatet ish jugosllave. Disa syresh edhe kishin lënë jetën nëpër ato burgje.

Vrasja e Sefedin Begut ishte trumbetuar dhe proklamuar si vrasje e armikut të përbetuar të popullit. Njerëzit ishin detyruar të shkruajnë dhe këndojnë këngë kundër Jashar Pashës e Sefedin Begut... Një këngë e mëvonshme, që do të këndohet nëpër oda, e ndikuar nga fryma e fitores komuniste mbi "armiqtë", do të përfundojë me refrenin:

Jashar Pashën, Sefedin Begin
Krejt shqiptarët jau kanë pa sherrin

E kam fëmininë
ma të bukur...
Edhe veç qat
fëmini e kam
të bukur...
Edhe jetën e
mavonshme e
kam pasë të
mirë... Jetë të
mirë në çdo
kuptim... Po
ajo kurrë nuk
krahasohet me
fëmininë..."

Vrasja e beut ishte shoqëruar me djegien radhazi të shtëpive dhe kullave, që kishin qenë në pronësi të tij. Ishte djegur edhe shtëpia e Jashar Pashës, në rrugën e atëhershme "Omladinka" të Pejës, që, siç thuhet, ishte "një ndër shtëpitë më të bukura të Kosovës"! Ishte konfiskuar mandej edhe ndërtesa pesëkatëshe në Beograd, në rrugën "Dobrashina", një kat i të cilës ishte në pronësi të gruas së parë të Sefedin Begut.

Faruk Begolli thotë se më kurrë nuk kanë ngritur ndonjë padi lidhur me këto konfiskime, mbasi, siç pohon ai, nuk kanë dashur t'u shkaktojnë trauma pronarëve aktualë të atyre pronave.

Përpos në prona, llahtaria kishte kapluar edhe familjarë. Një ndër vëllezërit e Sefedin Begut, Sami Begu, duke e ditur që edhe atë mund ta priste i njëjti fat, ishte arratisur në malet e Rugovës dhe, bashkë me njerëz të tjerë, kishte krijuar një çetë të vogël kaçakësh, e cila do të luftonte kundër komunistëve... Sami Begu kishte ndenjur kaçak deri në vitin 1949, kur edhe ishte vrarë nga komunistët.

Vëllau më i vogël i Sefedin Begut, Gjergjizi, kishte shkuar të jetonte në Suboticë. Mbas shumë vitesh, ai tërë ngjarjet e familjes do t'ia tregojë Faruk Begollit, njeriut që, më vonë, do të bëhej një nga yjet më të famshëm të filmit e të televizionit në ish-Jugosllavi.

FËMIJËRIA NË BARAN

Nga tërë ajo pasuri që kishin pasur, familjes së beut i kishin lënë vetëm 5 hektarë tokë dhe një shtëpi të vjetër në Baran, në të cilën po jetonin gruaja dhe fëmijët e tij bashkë me familjen e Tafë Gashit. Shtëpia e vjetër kishte një oborr të madh, shumë pemë, bagëti e pula, ahurin dhe plehun në oborr. Prona dhe e tërë pasuria tashmë drejtohej nga Tafë Gashi. Çifligari dhe çifçiu jetonin bashkë dhe ndanin të mirat dhe të këqijat.

"Unë si fëmijë nuk kisha lidhje se kush ishte begu e kush çifçija... Jam rritë me ta si me njerëz të familjes... Edhe ata kanë vuajtur si ne... Sa burgun, sa pushkatimin... Por, krejt këto unë nuk i di, nuk i kam përjetue... E kam fëmininë ma të bukur... Edhe veç qat fëmini e kam të bukur... Edhe jetën e mavonshme e kam pasë të mirë... jetë të mirë në çdo kuptim... Po ajo kurrë nuk krahasohet me fëmininë..."

Fati i familjes së Sefedin Begollit, gruas dhe katër fëmijëve të tij, tashmë ishte pothuaj në duar të kryezotit të familjes Gashi, i cili kujdesej për ta si për pjesëtarët e tjerë të familjes së vet.

E ëma e Faruk Begollit, për një kohë të gjatë mbas atyre ngjarjeve tragjike, do të dërmohet duke u endur nga një stacion policie në tjetrin, nga një burg në tjetrin, nga një zyrë partie në tjetrën, në biseda informative, duke dhënë dëshmitë që ata ia kërkonin për burrin "armik."

Si fëmijë, Faruk Begolli do të rritet me përkëdhelitë e nënës, motrave, por edhe të gjyshes, gruas së Jashar Pashës.



“Del dhe sheh... Sytë i ke plot... Hapësinë...”

“Gjatë pushimeve në shkollë, ne shumë shpesh shkonim te gjyshja ime, e shoqja e Jashar Pashës, njerka e nanës time, të cilën e quaja “nana” dhe e cila i kishte 16 gusha në qafë. Po, ajo më donte aq shumë sa që unë nuk e shihja shëmtinë e saj. Ajo shpesh më merrte me vete në Pejë. Te gjyshja shpesh vinte edhe Istref Begolli me motrat e veta”.

Faruk Begolli kujton me aq pasion jetën si fëmijë në Baran. Jetën në katund ai e quan si një “mrekulli”. Shtëpia ku është rritur ai përpara ka pasur një kopsht të madh të mbushur me drunjë mollash e kumbullash. Pranvera i sillte atij dhe fëmijëve të tjerë frutat e këndshme, të cilat ata i thërmonin me brisqet e vogla, që si fëmijë i mbanin me vete.

“Katundi për fëmijët asht një mrekulli. Kur ia nisë pranvera, ke gjithçka me hangër; molla të egra, thana, do xhenerika... Ti, si fëmijë, e ke një brisk të vogël e me ta ia rregullon vetes frutat”.

Shtëpia ku jetonin Begollët ishte e madhe. Pranë ishte një jaz dhe një çeshme. Afër aty ishte edhe një lis i vjetër me degë të gjera e të dendura. Faruku dhe fëmijë të tjerë kacavirreshin si ketrat nëpër degët e këtij lisi dhe ndërtonin kasolle të vogla. Diku në oborr ishte edhe një gropë e madhe e krijuar nga rënia e një bombe gjatë luftës. Faruku, bashkë me fëmijë të tjerë, do të krijojë aty tunele e lloj- lloj labirinthesh prej dheu. Ndërkaq, verës me kungujt e arave ndërtonin “qerre”, të cilat i tërhiqnin nëpër oborr. Mbi oborr ka pasur edhe një shpat në të cilin dimrit, kur kishte borë, por edhe verës, fëmijët rrëshqitnin si në patinazh.

“Më kujtohet kur fëmijët më thoshin “qiti bythët në stom”, unë u ngjitsha nalt e mandej u lëshojsha teposhtë e i çkoqsha pantollat. Kur shkojsha n`shpi mandej nana më rrihte dhe tek mandej m`i harronte pantollat.”

Por e ëma e donte. E donte, pavarësisht se “nuk i zinte vendi vend”, e donte edhe më shumë ngase i ngjante të atit Sefedinit. Si fëmijë, Faruk Begolli kishte dëshirë të vishet si burrë. E ëma i kishte blerë tirqi e xhubletë dhe ai krenohej e lavdërohej para fëmijëve të tjerë. Vobektësia në të cilën po jetohej ishte e pahetueshme për Farukun fëmijë. Motrat dhe të gjithë njerëzit e tjerë për rreth kujdeseshin që ai të kishte të hante dhe të mos mbetej i uritur.

“Unë nuk a kam ndi varfninë e as problemet që i ka pasë familja ime në atë kohë. Motrat m`a kanë nda një kore të bukës së kollomoqit, „se çohet djali prej gjumit e nuk kemi cka me i dhanë...” Unë ato gjana në atë kohë nuk i kam dijtë. I kam kuptue ma vonë”!

Si fëmijë, “ladronte”, sic shprehet ai, gjithkrah dhe nuk i zinte vendi vend nga dëshira për të hulumtuar secilën skutë të kopshtit, arës a fushës, që rrethonte shtëpinë dhe fshatin ku jetonte ai.

“Në atë hapsinë të madhe unë ndihesha njeri shumë i lirë...”!

Kjo liri që i ka ofruar hapësina e fshatit dhe, përgjithësisht, vetë jeta në katund, do të mbetet pjesa më e bukur e jetës së Begollit, kujtimi më i mirë...

“Del dhe sheh... sytë i ke plot... hapësinë...”

Përpos për të ëmën dhe për motrat, Faruk Begolli flet me respekt edhe për “nanën Rukë”, nënën e axhës Tafë, e cila ishte baçicë e shtëpisë. Pas një vrapi të gjatë dhe lojës së lodhshme në oborr, nëna Rukë shpesh nxirrte nga bodrumi i shtëpisë një domate dhe një kore buke dhe ia jepte Farukut të lazduar, që siç thoshte e ëma e tij “si zinte vendi vend”!

Jeta dinamike në katund duket se ka qenë ideale për temperamentin e Faruk Begollit, i prirur gjithnjë nga e panjohura dhe nga „krijimi“ i gjërave që nuk kanë ekzistuar më parë. “Krijimi” përmes lojës. Të “jetuarit e jetës si lojë” dhe “aktrimi e krijimi artistik si lojë” do të mbeten si moto në jetën dhe krijimtarinë e mëvonshme të Begollit.

NË SHKOLLË

Tri klasët e para të shkollës fillore Faruk Begolli i kreu në Baran. Por, shkrimin dhe leximin ai e kishte mësuar më përpara, nga librat dhe fletoret e të vëllait, Adilit. Ai, nga kureshtja fëmijërore, ia mirrte fletoret të vëllait dhe përpiquej t'i zgjidhte detyrat, që mësuesit ia kishin dhënë si obligim t'i kryente në shtëpi. I vihej pas të vëllait dhe dëshironte të shkonte edhe ai në shkollë, edhe pse ende nuk e kishte moshën për shkollë. Askush nga të tjerët në shtëpi nuk guxonte të “conte dorë mbi sugarin”, përpos Adilit, i cili, natyrisht, e rrahte tinza të tjerëve. Adili, që ishte dy vjet më i madh se ai, e rrahte dhe nuk dëshironte ta merrte me vete. Prandaj, e ëma do ta lusë mësuesin që ta pranojë Farukun në klasë, sikur të ishte nxënës, në mënyrë që ta qetësonte Adilin e inatosur...

Faruk Begolli, për një vit të tërë, edhe pse nuk ishte nxënës i regjistruar, kishte ndjekur mësimet në klasën në të cilin ishte edhe Adili. Do të tregohet i zellshëm dhe një prej nxënësve më të mirë në klasë. Prandaj, si shpërblim për këtë përkushtim, mësuesi do ta kalojë në klasën e dytë, bashkë me të tjerët që ishin regjistruar në mënyrë të rregullt. Nëna e tij kishte kërkuar që ai vit të mos i pranohej, por, me insistimin e mësuesit, ai e kishte fituar vitin. Për suksesin e treguar i kishin dhënë një peshqir dhuratë. Në klasën e dytë ai do të hyjë si 6 vjeçar. Një pjesë të fletoreve dhe të mjeteve për shkollë ai i blinte nga shitja e kokrrave të fasules dhe kallamoqit, të cilat mbetnin në arë mbas korrjeve.

“Kur u ba kolektivizimi... korrshin bashkarisht, brigadierë e çka po dij unë... E çka mbetke poshtë mbas korrjeve, kokrra pasuli e kokrra kallamoqi, na fëmijët dilshim, i mbledhshim e masandej i çojshim në pazar e i shitshim. I bajshim për shembull dy kilogramë pasul... edhe blejshim diçka për shkollë... Asokohe, çokolata nuk ka pasë...”

Njëherë, mësuesi i tij, Idriz Hoxha, e kishte rrahur keq, pasi ai e kishte harruar fletoren e shkollës në hanxhik. Për këtë lëshim, mësuesi ia kishte dhënë 25 thupra, me thuprën që ai e kishte zgjedhur vet. Këto 25 thupra Faruk Begolli nuk do t'i harrojë kurrë. Por, pos këtyre thuprave, Faruk Begolli nuk do ta harrojë kurrë as dashuriçkën e parë nga klasa e tretë...

“Ia bajsha çantën asaj dhe kjo ishte një formë e të shprehurit të dashunisë. Ia bajsha çantën e bile bahesha xheloz kur ia merrke dikush tjetër me ia bajtë...”



Gjatë pushimeve të orëve dhe para fillimit të mësimit nxënësit luanin lojëra të ndryshme. Por, natyrisht, lojërat e preferuara ishin ato të inspiruara nga lufta e atëhershme me “partizanë e ballistë”. Dhe, natyrisht, popullariteti i partizanëve atëherë ishte në kulm dhe, padyshim, të gjithë fëmijët donin të ishin “partizanë”.

„Në shkollë luanim partizanë e ballista. Të gjithë donin të ishin partizanë e, mbasi unë isha ma i vogli, mua m’bajshin ballist“.

KTHIMI NË PEJË

Në vitin 1952, atëherë kur torturat e OZNA-s ndaj familjes Begolli kishin pushuar, ata kishin vendosur të ktheheshin sërish në Pejë. Por, tashmë, nuk e kishin shtëpinë që e kishin pasur dikur, prandaj ata banojnë si qiraxhinj dhe, për një kohë të gjatë, jetojnë në kushte të mjerueshme. Varfëria dhe mjerimi përjetohen edhe nga Faruku, i cili, tash e tutje, shkollën fillore e vazhdon në Pejë. Madje, mbasi zhvendosen nga Barani në Pejë, Faruk Begolli më asnjëherë nuk do të kthehet në katund për një kohë më të gjatë. E vetmja periudhë kur atë e gjejmë përsëri atje është koha mes pushimeve vjetore në shkollën e mesme. Kthimi në Baran do të mbetet si një ëndërr e tij e përhershme. Nga kjo ëndërr ai nuk u shkëput as kur e krijoi famën si artist. Përkundrazi, vazhdimisht shprehej se do të donte të kthehej atje dhe ta ndërtonte një shtëpizë me një kopsht të vogël.

„Unë, kur bana pare, u bana artist... E kam pasë, edhe hala e kam si dëshirë me e ba një shpi të vogël, në katund, me nja dy a tri lehë kepë, dicka që me pasë me cka me u marrë... Dhe atje me e kalue verën... Dy-tri pula qatÿ... Jo me shku në deti, por atje... E kam pasë hapësinën ku me e ba atë shpi... Po unë e di që kjo asht vetëm një iluzion, njilloj andre...“

Jeta në qytet Faruk Begollit do t’i sjellë pikëllim dhe shumë telashe. Ndjente pikëllim për shokët e katundit dhe për jetën atje. I mungonte shtëpia e madhe dhe oborri me mollë e kumbulla, i mungonin koret e bukës së nanës Rukë, gropa në kopsht, jazi, lisi i madh me kurorë dhe shumëçka tjetër...

Në Pejë gjallonin me të ardhurat që nxirrin nga ajo pak tokë që u kishte mbetur. Varfërinë dhe vuajtjet ua zbuste sadopak daja, Muharrem Pasha, i biri i Jashar Pashës. Në atë kohë vobektësie, ai përkujdesej për ta me aq sa mundte... Për ta në Pejë do të kujdesej edhe djali i tezes, Istref Begolli dhe dy motrat e tij. Istref Begolli më vonë do të bëhet një prej emrave më të fuqishëm të filmit dhe sidomos të teatrit në ish Jugosllavi. Ai do të jetë një prej shtysave kryesore që Faruk Begolli të nisë rrugëtimin e tij drejt artit të aktrimit...

“Kur je i dashunuem, gjithçka të duket e bukur...”

Bota magjike e fshatit përnjëherësh do të rrenohet për t'u zëvendësuar me një botë krejtësisht armiqësore dhe të ashpër. I ballafaquar me një rreth të ri njerëzish dhe me një mentalitet tjetër, Faruk Begolli do të ndihet i thyer dhe i përbuzur. Në shkollë ai do të ballafaqohet me goditjet e para dhe të tmerrshme. Thirrjet e mësuesve para fillimit të orëve: „Beglerët armiqtë tanë...” apo „Sefedin beu armiku ynë...”, do ta lëndojnë dhe bëjnë të struket brenda vetes... Edhe moshtarët e tij do ta injorojnë dhe përbuzin për një kohë të gjatë.

Mes zgënjimit e thyrjes përfundimtare dhe luftës për të qëndruar, ai zgjedh këtë të dytën. Vendosmëria e tij dhe inkurajimi i familjes, sidomos i nënës, bënë që ai të mposhtë vuajtjen dhe përbuzjen.

Mbas disa vitesh, telashet e tij do të hiqen. Ai do të rritet dhe zhvillohet, pas disa kohësh do të bëhet shumë i popullarizuar si portier i hendbollit.

Një djalë zgjatak me fytyrë të bukur, padyshim se do të ketë qenë atraktiv për çikat e reja të Pejës. Por, më shumë se sa ndodhitë e vërteta, ai dhe shokët do të kalojnë shumë mbrëmje duke folur për çika, secili duke trilluar rrëfime të jashtëzakonshme për “aventurat” me këtë apo atë çikë, që po cmendej pas tyre... Megjithatë, histori dashurish të ëmbla nga ajo kohë janë të paharrueshme për Begollin.

“Kur je i dashunuem, gjithçka të duket e bukur... Thue: o Zot, qysh e ka ba Zoti, e kisha hangër krejt... Seriozisht... E shoku yt e sheh e thotë: kuku, cka paske ba... Por për ty ajo asht ma e mira... M'kujtohet, kur ma pat ba: prej qetashtit unë ma nuk jam me ty, e sa ja kem pasë nisë me shkue bashkë. Pasha nderën, më kujtohet, më lëshuen kambët, edhe u zverdha, mos t'u mbajsha, rashë... M'la. Këtë kurrë nuk e harroj... M'lëshuen kambët... E kjo, nuk ishte dashnia e parë... Po unë jam kanë budallë, se gjithmonë secilën e kam pasë si të parën, secilën dashni e kam përjetue si të parën... Po nuk më kanë zgjatë shumë... Se e kam intenzitetin e naltë... Kur due, due... Por, nuk më zgjasin shumë... Vec janë intenzive... Shpesh, shumë shpesh, jam dashunue... Ani unë, artist... Tan kohën në terren... Dashunohesh, e nuk do me u nda... E unë nuk jam kanë ai që kam dashtë me u nda kurrë...”

STAFETA E TITOS DHE HENDBOLLI

Mbas një kohe, sukseset e tij në shkollë do të jenë të dukshme. Në klasën e VII-të, nga shkolla ku ai mësonte, ishte caktuar ta dorëzonte stafetën e Titos në sheshin e Pejës. Natyrisht, ky akt në atë kohë ishte një privilegj i jashtëzakonshëm për secilin fëmijë apo të rritur. Dhe, kjo ndërmarrje e shkollës nuk bëhej për të rehabilituar “të birin e armikut”, por thjesht vinte si ‘presion’ i suksesit dhe punës së jashtëzakonshme të Faruk Begollit si nxënës. Por, mbasi ai do ta dorëzonte stafetën, strukturat partiake fillojnë ta ‘tjerrin’ këtë veprim dhe gjejnë prapa tij qëllime “tendencioze” dhe të “dëmshme” për popullin. Si bëhet që “i biri i armikut” ta dorëzojë stafetën e Titos? Si rrjedhojë, mësuesi i klasës – kujdestari - largohet nga puna.

Në atë moshë të hershme, Faruk Begolli nisë të pasionohet mbas hendbollit. Ky pasion do ta ndjekë për vite me radhë. Ai, në moshën 14 vjeçare, do të jetë një lojtar (portier) i shkëlqyeshëm i ekipit të atëhershëm hendbollistik “Buduçnost”, që më vonë do të zërë

vendin e parë si ekipi më i mirë i Kosovës në ligën e dytë të Serbisë. Si portier ai ishte shumë i lëvizshëm dhe i pëlqente të mbronte sidomos kur kuptonte se në publik kishte edhe vajza të bukura, të cilat edhe në atë kohë e adhuronin.

“Kur shihnin që ka çika shumë në publik, bashkëlojtarët gëzoheshin dhe më thoshin se më gol s’kishte kush më jepte.”

Kur e regjistroi gjimnazin, ai tashmë ishte i popullarizuar në Pejë, si sportist por edhe si recitator i talentuar. Me poezinë “Kanga e rinisë” të Migjenit ai do ta bëjë publikun në sallë të brohorasë dhe duartrokasë me entuziazëm.

Më vonë, si portier hendbolli ai do të luajë edhe për ORK “Beograd”, ekip i cili ishte shumë afër të hynte në ligën e parë. Në këtë ekip do të arrijë të nxjerrë edhe ndonjë dinarë kohë mbas kohe. Në njërin nga lojë të vendimtare në stadiumin “Tashmajdan” të Beogradit, ku pritej hyrja në ligën e parë, portierit Faruk Begolli do t’i humbë “rruga në oborr” dhe do t’i mbushet porta me gola.

“...Isha portier i parë dhe disa herë ndërrohem me portierin e dytë, por, sa herë që hyja, ma mbushnin rrjetën me gola. Dhe ne u eliminuem nga ekipi i Zrenjaninit...”

Mbas këtij “dështimi” jo të qëllimshëm, Faruk Begolli vendosi të largohej nga ekipi “Beograd”. Meqë nuk mund të rrinte pa sport, bie në kontakt dhe mandej pranon të mbrojë për ekipin e atëhershëm hendbollistik “Borci” të Ferizajt. Në “Borc” njihet me mbrojtësin e njohur të asaj kohe, Sheqer Shllakun, i cili do t’i mësojë Faruk Begollit “truke” të reja të mbrojtjes. Përpos me Sheqerin, ai aty njihet edhe me lojtarë të tjerë, të cilët i bën shokë, ndër ta edhe: Sahit Sahiti, Bahri Sojeva e Fahri Buçinca.

Volejbolli asokohe ishte në kulmin e popullaritetit dhe entuziazmi për lojë të Begollit ishte i jashtëzakonshëm. Ai shpesh, për të ardhur në Ferizaj, do të falsifikojë biletat e trenit, apo do të udhëtojë tërë natën me trenat e ngadalshëm. Zakonisht, si shpërblim për lojë të merrte nga ekipi një drekë apo darkë të varfër.

Një ngjarje e pazakonshme nga ajo kohë e rinisë së hershme do t’i mbetet përgjithmonë në kujtesë. Me një grup shokësh ai vendos të ikë në Shqipëri, në vendin që atëherë e mendonin si parajsë. Mbase i bëjnë të gjitha planet, e caktojnë edhe ditën kur do të iknin nga Kosova. Megjithatë, mbas këtij vendimi, diçka nisë ta brejë brenda dhe ta kallë atë fillin e dyshimit për këtë veprim: çka do të bëhej me të? Ku do të mbetej nana? Në anën tjetër shokëve ua kishte dhënë fjalën dhe nuk dëshironte t’i binte ‘mohit premtimit. Mbas disa ditësh, kur ishte gjetë lidhja për të kaluar matanë kufirit që kontrollohej ashpër, dhe kur gjithçka ishte realizuar sipas planit, Faruk Begolli heq dorë dhe nuk del në pikëtakimin e caktuar më parë. Me netë të tëra nuk vjen në vete. I dhimbsen shokët dhe e bren ndërgjegjja që nuk ishte bashkuar me ta. Ndërkohë, shokët kishin pasur fat të ligë. Ata, të tradhtuar nga një bashkëvendës, ishin kapur në kufi nga një patrullë kufitare.

Vëllau i madh, Adili, kishte filluar studimet në Lubjanë, ndërkohë që Faruk Begoll, 17 vjeçar, matej të fillonte studime që nuk kërkonin shpenzime të mëdha, mbase fukarallëku



po i dërmonte, pavarësisht që, sic thotë ai, “isha bir begu e nip pashai”! Megjithatë, shpëtimi kishte ardhur nga një bursë, që asokohe jepeshin për nxënës të dalluar. Faruk Begolli kishte fituar një prej këtyre bursave, por me kushtin që të ndiqte studimet e xehetarisë. Pos bursës, favori tjetër ishte edhe më atraktiv për Faruk Begollin: nuk kishte provim pranues.

Dy ditë para se të vinte dita për t’u nisur në fakultet, e ëma dhe motrat i kishin gatuar gurabia e gatojca tjera të këndshme, në mënyrë që “rrugën e largimit” t’ia ëmbëlsonin sadopak.

Në momentin kur do të duhej të nisej, ishte përshëndetur me motrat, por kishte mbetur si i ngrirë kur i kishte zgjatë dorën nanë Elmazes. Nuk kishte mundur ta bëjë asnjë hap tutje.

„Isha i vetëdijshëm se kjo ka me qenë ndamja jonë definitive. Nuk munda të nisesha. Kurrë nuk ia kam pa lotin. As aty nuk qau. Vetëm më tha me za urdhnues: “Nisu! Nisu menjëherë!”

Faruk Begolli kishte mbledhë valixhet dhe mandej ishte nisur... Mbas hapave të parë, kishte qarë. Nuk po i vinte turp dhe as po i fshinte lotët. Në stacion të trenit kishte menduar të kthehej në shtëpi, por këtij tundimi i kishte bërë ballë. Kishte hipë në tren për në Beograd, por sërish me mendjen se do të hipte në trenin kthyes nga atje për në Pejë.

Në mëngjes, kur kishte arritur në stacionin e trenit në Beograd, ishte pritur nga shokët, që kishin nisur ta ngacmonin duke ia hapur valixhet dhe duke ia marrë gurabiat e gatojcat, që ia kishin dhënë me vete e ëma dhe motrat.

“Shokët e vërenin mërzinë time dhe më thoshin: hala je fëmijë”.



JETA N' BEOGRAD


“

Unë jam njeri që e do bukurinë e grues, jo sall bukurinë e jashtme, por edhe ata t'mbrendshmen, sepse ajo asht shumë e randësishme. Bukuria e grave më inspiron. Dhe, në këtë gjurmim inspirimi për t'bukurën e kam takue edhe gruen teme”.

Studimet për xehetari Begollin nuk e provokuan fare. Ai nuk ishte aspak i kënaqur me profesionin që e kishte zgjedhur. Madje, si rezultat i këtij mos-motivimi, ai e humbi vitin. Prandaj, edhe detyrohet të largohet nga Beogradi, meqë qëndrimin e tij të mëtutjeshëm dhe shpenzimet e kota atje s'kishte si t'i arsyetonte para familjes. Vendosi të kthehej përsëri në Pejë, ku mendonte të punonte si mësues në ndonjë shkollë fillore të kësaj ane. Por, për çudi, ky qëllim i tij nuk u realizua, sepse asnjë nga shkollat e kësaj ane nuk shprehu interesim dhe gatishmëri për ta pranuar si mësues. Ndërkohë, ai merr një vendim për të studiuar ekonominë në Prishtinë. Kështu, në vitin 1961 regjistron vitin e parë, të cilin e kryen me shumë sukses. Megjithatë, mbas një viti të kaluar në Beograd, e kishte shumë të vështirë të mësohej me Prishtinën. Dhe, rishtas, merr një tjetër vendim, të transferohet në Beograd dhe atje t'i vazhdojë studimet e filluara për ekonomi. Në Beograd vazhdon vitin e dytë të studimeve, ku, edhe përkundër disa telasheve të vogla, në pamje të parë dukej se gjithçka ishte vënë në binarë të duhur. Tashmë, të gjithë mendonin dhe ishin tejet të bindur se Faruk Begolli përfundimisht e kishte gjetur profesionin e tij të jetës. Megjithatë, ai ende nuk po ndjehej i kënaqur. Shumëçka nuk funksiononte. Prandaj, diçka duhej të ndërronte. Përnjëherësh u bë mospërfillës në ligjërata, me një fjalë s'kishte interesim për mësim. Ankohej, e as vetë nuk e dinte se përse po ankohej. Pas një kohe, ia mundësojnë të kthehet sërish në Prishtinë, në po të njëjtin fakultet, me një arsyetim formal se atje në Beograd nuk ia kishte dalë në studime shkaku i gjuhës. Pas kthimit në Prishtinë, sikur filloi një valë e re e punës dhe e suksesit për studentin e ri, Faruk Begolli. Por, sërish, entuziazmi dhe vullneti i tij rinor shuhet shpejt. Pasi përfundon vitin e dytë, kthehet në qytetin e tij të lindjes, në Pejë. Ishte koha e pushimeve verore dhe Begollit po i silleshin në krye shumë pikëpyetje e dilema. Askush, madje as ai vetë nuk e kishte të qartë se çfarë drejtimi po merrte jeta e tij. Dhe, pikërisht në atë kohë, në njërën prej atyre ditëve verore, takon kushëririn e tij, Istref Begollin, të cilit nis e i rrëfëhet (duke iu ankuar) për „vuajtjet“ dhe pakënaqësitë e tij për studimet në drejtimin e ekonomisë. Asokohe, Istref Begolli,

ndoshta edhe duke njohur natyrën e tij, gati si aksidentalisht i propozon që t'i regjistrojë studimet për aktor në Akademinë e Arteve, në Beograd. Diçka lëvizi, sikur një fije shprese u ndez. Begolli po mendonte për skenën e teatrit, për kamerën e filmin. Kush do ta kishte thënë: Faruk Begolli, aktor?

Gjatë atyre ditëve ai takon edhe Ekrem Kryeziu, i cili, poashtu, mbas studimeve të papërfunduara për drejtësi, kish vendosur të studionte Dramaturgjinë atje në Beograd. Ekrem Kryeziu e motivon edhe më shumë Begollin për të provuar regjistrimin e studimeve për aktor. Begolli vendosi të konkurrojë, me gjithë frikën se nuk do t'ia dilte në provim pranues, e veçmas pasi e kishte kuptuar se pjesë e provimit pranues ishte edhe një hartim me shkrim. Megjithatë, ishte Ekrem Kryeziu ai që më së shumti e inkurajonte, duke i premtuar se ai vetë do t'ia shkruante „pjesën me shkrim“.




Në Beograd, afër vendit ku mbahej provimi pranues ishin mbledhur afro 1000 të rinj, të cilët ia kishin mësyre aktrimit, regjisë dhe dramaturgjisë. Begolli „ftohet“ edhe më tepër, i humb pothuaj të gjitha shpresat. Nuk e mendonte dot se nga ajo turmë ai do të mund të hynte në mesin e 12 më të mirëve. Megjithatë, siç shprehet edhe Begolli, „kur ta don, ta don, kur nuk ta don, nuk ta don“. Nga gjithësejt 1000 konkurrentë, ai futet në rrethin e atyre që kishin të drejtë të hynin në provim pranues. Ishte në mesin e 500 kandidatëve që po aplikonin.

Në provim pranues, Ekrem Kryeziu ia shkruan hartimin me shkrim, ndërkohë që Begolli „shtrëngon“ veten dhe shfaq talentin në pikat tjera të provimit pranues. Deklamon një poezi të poetit boshnjak, Izet Sarajliq. Ballafaqimi me profesorët në komision e çarmatosëtërisht dhe e bën të ndjehet i emocionuar. Dukej se gjithçka po shkonte për së mbari. Turma sa vinte e zvogëlohej dhe Begolli kishte kaluar dy rrahë të provimit pranues, duke u kualifikuar në mesin e 34 kandidatëve. Pa fije dyshimi, kjo ishte edhe sfida e fundit e tij, të cilën duhej medoemos ta kalonte. Ishte kjo pengesa e fundit në maratonën e gjatë dhe ai mund të bëhej student i aktrimit. Kjo do ta ndryshonte krejt rrjedhën e jetës së tij. I kishte vetëm një javë kohë për t'u përgatitur. Për provimin final zgjodhi dhe përgatiti në serbisht poezinë e Majakovskit „Retë në pantallona“, si dhe në gjuhën shqipe një monolog nga drama, „Nuk martohem me pare“. Provimi pranues - pjesa e fundit vulosi përgjithmonë fatin e tij si aktor. Komisioni dha



vlerësimin përfundimtar për 12 kandidatët e pranuar, midis të cilëve figuronte edhe emri Faruk Begolli. Jeta e tij ndryshoi shumë mbas këtij provimi pranues. Atij iu hapën dyert e një bote tjetër, të panjohur më parë.



Fillon vitin e parë të studimeve në vitin akademik 1963/1964, në klasën e Minja Dediqit, me kolegët e tjerë si: Svetlana Bojkoviq, Petro Bozhoviq, Branko Miliçeviq, Josif Tatiq, Lane Gotoviq, Gjurgje Svetiq etj. Begolli e nis klasën me një gjeneratë, por e përfundon me një tjetër. Në vitin e parë të studimeve, Begolli bën një përpjekje të jashtëzakonshme, përvetëson dhe perfeksionon diksionin e gjuhës serbe. Fakultetin, të tretin me radhë, e fillon me më tepër zell dhe me bindje të plotë se ky do të jetë zanati i tij i ardhshëm.



Begolli, edhe pse student i aktrimit, vazhdonte të luante ende hendboll për "Borcin" e Ferizajt. Nga Beogradi udhëtonte shpesh drejt Ferizajt për të mbrojtur në ndeshjet e ekipit të tij. Kjo ishte koha e fundit, kur ai përfundimisht duhej të zgjidhte midis hendbollit dhe aktrimit. Këtë ia kishte bërë të qartë edhe profesori i klasës së tij, Minja Dediq, duke i kërkuar të zgjedhë mes aktrimit dhe hendbollit, ngase, sipas tij, angazhimi i dyfishtë do t'i paraqiste probleme. Natyrisht, Begolli përfundimisht u përcaktua për aktrimin, sado që lidhjen e tij me sportin nuk e shkëputi kurrë. Ai, edhe sot e kësaj dite, vazhdon të jetë një "fans" i madh i sportit, e posaçërisht i futbollit. Asokohe, një gazetë, mes tjerash, shkruante: "Kur është në pyetje futbolla, Faruk Begolli i harron të gjitha". Interesimin për futbollin realisht nuk e humbi asnjëherë, as tash në kohën e pleqërisë. Periudhat e kampionateve botërore në futboll janë periudhat kur Begollin zor se mund ta gjesh jashtë shtëpisë. Gjatë kampionateve, asgjë s'paraqet më shumë rëndësi për Begollin se sa futbolla.

Me shokët e shkollës së mesme Begolli takohet edhe sot. Ai vazhdon ta ruajë shoqërinë me ta. Midis tyre, Begolli përmend Skënder Boshnjakun, Jusuf Gacaferrin, Skënder Rodotinën, Ali Berishën etj. Ndërkaq, gjatë studimeve për aktor në Beograd, ai njihet me dy shokë tjerë të rinj, të cilët do të mbesin miqtë dhe shokët e tij të përhershëm. Ishin ata, Josif Tatiq - Tale apo Jataganac, siç e quan ndryshe Begolli, dhe Laslo Shvirlitli - Laci, të dy këta aktorë nga klasa e Begollit.



„Une shoqinë e kam formue tek kur e kam regjistruar Fakultetin e Arteve n'Beograd. Filluem me fakultet, njani i Novi Sadit, unë i Pejës, tjetri i Zrenjaninit, e kolegët tjerë t'klasës ishin prej Beogradit. Dhe, dashtë e pa dashtë, ata t'Beogradit, mbasi kryhej orari i mësimit, shkonin nëpër shpia t'veta, e tana herat mbetshim vetun na të tre. E, kaniherë, vetë rrethanat ta imponojnë me fillue me u shoqnue me njerëz t'caktuem. Na, të tre, filluem me e ba një jetë ma intenzive. Ishim edhe ka 20 orë bashkë... Shpesh banonim bashkë. Krejt çka bënim e bënim bashkë. U bëmë të pandashëm, ashtu siç jemi edhe sot. Jataganac është akoma aktor, kurse Laci asht mjek i njohun. Unë n'profesion, edhe pse tash ma nuk e di, a jam profesor, a jam aktor? Atëherë, sigurisht që të tre na kemi dashtë me kanë veç aktorë. Kjo shoqni e jona asht qysh prej viteve t'60-ta, pra janë ma shumë se 45 vjet n'pyetje. Ndoshtë që ti me shokët nuk shihesh 2 vjet, por ata prapë mbesin shokët e tu. Nëse ke kriza, ata i thirrë, nëse t'nevojitet diçka, ose edhe nëse ke festë, atyne u lajmërohesh. Se shoqnia nuk mvaret prej takimeve t'përditshme, po shoqinë e ke n'zëmër dikun. S'paku e din që e ki një njeri, edhe ai t'ka ty“.



Mbas pak vitesh, kur tashmë veç kishte hyrë plotësisht në botën e filmit, Begolli bëhet një prej aktorëve më të popullarizuar në ish-Jugosllavi. Enver Petrovici thotë se në atë kohë nuk ka pasur njeri që nuk e ka njohur Faruk Begollin dhe se në Kosovë të gjithë janë krenuar me të.



Një pjesë të mirë të kohës Begolli e kalonte në Klubin e Shkrimtarëve të Jugosllavisë, një restorant ku rrinin, ndër të tjera, njerëzit e filmit dhe ku bëheshin bisedat rreth kontratave, ndaheshin rolet etj. Ekrem Kryeziu, i cili në atë kohë banonte me të në Qytetin e Studentëve, tregon se si ka pasur telashe që ta zgjonte Begollin herët në mëngjes.

„Ne jetonim bashkë në Qytetin e Studentëve dhe nuk ka pasë natë që Faruku të kthehej para orës dy apo tre të pasmesnatës. Kur kishte xhirime të filmave, unë e kisha për obligim ta zgjoja herët në mëngjes. E lidhsha shtratin e tij me njëfarë lloj spangoje dhe e luhatsha prej distance. E zgjoja prej distance, sepse, nëse ishte afër tij, ai gjuante shkëlma e grushta, se nuk kishte qejf të zgjohej“.

Aktori i ri, Faruk Begolli, shumë shpejt u bë i adhuruari i shumë vajzave të reja gjithandej nëpër Jugosllavi. Aktorja Melehate Qena tregon ta ketë njohur Begollin në Beograd, në vitin 1967, në kohën kur ajo sapo kishte nisur studimet për aktore. Sipas saj, Begolli ishte i famshëm ngaqë veç kishte xhiruar katër apo pesë filma dhe se gratë „vraponin“ pas tij.



„Begollin e kanë ndjekë gratë e bukura gjithmonë. Shumë femra kanë vrapue mbas tij. Dhe besoni që ka qenë andërr për secilën femër. Ai gjithmonë ka qenë gjentil e i kujdesshëm... Begolli ka pasë shumë femra. Kjo asht e sigurtë. Mendoj që Begolli e ka pasë dhe e ka jetën e vështirë. Sepse asht vështirë të jesh i “zgjedhur”. Atij kurrë nuk i kanë lanë hapësinë që ai të zgjedhë. Jo, gratë e kanë zgjedhë gjithmonë atë... Begolli dallon prej Don Zhuanit, sepse Don Zhuanit i ka ndjekë gratë, kurse Begolli nuk i ka ndjekë, por e kanë ndjekë ato...“.

Begolli i famshëm ngarendte nga një shesh xhirimi në tjetrin, ndërsa kohën e paktë të lirë, kur nuk xhironte filma, e kalonte duke bërë qejf kafeve me meze, raki dhe duhan, që do ta përcjellin pandashëm gjithmonë. Begolli, siç edhe pajtohen shumica e kolegëve dhe njerëzve që e kanë njohur nga ajo kohë, kishte telashe me vajzat e reja, të cilat i binin në gjunjë dhe ai vështirë i hiqte qafe.

“Sa i përket femrave, unë nuk kam vrapue mas tyne, përkundrazi, shpesh m’asht dashtë me ju thanë, n’mënyrën ma t’kulturueme, ‘nuk po mundem’. Kjo ‘nuk po mundem’ ashtë kanë pjesë e jetës, kënaqësisë, bukurisë... Tjetër asht dashunia, por n’rastet tjera jam mundue gjithmonë me kanë fer, me u sjell si gjentëlmen, mos me i ofendue femnat. Kam pasë probleme prej femrave. Ato m’thoshin: pse ti nuk po m’don, pse ti kështu, pse ashtu... E unë kam ba sa kam mujtë“.

Por, gratë kanë qenë realisht publiku më i flaktë i filmave të tij. Çdo herë, në rastet kur për vlerën e ndonjë filmi të tij ka votuar publiku- gra, Begolli gjithnjë ka fituar.

Enver Petrovci thotë se Faruk Begolli i ka dashtë femrat dhe se shumicën e herëve atij nuk i ka bërë përshtypje mosha apo pamja fizike e femrave. Sipas tij, ai i ka dashtë të gjitha dhe ka qenë shumë gjentil me to.



“Jam i lumtun me at’ dashuni, jam i lumtun që e kam pasë at’ grue. I jam falenderue që ma ka ofrue at’ dashuni t’mrekullueshme, ...”

Fadil Hysaj thotë se Begolli, asokohe, ka qenë si një lloj “seks simboli”, i adhuruar, sidomos nga femrat, të cilat, siç thotë ai, “e kishin ëndërr”. Sipas Hysajt, shumë të rinj të asaj kohe ëndërronin të kishin një karrierë të ngjashme si të Begollit.

Faruk Begolli martohet me Zoja Gjokoviqin, një grua serbe e shkëlqyer, për të cilën ai flet me shumë respekt. Për të me shumë respekt flasin edhe kolegët e Begollit. “Ka pasur një grua shumë të mirë, shumë të këndshme”, thotë Enver Petrovci. Regjisori Ekrem Kryeziu e quan “grua të mrekullueshme”. Kryeziu nuk kursehet fare me komplimentet për Zoja Begollin: “Zoja ka qenë shumë më e mirë se Faruku. Emri i saj është Zojë, por ajo vërtetë ka qenë zonjë në kuptimin e plotë të fjalës”.

Zoja, që ishte balerinë profesionale në teatrin “Narodno Pozoriste” të Beogradit, më vonë do ta marrë mbiemrin e burrit – Begolli. Gjatë krejt atyre viteve martesë, ajo ishte, siç thotë vetë Begolli, “shtylla e shpisë”. Megjithatë, mbas 17 vjetësh martesë, Begolli ndahet nga ajo. Zoja vazhdon ta mbajë sot e kësaj dite mbiemrin Begolli, padyshim, nga respekti për ish-bashkëshortin e saj.

„N’këto vitet e fundit nuk flas ma për dashuninë, sepse ka ekzistue një dashuni e vërtetë dhe, si rezultat i saj, edhe një martesë. Jemi kanë 17 vjet bashkë. Ajo e ka mbajtur mbiemrin tem. Por, kur mbaron, mbaron, fatkeqësisht. Kena mbetet shokë. Ndigjohemi n’telefon kohë mbas kohe. Ma së shpeshti jena ndigjue gjatë luftës. Por, mbasi kuptuem që të dy jena mirë, edhe unë e edhe ajo, filluem me u ndigjue rrallë e ma rrallë. Jam i lumtun me at’ dashuni, jam i lumtun që e kam pasë at’ grue. I jam falenderue që ma ka ofrue at’ dashuni t’mrekullueshme, at’ martesë, at’ shoqni dhe at’ copë jete t’mrekullueshme”.

NJË HISTORI MEDIALE


Shumë njerëz, edhe sot e kujtojnë një histori mediale në lidhje me Faruk Begollin. Në vitin 1982, një deklaratë e tij do të shkaktonte zemërimin e shumë njerëzve në Kosovë. Në një emision televiziv, që i kushtohej demonstratave të studentëve shqiptarë të vitit 1981, Begolli, i intervistuar në një kontekst tjetër, deklaroi publikisht se i pëlqente Beogradi dhe se më mirë



e ndjente veten në Beograd. Kjo deklaratë e tij, e perceptuar ndryshe nga ç'ishte menduar, krijoi një zemërim të paparë tek njerëzit në Kosovë. Shumë nga ta filluan të shihnin tek ai „tradhtarin e atdheut“. Kjo deklaratë, me preferenca aq të zakonshme njerëzore, në rrethana të atëhershme politike, u keqkuptua dhe u keqinterpretua skajshmërisht.

Në lidhje me këtë deklaratë të tij, mbas disa vitesh, i pyetur nga një gazetë kosovare, ai shpjegon shumë qartë tërë atë histori dhe prapavijën e saj:

“Kurrë nuk jam marrë me politikë, e as që kam ndonjë ambicie të tillë. Atë që e kam thënë me atë rast, nuk e mohoj. E kam thënë se në Beograd kam kaluar pjesën më të madhe të jetës. Kam kujtimet e mia, kujtimet e mira, pavarësisht qëndrimeve denigruese të politikanëve të atjeshëm ndaj shqiptarëve. Kur e kam pranuar ofertën e Televizionit të Beogradit, nuk më është thënë qëllimi i atij emisioni. Më është thënë të flisja për mënyrën se si jam afirmuar në Beograd dhe ç'ndjeja unë për Beogradin. Nuk kam pasur haber se me çfarë prapavije politike e kishin planifikuar ata emisionin. Ajo deklaratë imja mandej është montuar dhe është “sakatuar”. Sikur të ishte dhënë e plotë, do të duartrokitesha, por ndodhi ashtu siç ndodhi dhe...”



“Kurrë nuk kam ikë nga rranjtë e mia, por nuk kam mendue se kjo asht gjaja ma e randësishme e jetës teme”

Regjisori Ekrem Kryeziu thotë të ketë qenë i lënduar mbas asaj deklaratë të Faruk Begollit:

„Nuk më kujtohet saktë, mund edhe të gaboj, por ajo që më ka lënduar, e që i ka lënduar të gjithë njerëzit rreth tij, është se ai ka thënë se e ndjen veten në Beograd si në shtëpi të veten dhe se kur i afrohet Beogradit e përjeton se po kthehet në vendlindje. Mund të gaboj, por kështu diçka ka qenë. Ndosh-ta ne kemi qenë të irituar nga Beogradi së tepërmi dhe çdo fjalë e mirë që flitej për Beograd ne e përjetonim si fyerje kombëtare“.

Ish-studenti dhe më vonë kolegu i Begollit, aktori Enver Petrovci, edhe sot thotë të mos e ketë kuptuar se pse njerëzit në Kosovë janë ndjerë të fyer nga ajo deklaratë e Begollit.

„Ishte ajo koha mbas vitit 1981, kur televizionet dhe gazetarët serbë na provokonin vazhdimisht. Faruku ka thënë që e ndjen veten mirë në Beograd, se ndjehet si fëmijë i Beogradit. Pse jo? Po pse jo? Nuk e di pse njerëzit e kanë keqpërdorë këtë deklaratë të tij. As Faruku, por as Bekim Fehmiu kurrë nuk e kanë mohuar se kanë qenë shqiptarë. Me Farukun, në kafe, në rrugë, në teatër apo kudo që jemi takuar në Beograd, gjithmonë kemi folur shqip mes vete dhe kurrë serbisht. Më në fund, a ka shqiptar, i cili ka jetuar në Beograd, dhe për të cilin njerëzit këtu në Kosovë nuk kanë paragjykime? Njerëzit, të cilët dikur kanë qenë krenaria jonë, mu nga fakti që kanë bërë emër në Beograd, më vonë janë sharë“.

Por, Begolli edhe tani e thotë të njëjtën gjë për Beogradin.

„Pavarësisht se dikush mundet me m’keqkuptue ose keqinterpretue, unë edhe ma tutje e due Beogradin“.

Ndërkohë, për të sqaruar pozicionin e tij prej artisti karshi vendlindjes, në një intervistë dhënë një gazete kroate kohë më parë, deklaroi:

“Kurrë nuk kam ikë nga rranjtë e mia, por nuk kam mendue se kjo asht gjaja ma e randësishme e jetës teme“.

Filozofi Shkëlzen Maliqi konsideron se nami si yje filmi i Bekim Fehmiut dhe Faruk Begollit në Beograd në atë kohë e ka ndryshuar atë perceptimin tradicional paragjykes për shqiptarin si qenie e huaj në hapësirat jugosllave apo s i “pakulturuar”, i “prapambetur”, “sharraxhi”. Sipas Maliqit, edhe Begolli e edhe Fehmiu ishin bërë kult aktorë të kohës.

“Bekim Fehmiu ishte aktori i parë shqiptar dhe jugosllav që depërtoi në kinematografinë botërore, pasi që luajti kryerolin e Odiseut në filmin dhe serialin televiziv italian. Ndërkaq, Faruk Begolli si i ri u bë yll i kinematografisë jugosllave dhe, disa vjet më vonë, pas themelimit të Kosovafilmit, edhe i kinematografisë kosovare“.



VDEKJA E NANËS

Që nga dita kur Begolli për herë të parë ishte larguar me tren për në Beograd, asnjëherë s'mundi të kthehej për kohë më të gjatë në Pejë. Nga Beogradi, e më vonë edhe nga Prishtina, ai e vizitonte të ëmën kohë mbas kohe. Vizitat u shpeshatuan mbas një sulmi në tru, që nana e tij e pësoi në vitin 1993. Ajo paralizohet dhe, në të njëjtën kohë, ngadalë kaplohet edhe nga një lloj skleroze. Që nga ai moment, Begolli shumicën e kohës e kalonte pranë saj, edhe pse ajo tashmë vështirë e njihte dhe vështirë i kujtohej se kush ishte.

„M'vetke se kush isha, masandej m'thirrke me emna tjerë, t'djemve, çikave apo n'emnat e të afërmve tonë. Rrallëherë ia mbushja mendjen se unë isha Faruku, djali i saj“.

Më vonë, gjendja e nanës së tij përkeqësohet. Një ditë, teksa Begolli në Teatrin "Dodona" po bënte regjinë e shfaqjes „Heronjtë e kombit“, të Ymer Shkrelit, e thërrasin dhe e paralajmërojnë se nana e tij po jepte shpirt. Begolli mbërriu para se nana të vdiste. Rreth saj ishin mbledhur të gjithë: vëllezërit, motrat dhe të afërm të tjerë, përfshirë edhe dajën e Begollit, Muharrem Pashën.

„... Unë i hyna nën sjetulla, nisa me kajtë, me dënësë, mbas pak kohe ajo dha shpirt n'krahtë e mi. Motrat m'ngushëllojshin, por unë kajsha me afsh. Masandej ato filluen me m'qortue, bile m'bërtitshin duke m'thanë që ta liroja për me e rregullue se do t'shtangohej ashtu si unë e mbaja“.

Mbas viteve të 90-ta, në kohën e turbulencave politike, kontakti i Begollit me shokët e shkollës ishte më i rrallë, por asnjëherë nuk u shkëput tërësisht. Para një kohe, e tërë gjenerata e klasës së tij nga fakulteti u mbledhën në një kafe, për të kujtuar kohën e shkuar nga studimet. Nga atje ata e morën në telefon Begollin dhe të gjithë radhazi folën me të:

„U smuva nga qefi. U ktheva shumë mbrapa n'kujtime, e asht shumë vështirë me u kthye mbrapa e me kujtue at' kohë. Fatmirësisht, nga ajo kohë kam kujtime t'mira. Due me i kujtue veç gjanat e mira nga ajo kohë. Shoku im, Josif Tatiç m'thirrë vazhdimisht. Kam frikë se me ba me shkue n'Beograd do t'kaj. Nuk due me mendue për aso gjanash“.

Shkëlzen Maliqi konsideron se, për Begollin, vendimi për të lënë Beogradin ka qenë vendim shumë i vështirë. Ai beson se divorci i tij nga gruaja Zoja ka ndikuar në këtë vendim, por, siç thotë, kjo gjë nuk mund të jetë argument i mjaftueshëm.

„Për arsyet e vërteta pse e ka lënë Beogradin dhe karrierën e yllit të filmit jugosllav, ai nuk ka folur asnjëherë publikisht. Me famën dhe lidhjet që ka pasur, Faruku gjithsesi që ka mundur ta vazhdojë karrierën e aktorit të suksesshëm. Por, ai kishte një dëshpërim personal me

“...Duke u
shoqnue
me njerëz
jashtë
profesionit
e sheh një
botë tjetër”

botën ku kishte qenë yll, por që po shembej me të shpejtë, duke i hapur rrugën primitivizmit e fashizmit politik dhe kulturor. Kjo ndjenjë mendoj se ka qenë shtytësi kryesor pse Faruku me vetëdije filloi një jetë dhe karrierë të re, i përqendruar kryesisht në “rolin” e profesorit të aktrimit në Prishtinë”.

Përgjithësisht, Begolli ka qenë i pasionuar pas ndejave me shokë. Mbas kthimit në Prishtinë, në fund të viteve të 80-ta, ai njihet me shokë tjerë të rinj. Shihej shumë shpesh i shoqëruar me studentët apo ish-studentët e tij apo me kolegë tjerë. Për Begollin, shoqëria është një prej gjërave më të rëndësishme në jetë, krahas profesionit dhe dashurisë. Por, shokë të vërtetë ai thotë të mos ketë pasur më shumë se tre apo katër veta.

„Ajo shoqni që formohet n’rini, ajo mbetet, kurrë ma nuk ndërrohet. Mundesh mos me u pa me personin 20 vjet, 30 vjet, por ti e ke shok. Ti ke besë, ke mbështetje te ai, e edhe ai n’ty. Pra, sa ma i ri që je, ma lehtë formon shoqni, ma lehtë e gjen shokun. Sa ma i vjetër që je, aq ma vështirë e gjen shokun. Unë me këto vjet’ e mia, unë ma shok, qasi të shpirtit, nuk muj me gjetë.”

Sipas Begollit, shoqëria më e mirë është ajo e dy shokëve që nuk kanë profesione të njëjta. Orët e mundimshme në prova teatri apo sheshe xhirimi, takimet e lodhshme me kolegë dhe njerëz të zanatit, mund të baraspeshohen me ndejat me shokë jashtë profesionit tënd. Dhe, në të njëjtën kohë, akumulohesh, sepse percepton informata jashtë botës tënde të profesionit.

“...Duke u shoqnue me njerëz jashtë profesionit e sheh një botë tjetër. Kjo gja m’ka ndihmë shumë, mbasi shoqnia jeme nuk ka qenë e përbame vetem prej njerëzve t’profesionit. Kam pasë edhe shoqinë, si ta quaj, intime, që thonë, e kam shokë t’shpiritit”.

Një prej shokëve të pandashëm gjatë viteve të fundit është Albert Maloku, me profesion ekonomist. Ai merret me tregti. Alberti e shoqëronte Begollin në ndejat e gjata të rakisë, por ai edhe tani po përkujdeset për Begollin, kur ai është i sëmurë. Madje, është njëri prej njerëzve të rrallë, të cilin Begolli e lejon ta vizitojë në dhomën ku është duke qëndruar i shtrirë.

„Albertin e kam shok tash, po përpara kam pasë shokë tjerë. Ai s’kishte lidhje me gjanat t’cilat i baja unë, madje nuk vike as n’premiera t’mia. Hiç. Thojke se, ato që i bajmë na artistat, ai nuk i kapë fort. E unë, tek ma vonë e kam kuptue këtë gja. N’fillim u mundojsha me ia shpjegue. Shiko, i thojsha, jam ka e baj këtë send, ndigjom pak. Se kisha nevojë, isha i ri, e ai ndigjojke, ndigjojke e masandej m’thojke: ‘A po e din ti që nuk po të marr vesh bash kurrëgjja. Ti je ka flet krejt për diçka tjetër. Kallxom për specia, ose për futboll’. Por, masandej unë fillova me e pa që asht shumë e randësishme me pasë shokë jashtë profesionit. Po flas për shoqni t’vërtetë, jo për shoqni me të cilët pi raki. Unë jam kthye n’Prishtinë. Te tanë i njoh, kanë qenë studentë t’mi. Shoqnohem me ta, jam edhe n’kafe e edhe n’mësim me ta. Gati gjithkund. Por, unë kam gjetë një tjetër shok, i cili aspak nuk merret me këtë punë, e i cili as n’teatër nuk ka shkue deri sa nuk më ka njoftë mue. Merret me tregti njeri, dhe na kur rrimë, as ai nuk flet për tregti, e as unë nuk flas për art. E kemi një jetë dhe një muhabet krejt tjetër. Kjo don me thanë, se unë e kam nuanë ndoshta trenin e fundit para dhjetë a pesëmbëdhjetë vjetve me e ba edhe një shok, ama tamam me i thanë shok”.

SHIKIMI NË BEBEZEN E DIELLIT

“

Nganjherë m'kaplon malli për kohën kur jam kanë i ri, kur kam xhirue filma, kur kam shkue nga një vend xhirimi në tjetrin nëpër krejt ish-Jugosllavinë”.

Një karrierë e shkëlqyeshme në film. Në vitet e arta të kinematografisë së ish-Jugosllavisë, Faruk Begolli ishte njëri prej aktorëve më të adhuruar nga publiku dhe më të kërkuar nga regjisorët e filmit jugosllav, por edhe kosovar. Regjisorët provokoheshin nga sharmi i tij dhe nga ngrohtësia që ai u jepte personazheve të filmave. Aktor i ri, me plot energji dhe sens loje, Begolli me një shpejtësi marramendëse u bë një yll filmi.

Deri më tash ka luajtur në afro 70 filma, artistikë e televizivë, metrazhesh të ndryshme, të prodhuar nga shtëpi filmike e televizione gjithandej ish-Jugosllavisë. Kishte role kryesore por edhe episodike. Me pak shpërblime të rëndësishme, Begolli shpërblimin më të madh e ka marrë nga publiku gjithkund ku janë shfaqur filmat e tij. Fama dhe popullariteti i tij nuk u shuan asnjëherë. Madje, popullariteti i tij vazhdon edhe tash kur publiku e sheh Begollin shumë rrallë nëpër filma.

“Në akademi kam hy krejt i pa dije, i pavetëdijshëm se çka po ndodh në botën e filmit. Në atë drejtim jam kanë krejtësisht naiv apo virgjin. Kështu që, unë nuk kam pasë ndonji idol. Natyrisht, kishte aktorë të cilët i doja. Në atë kohë unë kqyrsha ma së shumti filma western. E masandej, shembull m'asht ba Bekim Fehmiu. Se kur u pranova në akademi, ai njihej si legjendë në punën e tij. Bile, m' patën lodhë tuj m'thanë: eh, Bekimi punon. E unë isha një njeri krejt ndryshe. Nji njeri që ma shumë m'interesojke shoqija e kafja sesa puna. E ata, profesorat, m'thoshin: Bekimi nga tri apo katër orë n'ditë ushtron. E masandej unë e pyetsha Bekimin (se ai vërtet m'ka ndihmue shumë dhe m'ka pritë mirë në atë fillim): a përnjimend punon ka katër orë? E ai ma kthejke: jo katër, por pesë orë punoj...”



“Asaj i kanë dhimbtë shumë plagët dhe vuajtjet e mia n’filma. Prej asaj kohe ajo asnjherë s’ka dashtë me i pa filmat e mi”.

Në vitin 1966, kur Begolli ishte ende në vitin e dytë të studimeve, regjisori i njohur jugosllav, Veljko Bullajiq, e vizitoi Akademinë e Arteve në Beograd, me shpresën që të takonte aktorin, të cilit do të mund t’ia besonte rolin kryesor në filmin e tij “Shikimi në bebëzën e diellit”. Begolli, kur takohet me të, mundohet ta mbulojë gojën, duke dashur t’i fshehë dhëmbët e rënë. Bullajiq, i cili e kishte kuptuar ndrojtjen e artistit të ri, i kishte thënë: “E di që nuk i ke dhëmbët, qesh lirisht”. Gjithçka kishte përfunduar shpejt. Begolli kishte hequr dorë dhe as që kishte ëndërruar më pas se mund të ketë ndonjë rezultat nga vizita e këtij regjisori.

“Unë hoqa dorë, se nuk besojsha se ka me m’zgjedhë bash mue, se thojsha: a e merr njeri n’film nji artist të ri e pa dhambë.”

Por, mbas pak muajsh, Begolli ishte ftuar në prova xhiruese. Në ato prova takohet me konkurrentë tjerë, artistë të njohur të asaj kohe, të cilët po provoheshin për të njëjtin rol dhe për disa role tjera të filmit. Në këto prova xhirimi, Begolli ballafaqohet për herë të parë me një punë profesionale dhe me një ekip profesionistësh. Vesh kostumet e personazhit dhe del përballë aktorëve tjerë, duke u munduar të gjejë përngjasimet me personazhin, që regjisori po besonte se i përshtatet Begollit. Për partner kishte Bata Zhivojinoviçin, një aktor i njohur i asaj kohe, ndërkohë që konkurrentë për rolin që ai po e provonte kishte aktorët e famshëm: Bekim Fehmiu, të cilin Begolli asokohe e adhuronte dhe Rade Sherbexhinë. Një skenë provuese e pati edhe me vetë Bekim Fehmiun. Prandaj, edhe ndihej i emocionuar dhe jo sa duhet në formë.

Personazhi që interpretonte Begolli ishte një djalë i ri, i cili i ndihmon një partizani të sëmurë nga tifoja për të kaluar matanë një pylli, të cilin armiku vazhdimisht e qëllonte me granata. Ngjarja zhvillohej nëpër terren të vështirë, në një dimër me borë.

“Gjatë provave, regjisori m’thojke: ‘Ti s’po dijshe kurrnga’. E unë njimend nuk dijshe kurrnga, se hala isha n’vitin e dytë n’studime. Prandej, regjisorit iu përgjegja me këto fjalë: ‘Po, nuk po di asgja, se nuk i kena mësue këto gjana hala’”.

Pas kësaj ngjarjeje, Begolli kthehet në Beograd i zhgënjyer dhe i pashpresë. Megjithatë, doli se provokimet e regjisorit Bullajiq ishin jo të njëmendta. Mbas një muaji, Begolli befasisht merr vesh se i është besuar roli, për të cilin kishte bërë provat e xhirimit. Natyrisht, besimi që i ishte dhënë e bëri të ndjehej si një aktor i vërtetë. Një gazetë asokohe shkruante për të në një qoshe të gazetës.

“Ecsha rrugës dhe shikojsha a po m’shohin të tjerët, a po e dinë kalimtarët se unë isha Faruk Begolli, ai për të cilin po shkruante gazeta atë ditë. Edhe, tanë kohën, mendojsha se qysh me ju tregue: hej, a po m’shihni, unë jam ai për t’cilin ka shkruar gazeta. E shkrimi, në fakt ishte në nji skaj t’gazetës dikun me pak rreshta”.

Xhirimet bëheshin në Zagreb. Begolli udhëtoi atje dhe iu bashkëngjiti ekipit të filmit. Kishte edhe një motiv më shumë: po paguhej shumë mirë për rolin. Ia lyejnë flokët. Brenda një kohë të shkurtë ia vunë edhe dy dhëmbët e përparmë, që i mungonin. Ditët e para, para fillimit të xhirimit, Begolli ndjehej si mbret i vërtetë, i rrethuar nga çikat e reja dhe nga shkrepëtimat e foto-aparateve të gazetarëve, të cilët e ndiqnin gati në çdo hap.



Megjithatë, kjo "idilë" e tij mbaroi shpejt, sapo filluan xhirimet. Për fatin e keq të tij, eksperiencia e parë e tij me filmin ishte e hidhur, aq e hidhur, sa ai një herë mendoi ta braktisë përfundimisht profesionin prej aktori dhe të kthehet përgjithmonë në Pejë. Raportet me regjisorin u tendosën skajshmërisht. Si debutues, pa kurrfarë përvojë në zanatin e ri, Begolli ndihej i frustruar dhe aspak i përgatitur për t'u ballafaquar me telashet, që sa vinin e shtoheshin.

"Metoda" e regjisorit, që punën me aktorë ta drejtonte me britmë e nervozizëm, gati sa nuk e "çmendti" Begollin. I dukej se jeta po i bëhej ferr. Për një moment mendoi ta prishte kontratën dhe të gjente para diku për t'ia kthyer regjisorit. Dëshironte ta thërriste të ëmën dhe t'ia kërkonte të hollat, por nuk vendosi dot. Krejt kjo dukej punë shumë e komplikuar.

"I vetmi film, ku gjatë xhirimit nuk kam pasë asnjë lloj knaqësie ka qenë ky film. Si ka fillue filmi, jeta mu pat ba 'ferr', se m'bërtitke regjisorin. Por, unë vërtetë nuk ditsha kurrëgjatja, nuk e njifsha as teknikën e filmit e as aktrimin. Mendojsha me ikë prej ekipit, po kah me ikë se, qysh me ia kthye paret e me ia lanë filmin. Me një fjalë, filmi i parë ka qenë veç 'ferr'".

Begolli, i cili gjatë xhirimit të këtij filmi të parë po festonte ditëlindjen e tij të njëzetë e dytë, një ditë zihet keq me regjisorin, i cili edhe e akuzoi si "të patalentuar" dhe "frikacak". Begolli, mbasi i vërsulet regjisorit, ikën në mal, dhe atje do të qajë i thyer dhe i pashpresë.

"Në pyll erdhi dhe më mori Bata Zhivojinoviç bashkë me gruen e tij. Ata m'prunë n'dhomën ku rrija dhe filluen me m'folë duke m'dhanë guxim dhe duke m'inkurajue. Masandej i kënduem disa kangë t'dhimbshme bashkarisht. Kurrë s'kam me e harrue atë natë".

Në ditët në vijim, Begolli dhe regjisor Bullajiç e shikonin me plot nervozizëm njëri-tjetrin, por asnjëri prej tyre nuk provonte ta prishë kontratën. Me sa duket, të dy ishin të vetëdijshëm për pasojat e një veprimi të tillë.

Muajt në vazhdim u bënë pak më të relaksuar dhe bashkëpunimi me regjisorin po stabilizohej. Për shkak se i ishte kundërvënë "tiranit", Begolli shihej me admirim nga kolegët tjerë, të cilëve regjisorin poashtu shpeshherë ua sillte shpirtin në fyt.

Kjo përvojë e keqe gjatë xhirimit të parë bëri që Faruk Begolli pothuaj asnjëherë të mos i shikonte filmat e tij. Dhe, fatmirësisht, kjo përvojë e keqe në filmin e parë, nuk u përsëritet kurrë më. Begolli në xhirimet e filmave tjerë gjente vetëm kënaqësi dhe asnjëherë mërzë.

Kur e ëma e Begollit e pa për herë të parë të birin e saj në filmin "Shikimi në bebëzën e syrit", ku Begolli luante një të sëmurë nga tifoja, u sëmur dhe është dashur ta çojnë në spital. Ajo nuk ka mundur ta duronte dot "vdekjen filmike" të të birit, sepse asaj i është dukur si një vdekje e vërtetë. Zanatin e të birit e quante si "të mallkuar".

"Asaj i kanë dhimbtë shumë plagët dhe vuajtjet e mia n'filma. Prej asaj kohe ajo asnjëherë s'ka dashtë me i pa filmat e mi".

Planet e tij të mëhershme për ta braktisur zanatin e aktrimit dhe për t'u kthyer në Pejë te nana, u avulluan shpejt. Përvoja e hidhur prej filmit të parë, ngadalë mbeti si një ngjarje e



largët, ndërkohë që trysnia për të ecur tutje i vjen mbas një oferte të dytë për të luajtur në një film tjetër të radhës. Ishte ky rasti kur tek ai u ngjall "demoni" i aktorit. Sërish gati sa nuk ngulfatet nga entuziazmi. Rishtas fillon e ndjen brenda vetes dellin prej aktori, diçka i thotë se duhet nisur edhe një sfidë, edhe një aventurë.



Filmi i dytë, në të cilin luan Begolli, quhet "Ëndrra", me regji të Purisha Gjorgjeviqit, i cili asokohe ishte një regjisor i njohur. Ankthi i filmit të shkuar mbulohet dhe lihet anash. Begolli filloi xhirimet e filmit të dytë dhe kësaj radhe bashkëpunimi me regjisorin ishte i shkëlqyer. Madje, regjisori po entuziazmohej me punën e Begollit. Xhirimet shkonin si është më së miri dhe ekipi shfaqej tej mase i relaksuar.

Mbas rolit të dytë, vjen roli i tretë, i katërt... Begolli nis e bëhet aktor i kërkuar. Si në ata filmat western, ku banditët ndiqeshin nga policia me pamfletet e shkruara "wanted". Prandaj, dukej se edhe për Begollin regjisorët sikur kishin lëshuar një fletë-kërkim me mbishkrimin "e duam në film". Faruk Begolli, shkruante një revistë e atëhershme jugosllave, i takon grupit të aktorëve që në fillimet e hershme të karrierës i janë dhënë filmit.

Mungesat në akademi konsideroheshin si "mungesa me arsye" nga profesori i klasës së tij dhe Begolli nuk kishte ndonjë telashe. Madje, ai mori edhe rolin kryesor në shfaqjen studentore të vitit të dytë: "Fëmijët e diellit", të M. Gorkit. Por, ky do të jetë një nga rolet e tij të rralla në teatër. Përgjithësisht, mbas kësaj kohe ai refuzonte rolet që i ofroheshin për skenë. Kjo për shkak të angazhimit të madh që kishte në filma. Edhe fakultetin e kreu me pauza të shkurta ndërmjet.



Nga fillimi i karrierës prej artisti, Begolli mban mend një takim përshëndetës me Titon, ish-presidentin e Jugosllavisë. Mbas filmit "Beteja e Neretvës", të regjisorit Velko Bullajiq, Tito kishte shprehur dëshirën të përgëzonte ekipin e filmit.

Mbas aplaudimit të publikut për filmin, aktorët dhe ekipi ishin rreshtuar për ta përshëndetur të famshmin e asaj kohe, Shokun Tito. Radha e artistëve niste me ata që kishin role dytësore për të përfunduar me të tjerët që ishin në rolet kryesore. Begolli ishte i treti nga fundi. Tito po i përshëndeste të gjithë me radhë, ndërkohë që Begolli po dridhej nga entuziazmi.

"...Edhe ai erdhi te unë, me ato dorëzat e tij. Unë po e kqyri, por po e shoh që ai fare nuk po kqyr n'mue, po sytë i kishte dikah larg. Ma zgjati dorën dhe m'foli: 'Simpatican si ti, mladac '(Simpatik je ti, djalosh), dhe vazhdoi tutje. Unë kam kujtue që ai as që po m'kqyr, e le ma me e dijtë se kush jam. E tash, pse e ka dijtë ai: ai nuk ka pasë film që nuk e ka pa. Te tanë filmat tonë asht ulë dhe i ka pa. Kemi qenë një ditë mysafir të tij. Të paktën një herë gjatë festivalit, nëse jo dy herë, ka ardhë dhe i ka pa filmat".

"Për shumicën e aktorëve të gjeneratës së tij është ngjarje e shënuar kur marrin një rol në ndonjë film, ndërsa, për Faruk Begollin, është ngjarje e shënuar kur nis një film pa të", shkruante një gazetë e vitit 1976. Në vitin 1976, kur Begolli kishte 33 vjet, mbrapa kishte të xhiruar saktësisht 33 filma artistikë. Në atë kohë, në ish-Jugosllavi xhiroheshin afërsisht 16 filma në vit. Begolli ishte patjetër në ndonjërin prej filmave që xhiroheshin. Ai ishte pothuaj i pashmangshëm. Puna në film atij i sillte kënaqësi.

“Sa ma shumë që t’luen n’filma, aktorit aq ma shumë jeta i bahet ma e mirë, ma e lumtun. Kjo asht ajo ana e mirë. Megjithatë, ekziston edhe ajo ana tjetër, që sjellë një jetë të vështirë, të mundimshme, të pasigurtë, me netë të tana pa gjumë, me një jetë kryesisht jashtë shpisë dhe familjes. Kështu që, asht e lidhun kënaqësia me pakënaqësinë”.

Begolli luajti edhe në disa filma të suksesshëm televizivë. Në vitin 1972, luajti në filmin televiziv: “Të ngjuarit”, film ky në gjuhën shqipe, i prodhuar nga Radio Televizioni i Beogradit - redaksia në gjuhën shqipe. Skenarist dhe regjisor i këtij filmi ka qenë Ekrem Kryeziu, miku i studimeve të Faruk Begollit. Përpos Faruk Begollit, në “Të ngjuarit” luanin edhe Melihate Ajeti, Shani Pallaska, Istref Begolli etj. Regjisor i Kryeziu bashkëpunoi me Begollin gati në të gjitha projektet e tij filmike të mëvonshme, përfshirë edhe: “Kur pranvera vonohet”, “Epoka para gjyqit”, “Buka e hidhur”, “Darka e dreqit”, “Dashuria e Bjeshkëve të Nemuna” etj. Për sa u përket filmave të tij, Kryeziu konsideron se ka bërë përzgjedhje të mirë, sidomos me Faruk Begollin në rolin e Abdyl Frashërit.

“Nëse ndonjë herë kam bërë ndonjë përzgjedhje të mirë të roleve për filmat e mi, atëherë ajo është përzgjedhja e Faruk Begollit për rolin e Abdyl Frashërit”.

Në Televizionin e Prishtinës Begolli, gjithashtu, luajti në dramën televizive: “Fluturimi i micakut”, të regjisorit Emin Halili.

Një film, i cili do t’i sjellë shumë popullaritet Begollit është “Dashuria e parë”, me të cilin fillojnë e krijohen klubet e adhuruesve të filmave të Faruk Begollit në tërë ish-Jugosllavinë. Popullariteti i Begollit mbas këtij filmi arrin kulmin. Dera e banesës së tij për çdo mëngjes gati bllokohej nga një thes letra, të cilat vinin nga adhuruesit e tij anembanë ish-Jugosllavisë.

Filma tjerë të rëndësishëm të asaj kohe, në të cilët luajti ai janë edhe: “Proka”, me skenar të Eqrem Bashës e në regji të Isë Qosjes, “13 Korrik” i regjisorit Radomir Saranoviq e në të cilin luan edhe Rade Sherbexhija, pastaj filmi “Përroi vërshues”, me skenar të Petrit Imamit e në regji të Besim Sahatçiu, “Ruajtësi i plazhit në kohë dimri”, i regjisorit Goran Paskaljeviq, “Pavle Pavloviq”, i regjisorit Mladomir ‘Purisha’ Gjorgjeviq, “Valteri mbron Sarajevën”, i regjisorit Hajrudin Kravac, “Beteja e Neretvës” i regjisorit Veljko Bulajiq, “Atentati i Sarajevës”, në regji të Fadil Hagjiqit, “Operacioni Beograd”, i regjisorit Zhika





Mitroviq, "Uka i Bjeshkëve të Nemuna", me skenar të Abdurrahman Shalës dhe Murteza Pezës e në regji të Miomir Stamenkoviqit. Përpos Begollit, në këtë film luajnë edhe: Ljuba Tadiq, Abdurrahman Shala, Josif Tatiq, Vesna Krajina, Branko Plesha, Melihate Ajeti etj.

SULMI I KUQ



"Sulmi i kuq", i regjisorit Predrag Goluboviq, ka në prapavijë një histori interesante. Bazohet në një histori nga Lufta e Dytë Botërore, sipas rrëfimit të Ali Shukrisë, ish-politikan kontravers dhe antishqiptar, pjesëmarrës në Luftën e Dytë Botërore. Ngjarja e filmit ndodh në Minierën e Trepçës dhe flet për një grup minatorësh, nga të gjitha nacionalitetet e ish-Jugosllavisë, të cilët kryejnë aksione diversante kundër forcave gjermane. Filmi shquhet nga humori i zi, asilloy çfarë mund të kenë mbase vetëm njerëzit, të cilët janë mësuar me frikën nga vdekja.

"Nja tre budallë i kanë çue hava nja tre bandera dikund në Trepçë. Dhe, kjo gja asht konsiderue si aksion i madh. Edhe tash, po bahet filmi".

Filmi ishte prodhim i „Avala Film“ dhe i Kosovës, e në rolet kryesore luanin: Bata Zhivojinoviq, Boris Dvornik, Abdurrahman Shala, Xhevat Qena, Bert Sotlar, Faruk Begolli, Shani Pallaska, Olivera Katarina, Istref Begolli, Ragip Loxha, Adem Mikullovc, Skender Radotina, etj. Filmi u realizua për afro 50 ditë. Punohej rreth 16 orë brenda minierave të Trepçës.




"Skenari ka qenë ky: 6 dasa janë të dashnuem në një femën, që luhej nga Olivera Katarina. Bile, unë isha ma i dashnuemi n'të. Unë e luejsa një piktor. Ishim shtatë komunist. Xhevat Qena ka luejtë për mrekulli. Ishte fantastik. Na ka shti n'xhep të vogël krejt neve tjerëve. Edhe e bamë filmin".

Menjëherë mbas montimit, filmi përzgjidhet për të marrë pjesë në festivalin e atëhershëm të filmit në Pulë. Ky do të ishte prezantimi i parë publik. Njerëz nga Bashkësia e Interesit të Kosovës nisen për në Pulë, mbasi filmi ishte i ko-prodhuar nga Kosova. Ata, deri atëherë, nuk e kishin parë filmin, ngaqë realizimi i tij qe bërë në "momentin e fundit". Në Pulë, para se të shfaqej para publikut të gjerë, filmin e shohin përfaqësuesit nga Bashkësia e Interesit. Ata nuk ndahen fare të kënaqur, prandaj edhe kërkojnë që filmi të mos shfaqet në festival.

"Sidomos Ali Shukria ka qenë kategorik që filmi mos me u shfaqë. Ai ishte shumë i idhnuem se 'roli' i tij në film nuk ishte kurrkund. Rrëfimi i tij ishte ndërrue gati krejt. Na ishim shtatë cara, që ia kanim nanën një miniere. E këta, n'festival të Pulës donin me e ndalue filmin. Por, ishte një problem, mbasi filmi ishte ko-prodhim. Dhe ata të „Avala Filmit“ u thoshin këtyne të Kosovës: ju, nëse doni, ndalojeni atje n'Kosovë, por këtu ne duem me e shfaqë. Edhe, çka po di... Tash këta tanët me siguri kanë nisë me u ankue, e ato lidhjet politike e çka po di unë. Mue sum kërcitke. Flejsa tanë ditën e pijsha tanë natën. E haber s'kisha se çka po ndodhë".

Tito, në njëren prej atyre ditëve, pasi ishte zgjuar prej gjumit të ditës, sipas zakonit, kërkoi ta shihte një film në kino-sallën e tij. Sipas „regullit“, për çdo film të ri jugosllav që ai e shihte, ftonte edhe politikanë të tjerë, të cilët në atë kohë mund të kenë qëlluar



për pushime në Brione. Zakonisht, kur ai ka parë ndonjë film të prodhimit kroat, ka ftuar politikanët kroatë... të Sllovenisë.. të Kosovës... Dhe, atë ditë, kur ai vendosi ta shihte filmin e ri „Sulmi i kuq“, ftoi si mysafir funksionarin a lartë partiak kosovar, Fadil Hoxha me bashkëshorten, Vahiden.

„...Edhe, e ka kqyrë filmin bashkë me Fadilin e Vahiden. E ka kqyrë Tita filmin mirë e me lezet deri n’fund. Se, kaniherë, nëse nuk i ka pëlqye, nuk e ka kqyrë deri në fund. Por, thonë nuk ka pasë gati film që nuk e ka kqyrë. Ka qenë njeri që e ka dashtë filmin. Mbas ka përfundue filmi, Tita i ka thanë tuj keshë Fadilit: „Dobar ti je film, Fadile“. (Fadil, filmi asht i mirë). Mbas këtij lavdërimi që Tito i bani filmit, Vahidja, grueja e Fadilit, lidhje mbas lidhje, e ku e dij se si, ka mbërrri me u thanë këtyne t’Bashkësisë së Interesit, t’cilët dojshin me e ndalë filmin në Pulë: „Rrini, mos hani mut“. E ata, po atë ditë u larguen nga festivali“.

Vlen të përmendet fakti se, në festivalin e Pulës, „Sulmi i kuq“ ka fituar çmimin e tretë të jurisë.

VITE TË VËSHTIRA

Në Vitin 1977, Faruk Begolli luajti rolin kryesor në filmin „Vite të vështira“, i prodhuar nga „Sutjeska film“, regjinë e së cilit e bënë Zhika Ristiç dhe Ravil Batirov. Xhirimi i këtij filmi filloi me 12 Shtator 1977, kurse xhirohet në Tashkent (BRSS) dhe në Jugosllavi.

Një telefonatë diku rreth mesnatës. Zoja Begolli, ish-gruaja e Faruk Begollit, ngre kufjen. Dëgjon bashkëbiseduesin, qeshet dhe mandej i tregon të shoqit: po të thërrasin nga Tashkenti. Begolli e merr këtë gjë si një lojë. Megjithatë, pak më vonë bindet vërtet se ishte regjisori Zhika Ristiç, i cili e kishte marrë në telefon nga një qytet aq i largët. Ekipi në Tashkent kishte parë filmin, ku kishte luajtur Begolli: „Dervishi dhe vdekja“, me çka edhe kishin vendosur t’ia ofronin rolin kryesor, atë të Aleksander Dragovica-s. Bëhet fjalë për rolin kryesor në filmin: „Vite të vështira“, bashkëprodhim jugosllavo-sovjetik. Skenarin e këtij filmi e kishin shkruar Zhika Ristiç dhe Oljusha Adisheva. Begollit i kërkohej që brenda dy ditëve të udhëtonte drejt Tashkentit. Ai kishte dilema. Frika nga aeroplani po e mundonte. Nga shpjegimi i shkurtër, kishte kuptuar se roli, të cilin do të luante, ishte i mrekullueshëm. Më në fund, kishte vendosur të shkonte. Por, para se të nënshkruante kontratën, kishte insistuar të lexonte skenarin. I besonte regjisorit Ristiç, por, siç thotë, „puna është punë“. Begolli arriti në Tashkent mbas dy ditësh, ashtu siç edhe ishte kërkuar nga ai.


„Çka të them. Frikësohem shumë nga aeroplani dhe përpiqem që të mos fluturoj, nëse veç kjo gja asht e mundun. Fluturimet ma t’gjata deri atëherë i kam pasë nga 45 minuta, ndërkohë që fluturimi Beograd - Moskë – Tashkent zgati shtatë orë“.

Mbasi lexon skenarin, Begolli kupton se roli i tij ishte „një rol mbas të cilit vrapojnë të gjithë aktorët dhe për të cilin duhet pritur e pritur“.

Mbas atij udhëtimi të lodhshëm, ditët e para në Tashkent i kaloi i shtrirë, ndjehej i dërmuar nga lodhja. I dhembte kryet, dhe këmbët i ishin mpirë, gati sa nuk i ndjente.



„Shetitsha nëpër dhomë si luani n'kafaz. Lexojsha tekste, gazeta dhe gjithçka që m'binte nëpër duer. Kështu deri n'agim“.



Mbas leximit të skenarit, Begolli kërkoi 15 ditë kohë, që të njëhej me shprehitë dhe zakonet e njerëzve, prej nga vinte personazhi në film. Kjo kërkesë e tij u plotësua pa fjalë. Gjatë pesëmbëdhjetë ditëve në vijim ai shëtiti nëpër muze, galeri, katunde, tregje, dasma, medrese, e ku jo. Këto vizita i ndihmuan që së paku pjesërisht të njëhej me rrethinën dhe me mënyrën e jetesës në Uzbekistan. Begolli ruan kujtime të mira nga koha e kaluar atje. Njerëzit atje, shpjegon Begolli në një intervistë të tij të asaj kohe, kur kuptonin që ne ishim nga Jugosllavia, tregoheshin edhe më dashamirës.

Xhirimet filluan në fund të muajit shtator. Ekipi i filmit ishte i përzier. Përpos aktorëve nga ish-Jugosllavia, kishte edhe shumë aktorë tjerë nga Uzbekistani, Turkmenistani e Moska.

Personazhi të cilin e luante Begolli fliste serbisht, ndërsa aktorët tjerë nga shtetet e BRSS –së flisnin rusisht. Në ekip mbretëronte një atmosferë shumë e mirë pune dhe shoqërimi. Gjithçka funksiononte mirë dhe të gjithë e kuptonin njëri – tjetrin. Një muaj e gjysmë xhirime kishin kaluar rrëmbimthi. Atje Begolli ishte njohur me njerëz të mrekullueshëm, si dhe profesionalisht kishte pasur një eksperiencë të shkëlqyer, me ç'rast aktori ishte “qendra”. Regjisorët e filmit, Ravil Bahtirov dhe Zhika Ristiç, shpeshherë punonin me orë të tëra me aktorët për të kapur një kuadër të vetëm. Begolli gjatë asaj kohe shoqërohej me aktoren e njohur nga Turkmenistani, Artikom Xhanom, me të cilin thoshte se kishte kënaqësi të luante. Partnere e Begollit në këtë film ishte një aktore e re nga Tashkenti, Aljmira Ismailova.

Po kush ishte Aleksandar – Sasha Dragoviç, personazhi, të cilin po e luante Begolli? I lindur në një fshat të vogël, ai hyn në Luftën e Parë Botërore në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare. Bashkë me të vëllanë e tij më të vjetër, të cilin në film e luante Zlatko Martinçeviç, zihen rob. Kampi i tyre ushtarak ndodhej afër kufirit me Rusinë dhe ata, bashkë me një grup të burgosurish, ikin në Rusi, ku edhe i bashkohen armatës ruse. Marrin pjesë në Revolucionin e Tetorit dhe e vazhdojnë luftën deri në fund, deri në thyerjen përfundimtare të trupave kundër-revolucionare. Është e njohur botërisht se në ato luftime kanë marrë pjesë rreth 35 mijë ish-jugosllavë. Personazhi të cilin e luan Begolli ka shumë transformime, të brendshme dhe të jashtme. Aleksandri futet brenda radhëve të kundërrevolucionarëve me mision të caktuar. Aty ai njihet me një vajzë të re, e cila kërkonte të hakmerret për vrasjen e babait të saj.

“Rolin e vajzës e luan në mënyrë të shkëlqyeshme Almira Ismailova. Mbas një dashurie të shkurtër, filmi përfundon tragjikisht me vrasjen e vajzës. Aleksandri, para se të niset në detyrën e fundit, ka këtë dialog: ‘Sasha, këtu përfundoi gjithçka. Kam dëgjuar se revolucioni ka filluar edhe në Kinë. A të shkojmë bashkërisht edhe atje?’ ‘Shok, do të shkojmë. Megjithatë, së pari më duhet të shkoj në shtëpi. Ka kohë të gjatë që nuk e kam parë vendlindjen dhe asnjë të afërm. Vetëm edhe njëherë dua ta shoh vendlindjen, shtëpinë dhe fushën rreth saj, lumin, vetëm këto”.

Begolli ishte vërtet i përkushtuar dhe së tepërmi i dhënë mbas filmit. Ai, thjesht, e donte filmin. Sipas tij, edhe jeta edhe puna duhen parë si lojë. Si një lojë që të jep kënaqësi.

“E due profesionin, e due aktrimin se ai m’jep kënaqësi. Lojë, që të bjen kënaqësi. Jo kritika, ose publiku ose... Jo, jo, si lojë që i kënaq nevojat e mia t’mbrendshme. Pra, krejt çka kam punue, kam punue me kënaqësi. Çdo herë, kur e kam marrë aktrimin si ‘lojë’, kam ba role t’mira. E kur kam dashtë me i ba rolet ashtu, me analiza e ku ta di unë, kam ba role ma t’dobëta. E, kur ju qassha rolit si lojë, gjithmonë kam qenë ma kreativ, ma i lirë, me imagjinatë ma t’zhvillueme... m’punonte truni”.

Për sukseset e tij, Begolli mendon se ka pasur edhe fat. Sipas tij, fat ka qenë angazhimi në filmin e parë, por edhe në disa nga filmat tjerë të rëndësishëm.

“...Fillojsha një film për dy ditë. Të nesërmen m’lajmëruen ‘jo, nuk ke me lujtë. Normalisht, u zhgënjeva e çka po di unë. Dhe, shkova n’kafe, se unë njeri i kafes jam. Kur jam dëshprue, nuk kam shkue n’teatër a n’galeri me vujtë, po n’kafe. Edhe, shkova n’kafe, aty me plot tjerë dhe me një regjisor, që ia niske filmit t’vet për pesë ditë. E unë me të as që folsha. Të nesërmen, ai po m’thirrë dhe po ma ndan rolin kryesor. Masandej, e kam pyet se si e çka u ba që ndodhi kjo? At’ ditë n’kafe me të ishin edhe vajzat e tij dhe grueja. Ato m’kanë lavdëruë aq shumë, sa që ai të nesërmen m’ka thirrë. Kështu që, e humba një rol, por e fitova një tjetër. E, ky që e fitova ishte shumë ma i mirë se ai që kisha humbë. Pra, a nuk asht fat ky? Unë nuk besoj në horoskop e n’këto yjet, po, megjithatë, diçka, pshtjellët’ dikund, e nuk varet prej teje”.

Pa asnjë dyshim, Begolli po pushtohej tërësisht nga bota e filmit. Përveç roleve në film, ai ishte mjaft aktiv edhe në ngjarjet tjera rreth filmit. Për një kohë të caktuar ai ka qenë Kryetar i Lidhjes së Artistëve të Filmit të ish-Jugosllavisë. Ndërkohë, në vitin 1980, ai u bë drejtor i “Takimeve të filmit” Nish-80. Çuditërisht, shkruante një gazetë në vitin 1980, sivjet asnjë nga rolet e Faruk Begollit në filma nuk është nominuar për çmim në festival, prandaj ai edhe është zgjedhur të jetë në krye të jurisë në festivalin e Nishit. I çliruar nga ndjenja e pritjes dhe ethet e ndarjes së shpërblimeve, ai ka qenë njëri prej mysafirëve më gazmorë dhe më të hareshëm, shton gazeta.

Ai u bë vizitor i rregullt në shumicën e festivaleve, pasi shumë rrallë ndodhte që në një festival filmi në ish-Jugosllavi të mos shfaqej ndonjë film ku kishte luajtur ai.

Begolli, gjatë asaj kohe punoi me regjisorë të ndryshëm. Përpos, në filma artistikë të metrazhit të gjatë, ai luante edhe në filma të shkurtë, por edhe në drama televizive. Ndër rolet më të çmuara në filma të shkurtër, Begolli përmend filmin “Biografia e ushtarit Shulc”. Protagonisti është një ushtar gjerman, i cili kundërshton urdhrin e eprorëve për masakra ndaj civilëve (fjala është për Luftën e Dytë Botërore) dhe ai pastaj edhe vetë pushkatohet bashkë me civilët. Është një biografi e vërtetë. Ky film ka pasur një sukses të madh ndërkombëtar. Kritikët patën vlerësuar jashtëzakonisht shumë rolin e Begollit në këtë film.

Në Bilten-in që e botonte Festivali i Pulës, në vitin 1979, ndër të tjera shkruante: “Faruk Begolli ka mbërri kulmin e tij si aktor në filmat vendorë, në të cilët, këto vitet e fundit, arriti të realizonte role të shkëlqyeshme dhe interesante. Është i dashur për publikun e Pulës, i cili çdo film të tij të ri e pret me vëmendje të posaçme”.



Por, jo të gjitha rolet që i janë ofruar ai ka pranuar t'i luajë. Begolli, mu në atë kohë kur ishte tejet i kërkuar, gjithnjë e më shpesh niste e refuzonte ofertat e regjisorëve. Begolli kujton faktin se nga disa prej roleve episodike ndonjëherë ka fituar shumë më tepër të holla se sa ç'kishte fituar me disa nga rolet kryesore nëpër disa filma.

“Kur të pëlqen një rol, nuk mendon për honorare, bile nganjëherë i thue vetes dhe të tjerëve ‘këtë e kisha luejtë edhe pa pare’. Por, në ato role ku unë nuk kam dashtë me luejtë, por kanë dashtë të tjerët, regjisorët ose producentat, aty kam marrë ma së shumti pare. Por, këto janë role kur aktori nuk arrin me ba gja, e kryen at’ punë dhe s’ban gja t’hajrit... Unë e kam pasë princip: nëse asht skenari i keq, nëse asht personazhi i keq, atëherë kërko të holla. Kam refuzue zakonisht aso role që nuk kanë pasë naj vlerë, por edhe që as vlera materiale nuk ka qenë kurrfare”.

Personazhet e Begollit ishin të ndryshëm. Megjithatë, regjisorëve u pëlqente t'i ndajnë atij role të heronjve partizanë, të cilët në fund të filmit vdesin, duke e lënë kështu publikun me lot në sy, ose personazhe të dashnorëve romantikë.

„Kam lujtë gjithçka. Por si partizan ia kam fillue, e masandej publiku m’ka dashtë. Se në filmin e parë e kam lujtë një partizan t’dhimbshtëm, kështu që... Ta tregoj një anekdotë, mos ta harroj: një regjisor njiherë e ka ndërrue skenarin për shkak temin. Personazhi që luejsha unë, n’skenarin origjinal nuk ka pasë me vdekë, por regjisori vendosi me e ndërrue, me m’vra n’fund, se thojke, publiku po kan. Për nderë po, e ka ndrrue se nuk kam pasë me vdekë. Se kur vdeksha, sa loti aty”.

Shkëlzen Maliqi thotë që, në përgjithësi, Faruk Begolli luante rolet e heronjve pozitivë në atë pjesë të kinematografisë jugosllave dhe kosovare që hymnizonte LNÇ-në dhe idealet komuniste.

“Regjisorët e kohës e shfrytëzonin, ngandonjëherë edhe deri në stereotip, fizikusin e Farukut si aktor tejet i pashëm, me imazhin gjithnjë rinor, fotogjenitet të pashoq, për të krijuar kult modelin e një heroi të idealizuar të kohës së revolucionit dhe të ndërtimit të socializmit”.

Begolli, i pakënaqur me kualitetin e filmave të atëhershëm jugosllavë, në një intervistë të vitit 1979 deklaronte:

“Sikur të mund t'i zgjidhja rolet, atëherë me siguri shumë rrallë do të kisha marrë pjesë në filmin vendor. Shpresoj që kam me pasë role më të mira në filmat e ardhshëm vendorë. Jam i bindur se skenarët janë të dobët dhe i dobët është organizimi. Këta faktorë e pengojnë zhvillimin e filmit vendor, dhe mendoj se në këtë plan duhet urgjentisht diçka të ndërmerret”.



Në filmin e angazhuar politik, ashtu siç ishin shumica e filmave të asaj kohe, "Era dhe Lisi", sipas romanit të Sinan Hasanit, ish-udhëheqësit të lartë komunist në ish-Jugosllavi, me skenar të Petrit Imamit, e në regji të Besim Sahatçiu, Faruk Begolli luan njërin prej dy roleve kryesore. Burimi, që luhet nga Faruk Begolli, është një luftëtar i ri komunist që lufton për idealet e partisë, mbas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Filmi flet për konsolidimin e pushtetit popullor mbas përfundimit të luftës dhe ballafaqimin me "mbeturinat" e fashizmit. Ky film ka marrë disa shpërblime në Festivalin e Pulës, që ka qenë festivali më me renome në ish-Jugosllavi (Petrit Imami ka marrë Arenën e Artë për skenarin, kurse Abdurrahman Shala ka marrë Arenën e Argjendtë për rolin e tij në këtë film). "Era dhe lisi" është dhënë edhe si seri televizive në 6 episode.



Në vitin 1979, në Festivalin e Pulës prezantoheshin dy filma, në të cilët kishte luajtur Faruk Begolli: "Era dhe Lisi" dhe "Vite të rënda". Mbas shfaqjes, në natën e parë të festivalit, "Era dhe Lisi" mori lëvdata të shumta. Gazetat të nesërmen shkruanin se filmi nuk do të largohej nga festivali pa ndonjë shpërblim. Lidhur me këtë, Begolli, në një intervistë të tij për revistën e festivalit, deklaroi:

"Mendoj që sivjet, për herë të parë prezantohem në këtë festival me dy role të vlefshme. Gjithashtu, mbas 14 vjet të karrierës time si aktor, për herë të parë, kam pasur kënaqësi të punoj në këto dy role, që më kanë mundësuar angazhim dhe hulumtim maksimal aktorsk. Jam shumë i kënaqur për sa i përket bashkëpunimit me regjisorët, Besim Sahatçiu dhe Zhika Ristiçq".



Në vitin 1979, ai luan edhe në filmin e shkurtër: "Duart e pastra", me dramaturg Fadil Hysajn, në regji të studentit të regjisë, Ismail Ymeri, i prodhuar nga "Kosova Filmi". Përpos tij, në film luanin edhe Istref Begolli, me të cilin Faruku do të luante në disa filma të ardhshëm. "Duart e pastra" ishte film shkollor i vitit të katërt dhe bënte fjalë për individin në sistemin totalitar.

Begolli në shtypin e atëhershëm drejtoi kritika të ashpra edhe në adresë të Festivalit të Pulës, për të cilin mendonte se ka humbur kredibilitetin, për të zgjedhur filmat vërtetë më të mirë.

"Shikojeni Pulën për shembull: kush asht ma i aftë n' 'kuzhin', kush mundet me u marrë vesh me ma shumë anëtarë të jurisë, ai fiton. As që shpresoj të shpërblehem në Festivalin e Pulës. Nuk do të ndjehesha mirë nëse m'shpërblejnë".

Sipas tij, Festivali i Pulës ka qenë shumë politizuar; një festival krejtësisht politik, siç e quan ai. Gjashtë republikat dhe dy krahinat kishin në festival nga një përfaqësues, si dhe një përfaqësues ka pasur edhe vetë Festivali i Pulës. Këta përfaqësues ishin kryesisht njerëz të cilët dinin të „luftonin“, sepse zakonisht secila republikë dhe krahinë kishte nga një film të nominuar, kështu që kishte shumë rëndësi zotësia dhe insistimi i tyre për përfaqësimin e kësaj republike apo krahine. Begolli mendon se në Pulë nuk ka pasur fare objektivitet.

Në filmin "Eskadrila partizane", të regjisorit Hajrudin Krvavca, Faruk Begolli luan njërin prej roleve kryesore. Në këtë film luan edhe aktori i njohur, Bekim Fehmiu. Edhe pse filmi flet për aviacionin partizan dhe Begolli luan një prej roleve kryesore, ai asnjëherë nuk do të fluturonte me aeroplan. Begolli, në një intervistë të tijën të hershme shprehet:

“Regjisori Krvavca ka pasur mirëkuptim dhe më ka dhënë rol “tokësor”: të tjerët fluturojnë e unë i pres poshtë. Kurrë nuk fluturoj me aeroplan. Kur duhet të udhëtoj për diku, e përdor zakonisht trenin, autobusin, automobilin apo biçikletën”.

Në “Kur pranvera vonohet”, një film i produksionit kosovar, në regji të Ekrem Kryeziut, Faruk Begolli luan njërin nga rolet kryesore. Skenari i këtij filmi është shkruar nga Azem dhe Ymer Shkreli, dhe është i bazuar në një ditar lufte të Fadil Hoxhës, udhëheqësit karizmatik partizan nga Lufta e Dytë Botërore. Xhirimet e këtij filmi zgjatën mbi dy muaj. Faruk Begolli në këtë film luan Vetëtimën. Ky film ka pasur premierën në festivalin e Pulës, ndërkohë që është dhënë edhe si seri televizive në TVP-në e atëhershme. Ekrem Kryeziu tregon të ketë pasur jo pak telashe me “Faruk Begollin e lazdruar”, i cili herë-herë dinte të shkonte shumë larg me humorin e tij. Në një skenë dashurie, Vetëtima, personazhi që luhej nga Faruk Begolli, duhej të puthte një grua. Gjatë xhirimit, Begolli nuk pranonte ta bënte një gjë të tillë, para se ta bënte këtë vetë regjisori.

“Ti je regjisor dhe ti më trego praktikisht se si me e ba një gja të tillë”.

Megjithatë, as regjisori nuk mbetej mangut me “shejtanllëqe”. Në një mëngjes, teksa po bëheshin gati të fillonin xhirimet, diku në një fshat të Kosovës, Begolli insistonte që “ta xhironin”, ngaqë nuk dëshironte të priste. Këmbëngulja e Begollit i vie deri në maje të hundës regjisorit Kryeziu. Ai, pa një pa dy, vendos ta “xhironjë” Begollin në një skenë, që nuk ekzistonte në skenar.

“Më pat hipë në tape të kresë. Aktorët i kisha afër vetes. Hajde, i thashë, Faruk, jepja bregut përpjetë. Ai ishte i veshur me tesha ushtarake. Me këpucë të rënda, me triko, bluzë ushtarake... me armatim”.

Begolli, natyrisht, e kishte përfillë urdhërin e regjisorit. Vrap i parë nuk “mjafonte”, prandaj skena duhej të përsëritej. Begollit, në atë nxehtësi, iu desh që disa herë të ngjitej deri në maje të kodrës dhe tek në fund, kur gati sa nuk e lëshuan këmbët, e pyet regjisorin “qysh doli skena”, për të marrë përgjigjen: “Shumë mirë doli, por nuk kam xhiruar fare”. Këtë lojë regjisori Kryeziu thotë ta ketë menduar jo për ta dënuar Begollin, por për ta disiplinuar nga lazdrimet.





Në dy filmat kosovarë "Era dhe Lisi" dhe "Kur pranvera vonohet" luanin rreth 100 aktorë, disa prej të cilëve studentë të Begollit, të cilët kishin kryer aktrimin në Shkollën e Lartë Pedagogjike. Mbas disa vitesh ky drejtim ishte ndërprerë.

Nana e Faruk Begollit kurrë nuk arriti ta kuptonte zanatin e të birit, të cilin ajo e quante si "zanat shejtani". Ëndrra e saj për kthimin e të birit me kohë u venit. Ajo i humbi të gjitha shpresat se i biri një ditë do t'i kthehej në Pejë, ngjashëm, ashtu siç kishte shkuar atë ditë me tren.

"Nana jeme kurrë nuk e pranonte atë që baja unë. Ndonjëherë, kur gratë tjera t'kojshive i thojshin: 'E pamë djalin tand mbramë dhe luajti bukur', ajo ndjehej paksa krenare, por kur i thoshin; 'e pamë në një film mbramë djalin tand tek puthej, kjo gja nuk e bante aspak t'lumtun nanën teme".

Begolli do të kthehej në Pejë për të xhiruar filmin "Si të vdiset", të regjisorit Miomir 'Miki' Stamenković. Disa skena nga ky film u xhiruan në shtëpinë e dajës së Begollit, Muharrem Pasha. Përpos Begollit, i cili luante rolin kryesor, në këtë film luajtën edhe: Xhevat Qorraj, Abdurrahman Shala, Xhevat Qena, Istref Begolli, Shani Pallaska etj.

Begolli në filmat e tij luante krahas aktorëve të njohur të asaj kohe, ndër të cilët edhe Rade Shrebexhija, Bata Zhivojnoviq, Olivera Katarina, Bekim Fehmiu etj. Për Bekim Fehmiun Begolli gjithmonë shprehej me shumë respekt. Në 70 vjetorin e lindjes së Bekim Fehmiut, Begolli në një intervistë në një gazetë lokale në Kosovë deklaroi:

"Ai është krenaria jonë, i vetmi artist ndërkombëtar për ne shqiptarët. Një aktor shumë i madh, një burrë shumë i mirë. E kam shok të mirë, kemi luajtur në disa filma bashkë".

Mbas viteve të 90-ta, kur Jugosllavia u kaplue nga turbullirat politike, Begolli kthehet përgjithmonë në Prishtinë. Angazhimet e tij në film vinin duke u rralluar. Filmi i fundit, që e luajti në Serbi, është "Bulevard Revolucije", i realizuar në vitin 1992. Në këtë film Begolli luan krahas mikut të tij, aktorit të njohur, Ljubisha Samarxhiq. Në të vërtetë, filmi i fundit që realizoi jashtë Kosovës është filmi sloven "Feliks", i regjisorit Bozhe Shprajca. Begolli në këtë film luan njërin ndër rolet kryesore. Në një intervistë të të mëvonshme, rreth angazhimit të tij në këtë film deklaroi:

"Kam qenë shumë i lumtur që kam luajtur në këtë film sepse më është kthyer shpresa se krijuesi mbijeton pavarësisht kësaj marrëzisë sonë të paparë ballkanike".



Mbas këtij filmi, ai luajti vetëm në video-filma kosovarë. Një prej roleve më të mira të tij në filmat kosovarë të para luftës është ai në filmin: “Dashuria e Bjeshtëve të Nemuna”, një film me skenarist dhe regjisor Ekrem Kryeziun. Në këtë film të popullarizuar asokohe, Begolli luan babanë e një vajze, e cila kthehet nga Amerika në vendlindjen e saj, dhe pastaj dashurohet në një djalë, me të cilin fatkeqësisht nuk mund të martohet, për shkak të lidhjes familjare që ka me të.

Mbas luftës, Faruk Begolli luan në disa filma të shkurtë të studentëve, por edhe në disa filma tjerë televizivë pa ndonjë peshë të madhe. Për “arsye profesionale”, siç i pëlqen të thotë, ai refuzon rolin kryesor në filmin “Syri magjik”, të regjisorit të njohur nga Shqipëria, Kujtim Çashku.

Filmi i tij i fundit artistik, në të cilin luan është: “Etjet e Kosovës”, i regjisorit të ri, Sunaj Raça. Gjatë premierës së këtij filmi në Prishtinë, publiku i duartrokiti gjatë paraqitjes së tij në ekran. Për shumëkënd, Faruk Begolli në këtë film ishte po ai Faruk Begolli i dikurshëm.

Faruk Begolli zë vend të merituar në kinematografinë ish-jugosllave dhe në atë kosovare. Madje, që të gjithë pajtohen në një pikë: Begolli me rolet e tij ka sjellë tek publiku një ngrohtësi dhe subtilitet të jashtëzakonshëm.

Begollin, si artist filmi, por edhe si njeri, Meli Qena e quan si “jashtëserik, të papërsëritshëm dhe të pa-konkurrencë”.

Isë Qosja vë në pah gjithashtu reputacionin që Begolli e kishte si aktor ndërkombëtar. Sipas Qosjes, në arenën ndërkombëtare Begolli është çmuar, sidomos mbas filmit të shkurtë: “Biografia e Ushtarit Shulc”, në të cilin film ai realizon një rol me një qasje tërësisht ndryshe nga ata të mëparshmit.

Por, për sa u përket roleve të dashnorëve romantikë, apo partizanëve “të dhimbshëm”, siç i quan vetë Begolli, Fadil Hysaj konsideron se rolet e tilla kanë qenë shumë të kërkuar nga vetë regjisorët, por edhe nga publiku.

“Në historinë e kinematografisë kanë qenë aktuale ato role të heronjve romantikë. Ky lloj filmi ka qenë shumë i kërkuar në atë kohë dhe në këtë aspekt mendoj se Faruk Begolli ka qenë aktor shumë i suksesshëm i kinematografisë çfarë ka ekzistuar atëherë”.


SHPËRBLIMET

Duket paksa paradoksale, por në krejt karrierën e tij të jashtëzakonshme si aktor filmi, Begolli merr shumë pak shpërblime e mirënjohje. Sado që, siç thotë ai, “as që m’bahet vonë për to”.

Në vitin 1972, në festivalin e filmit në Sopot, ai mori çmimin “Junak Kosmaja”, për rolin kryesor në filmin “Si të vdiset”.

Në Cele të Sllovenisë, në një festival regjional të mbajtur në vitin 1998, Faruk Begolli ka marrë çmimin për aktorin më të mirë të festivalit, për rolin në filmin “Dashuria e Bjeshkëve të Nemuna”.

Në vitin 1998, Fondacioni “Salbatring” nga Lubjana e nderoi Faruk Begollin me shpërblimin e vitit, për rolet e realizuara në kinematografi, si dhe për organizimin e jetës teatrore në Kosovë. Festivali studentor “Skena UP”, në vitin 2004, i ndau Begollit Çmimin Special. Shpërblimin ia dhuroi ish-Kryeministri i Kosovës, Bajram Rexhepi. Në Festivalin e 12-të të Filmit Shqiptar në Tiranë, ai shpërblehet me Çmimin “Aktori më i mirë” (roli dytësor). Ky shpërblim iu dha për rolin e tij në filmin “Etjet e Kosovës”.



PROFESORI

“KURRË NË JETË
NUK KAM DASHUR TË
BËHEM PROFESOR
E AS DREJTOR.
POR, U BËRA EDHE
PROFESOR E EDHE
DREJTOR.”

Profesori Faruk Begolli. Në fund të viteve të 60-ta, kur ishte në kulmin e karrierës si aktor filmi, i rrethuar nga fama dhe popullariteti, ai e nisi edhe një „udhëtim“ tjetër, krejt ndryshe nga puna që po bënte deri atëherë. Kurrë më parë nuk kishte menduar se një ditë do të mund të bëhej profesor. Në fakt, ishte profesioni që ai kurrë nuk e kishte dashur. Por, një takim në Beograd me shkrimtarin dhe publicistin Ramiz Kelmendi do të sjellë një kthesë të papritur në vizionin për të ardhmen dhe karrierën e tij. Ramiz Kelmendi i kishte propozuar që të kthehej në Prishtinë, të punonte me studentët në Shkollën e Lartë Pedagogjike, në Degën e Aktrimit, që pritej të hapej. Asokohe, në Prishtinë ekzistonte njëllloj studioje e aktrimit, e cila funksiononte brenda Teatrit Popullor Krahinor të Kosovës. Me studentët e asaj studioje punonte regjisori Sllobodan Popiq, që, sipas Begollit, ka shumë merita për teatrin kosovar. Popiq ishte regjisor i përhershëm në TPK. Në këtë studio, në të cilën pos Popiqit punonin edhe të tjerë regjisorë e aktorë, studentët mësonin nga disa lëndë, por në gjuhën serbe dhe kjo, sipas Ramiz Kelmendit, që po përpiquej ta bindte Begollin, ishte tejet paradoksale dhe e papranueshme, pasi sipas tij po krijoheshin aktorë gjysmakë.



Begolli, që sapo kishte përfunduar akademinë, ishte trembur nga ky propozim i Ramiz Kelmendit, i cili po i fliste me një ton patriotik, se hapja e kësaj shkolle aktrimi ishte e rëndësishme për shqiptarët.

„Unë i thoja se ‚nuk di gjë, se ‚nuk ia kam haber fare teorisë, se ‚krejt i kam bërë falë talentit, ndryshe nuk kisha mundur ta kryej as akademinë, e gjëra të tjera, por ai këmbëngulte. Ramiz Kelmendi është me të vërtetë njeri sharmant dhe unë e kam dashur e respektuar që prej fëmijërisë, por edhe në kohën kur ai punonte si gazetar“.

Ramiz Kelmendi kishte triumfuar. Shumë shpejt Begolli do të paraqitej para studentëve si profesor. Mbas pak, Studioja e Aktrimit e Teatrit Popullor Krahinor (TPK) ishte kthyer në Degën e Aktrimit brenda Shkollës së Lartë Pedagogjike. Kjo gjë ishte mundur falë veprimit të shkrimtarit dhe drejtorit të atëhershëm të TPK-së, Azem Shkreli.

ORA E PARË

Ardhja e Begollit si profesor në Prishtinë do të vlerësohet pozitivisht nga njerëzit e teatrit, por edhe nga njerëzit e zakonshëm. Prishtinës po i kthehej ylli i vet, bashk me shkëlqimin dhe famën e krijuar.

Ora e parë e mësimit dhe takimi me studentët Begollin do ta bëjnë të dridhet nga frika. Nuk po i ndihmonte talenti, akademia e kryer, fama... Asgjë nuk po i hynte në punë. Po dridhej. Për disa sekonda kishte mbetur i shtangur dhe krejt i trullësuar. Studentët, rreth 20 sa ishin, kishin krijuar një radhë të gjatë dhe po e prisnin idolin e tyre, të famshmin Faruk Begolli, që deri atëherë e kishin parë vetëm në filma.

“Fillova orën e parë... E di që jam dridhë nga frika, e studentët të gjithë më shikonin e qeshnin. Ishte hera e parë për ta që po e shihnin Faruk Begollin të ‘gjallë’, sepse në atë kohë unë veç kisha njëfarë fame, pasi kisha luajtur në katër a pesë filma, apo më tepër... Dhe, të gjithë ata më shikonin, e unë dridhesha.... Një kohë të gjatë, nuk e di sa, unë nuk dija se si t’ia filloja, çka të thoja... Ata më shihnin mua, unë ata, deri sa më ra ndërmend të ulem...”

Mbas orës së parë, ai do t’i rikthehet teorisë, duke i rilexuar edhe njëherë ato çka i kishte mësuar gjatë studimeve në Beograd: për aktorin e Stanislavskit, të Artosë apo të Elia Kazanit. Gjatë dy viteve të para do të lexojë libra teorikë për aktrimin dhe teatrin më shumë se ç’do të lexonte gjatë gjithë jetës.

“Kështu, prej këtyre përgatitjeve të mia, unë tashmë, kur vija para studentëve, gjysëm ore e më shumë mbaja ligjëratë, e askush nuk më kuptonte asgjë... E unë, i lumtur që po ‘di’, vija duke e rritur minutazhën e ligjëratave të mia... Por, ishin ligjëratat aq ‘interesante’ sa që shumica nuk më kuptonin, e disa nga fundi i bankave edhe flinin...”

Një fillim mjaft qesharak dhe shumë i ndryshëm nga mënyra se si ai do t’ua mësojë aktrimin studentëve njëzetë vjet më vonë: pak teori ose fare, por me shumë ushtrime e praktikë,

“Fillova orën
e parë... E di
që jam
dridhë nga
frika, e
studentët
të gjithë më
shikonin e
qeshnin”

pasi, sipas tij, studentët përmes praktikës vijnë tek konkluzionet e teorive.

Disa nga studentët e gjeneratës së parë dhe të dytë të Degës së Dramës në Shkollën e Lartë Pedagogjike, si: Enver Petrovci, Kumrije Hoxha, Bajrush Mjaku, Selman Jusufi, Drita Krasniqi, Skender Tafa, Avdush Hasani, Luan Daka, Fadil Hysaj dhe të tjerë, më vonë do të jenë themeli i teatrit dhe i kinematografisë kosovare. Në filmat e ardhshëm kosovarë këta studentë do të luajnë përkrah tij, disa prej tyre me mjaft sukses. Ata realisht do të përbëjnë edhe trupën e ardhshme të Teatrit Popullor Krahinor të Kosovës. Enver Petrovci mandej do të mbarojë edhe akademinë për aktor në Beograd dhe do të bëhet një prej aktorëve më të njohur të teatrit në Beograd. Bajrush Mjaku, poashtu, do të bëhet aktor shumë i kërkuar dhe me nam. Fadil Hysaj do të vazhdojë studimet për regji dhe teatrologji në Sarajevë, prej ku do të kthehet pastaj në Kosovë për t'u bërë një prej regjisorëve më në zë të teatrit në Kosovë. Hysaj tregon se sa ndikim ka pasur në ta si studentë profesori Faruk Begolli.

“Relacioni i tij me ne si studentë mund të them se është pjesa më mbresëlënëse e asaj rinisë tonë, që ka ngjallë një entuziazëm fanatik për teatrin dhe një ambicie shumë të shëndoshë që të bëhemi aktorë të mëdhenj... Ka kërkuar prej nesh ta kultivojmë kultin e punës dhe përkushtimin ndaj profesionit. Krejt kjo për ne ka qenë pak si befasuese, sepse ne atëherë Begollin e kemi parë si një aktor filmi paksa i lazduar... Ka pasur një kontrast me imazhin që ne kemi pasë për të dhe me atë që në fakt kemi gjetë te ai: nuk është toleruar vonesa, nuk është toleruar mosrealizimi i detyrave, por është vlerësuar puna e mirë e studentit... Ne kemi zbuluar në vetvete energji të pashtershme. Shpesh kemi ndejtë gjithë natën në skenën ku ushtronim, në Shkollën e Lartë. Ne, 6 studentët, kemi jetuar si një familje e re gjashtë anëtarëshe, ku tema e vetme ka qenë çka do të sjellim nesër në orën e aktrimit.”


Në fund të viteve të 80-ta, iniciativa e hershme për çeljen e Degës së Artit Dramatik brenda Fakultetit të Arteve ishte ripërtëritje sërish, dhe kjo me insistimin e piktorit Muslim Mulliqi dhe të kompozitorit Bashkim Shehu.

Hapja e Degës së Artit Dramatik po bëhej në një kohë tepër të nevojshme, ndoshta kritike, mbasi kishte nisur të ndihej mungesa e aktorëve të rinj. Ndihej nevoja për ripërtëritje. Kuvendi i Kosovës, mbas dy apo tre vite tentimesh, më në fund, kishte aprovuar kërkesën dhe kështu, në vitin 1989, kishte hapur Drejtimin e Aktrimit, që më vonë do të pasohet edhe me hapjen e drejtimeve të tilla, si: Regjia e Teatrit, Dramaturgjia dhe pastaj edhe Regjia e Filmit.

Shkëlzen Maliqi thotë se kthimi i Faruk Begollit në Prishtinë ka qenë një prej gjesteve dhe ndërmarreve më të rëndësishme që do të ndikojë në kahen e zhvillimeve në kulturë në Kosovë, në vitet dramatike të dy dekadave të fundit të shekullit XX.

“Me përkushtimin dhe profesionalizmin e tij Faruku bëhet njëra prej shtyllave të rezistencës kulturore dhe shpirtërore të kosovarëve ndaj pretendimeve asgjësuese të regjimit serb”.

Hapja e degës së aktrimit ishte një gëzim për të gjithë e posaçërisht për ata të rinj që po synonin botën e filmit dhe të teatrit. Faruk Begolli e kishte barrën kryesore për të konsoliduar ekipin e profesorëve.



“Kur e formuan Degën e Aktrimit, unë e luta aktorin tonë me nam, Bekim Fehmiun, që ta merrte udhëheqjen, ndërsa unë të mbetesha asistent i tij, por ai nuk pranoi. Atëherë unë bëra ligjërues pa thirrje universitare. I gjetur në këtë situatë, iu drejtova kolegut më të ri, Enver Petrovcit, ish studentit tim të dikurshëm, që ai të vinte dhe të punonim së bashku. Shpjegimet që ia bëja unë Enverit ishin si ato që mua m’i kishte bërë dikur Ramiz Kelmendi, kur po më bindte të vija të punoja si profesor. Enver Petrovci e pranoi ftesën time dhe, që nga ajo kohë e deri më tash, jemi së bashku në fakultet.”

Në provimin pranues të gjeneratës së parë të studentëve ishte lajmëruar një numër i madh kandidatësh, mbi njëqind e pesëdhjetë veta. Dhe ata ishin shumica njerëz që me të vërtetë e donin aktrimin. Studentët e pranuar të gjeneratës së parë ishin me fat. Begolli mendon se ajo ka qenë gjenerata më e suksesshme, meqë, sipas tij, kanë punuar me një disiplinë të jashtëzakonshme. Shumë nga aktorët e kësaj gjenerate sot janë krijuar aktivë dhe shumë të suksesshëm në teatër, në film apo si mësimdhënës në Fakultetin e Arteve.

Asokohe, Faruk Begolli udhëtonte nga Beogradi për të mbajtur mësim me klasën e tij. Vinte me kënaqësi dhe ndihej krenar që ishte profesor i asaj gjenerate aq të suksesshme, e cila po punonte me aq zell dhe me aq ngulm.


Në mungesë të kuadrit pedagogjik, Begolli, përpos aktrimit, ligjëronte edhe lëndët tjera. Ai thotë se shpesh i ka zëvendësuar edhe profesorët që mungonin.

Me gjeneratën e parë kishte filuar të punonte edhe Enver Petrovci, i cili veç kishte krijuar një karrierë të suksesshme. Në gjeneratën e parë Petrovci ligjëronte diksionin, ndërkohë që në vitin e dytë ai do ta ketë klasën e tij. Begolli, gjithashtu, lavdëron edhe gjeneratën e dytë të aktorëve, që kishin punuar nën drejtimin e Petrovcit.

Më vonë, grupit të vogël të profesorëve i shtohet edhe Abi Nokshiqi dhe disa profesorë të tjerë. Dukej se gjithçka po ecte si është më së miri. Megjithatë, asokohe, disa nga lëndët mbaheshin në gjuhën serbe dhe studentët kishin mjaft vështirësi. Duhet thënë, gjithashtu, se, në fillimet e saj, Dega e Aktrimit në Prishtinë kishte pasur një përkrahje dhe ndihmë të madhe nga Fakulteti i Dramës në Beograd. Vështirësitë dhe pengesat e vogla të atij fillimi mbuloreshin nga vrulli dhe entuziazmi i të gjithëve, sado që, siç thotë Begolli, ai entuziazëm i fillimit kishte ardhë duke u zbehur në gjeneratat e ardhshme. Fatkeqësisht, ngjarjet politike që do të pasojnë në atë kohë do të kenë ndikim të jashtëzakonshëm në punën e studentëve aktorë.

Mbas tri viteve punë të suksesshme, regjimi i atëhershëm serb i dëbon nga fakulteti, ashtu siç i largon të gjithë studentët tjerë shqiptarë nga objektet tjera universitare. Për shkak të bashkëpunimit dhe lidhjeve të krijuara, Dekanati i Fakultetit të Arteve në Beograd dhe sidomos profesorët e Degës së Dramës do të protestojnë dhe do të kërkojnë që ky vendim i pushtetit të shqyrtohet. Megjithatë, kjo protestë nuk do të ndihmojë dhe Begolli bashkë me kolegët e tij do të kërkojnë zgjidhje alternative.

Mbas pak muajsh, Dega e Aktrimit do ta vazhdojë punën në një objekt të braktisur, afër Fakultetit Ekonomik. Ndërtesa ku mbahej mësimi ishte e shkatërruar totalisht dhe nuk kishte as dyer e as dritare. Ishte, siç thotë Begolli, si një “nevojtoare publike”. Aty do të



punohet me muaj të tërë dhe do të pranohen edhe dy gjenerata të tjera. Megjithatë, mbas shumë muajve punë, detyrohen të largohen edhe nga aty, mbasi, një ditë, regjimi serb e kishte rrënuar tërësisht ndërtesën ku ata po mbanin mësim. Faruk Begolli është shumë krenar që në ato rrethana ia ka dalë të punojë me studentët dhe të ketë rezultate.

“Nga kjo distancë, kur i tregon ato ngjarje, të duket se megjithatë ‘ke bërë diçka’, se nuk je dorëzuar... Na dukej se jemi duke bërë diçka kundër atij regjimi, na dukej se po bënim njëloj proteste... Vetë ajo punë dhe diciplinë e studentëve nënkuptonte mosgjunjëzimin ndaj pushtetit, ishte njëfarë filozofie kundër nënshtrimit.”

Nga gjenerata e parë në vitin 1989 e deri më tani kanë diplomuar mbi 15 gjenerata aktorësh. Përpos punës si profesor, me studentët e tij Begolli gjithmonë ka punuar edhe në skenë, si regjisor. Ai ka preferuar që etydet dhe ushtrimet shkollore t'i ripunojë dhe t'i nxjerrë në skenë për publikun e gjerë. Por, natyrisht, si regjisor Begolli do të punojë edhe drama të autorëve të njohur si Jonesko, Dario Fo etj. Numerikisht, janë mbi tridhjetë regji, edhe pse Begolli asnjëherë nuk e quan veten regjisor.


„Nuk kam pasë dhe nuk kam kurrfarë pretendimesh që të bëhem regjisor. Unë jam aktor dhe i tillë do të mbetem deri në fund.”

Angazhimin e tij si regjisor ai e arsyeton me nevojën e studentëve për të luajtur në skenë. Regjia e tij, siç thotë ai, ka qenë gjithmonë në funksion të lojës së aktorëve dhe qëllimi ka qenë që të nxirret në pah talenti dhe kreativiteti i studentëve. Shumica e këtyre shfaqjeve, sipas Begollit, janë realizuar për shkak të nevojës së studentëve.

E veçanta e punës së tij me studentë është padyshim mënyra se si ai lidhet emocionalisht me ta. I konsideron si fëmijët e tij dhe i trajton po në atë mënyrë. Nismëtar dhe themelues i Degës së Aktrimit, profesor emblematic i kësaj dege, ai pjesën kryesore të kohës do t'ua kushtojë studentëve aktorë, gjegjësisht trajnimin të tyre. Regjisori Ekrem Kryeziu thotë të mos njohë një profesor tjetër më të përkushtuar, më të dashur për studentët se sa Faruk Begolli. Ndërsa ish studenti i tij, aktori Armond Morina, thotë se Begolli i trajton të gjithë njësoj dhe se ai kurrë nuk bën dallime ndërmjet studentëve. Shkëlzen Maliqi mendon që Faruk Begolli në punën me studentë është treguar inteligjent, mbasi, falë përvojës së madhe që ka pasë dhe jo për shkak të ndonjë përgatitjeje teorike, ai ka aplikuar metodën e punës të përqendruar në aktorin, në mësimin e individualizuar.

Begolli si profesor, me studentë është i drejtpërdrejtë dhe insiston nga ta të punojnë dhe të hulumtojnë.

“Me studentë nuk kam pasur vetëm raporte pedagogjike, por edhe prindore. Kur ata s studentë, ata fëmijë, sepse ata janë si fëmijët e tu, arrin t'i njohësh mirë, t'ua zbulosh shpirtin dhe mendjen, atëherë mund të priten rezultate... Pra, duhet të arrihet një shkallë e lartë e intimitetit në raportet me studentët, që ata të të besojnë... Nëse nuk krijohet kjo lidhje, atëherë aty do të ketë pak rezultate... Puna kryesore e një pedagogu është që studentit t'ia zhvillojë atë që ekziston në brendinë e tij, që është pjesë e shpirtit të tij... Sepse të gjithë studentët kanë botëra të ndryshme, dikush është melankolik, dikush ka komplekse, dikush ka turp... Njerëzit mendojnë se aktorët janë të paturpshëm, por kjo nuk është edhe gjithaq e saktë. Aktorët kanë turp, e sidomos kur janë në fillim. Dhe, edhe kjo është një punë për pedagogun, se si t'i ndihmojë stu-



dentët që të krijojnë vetëbesim, të mos kenë frikë në skenë, të mos kenë turp... Aktori zhvillohet si lulja, fillon nga rrënjët, trungu, fletët dhe aromën e nxjerrë më vonë..."

Ndonjëherë, kur studentët nuk veprojnë konform kritereve të tij, që natyrisht, synojnë zhvillimin e tyre si aktorë, Begolli di të bëhet edhe i 'ashpër'. Para disa vitesh, njëerës nga gjeneratat e aktrimit ai do t'i kërkojë ta përsërisë vitin. Studentët, të hidhëruar nga ky veprim, vendosin të "luftojnë", mbasi konsiderojnë se vendimi i profesorit që ata të përsërisnin vitin ishte i padrejtë. Ata shkruajnë një "letër ankese", të cilën ia drejtojnë drejtuesve të fakultetit. Dhe, natyrisht, për të sfiduar këtë vendim të profesorit, ata gjenin argumentet e tyre për rigozitetin e tij. Megjithatë, Begolli nuk zbrapset nga vendimi i tij për të ngulur tërë klasën e aktrimit. As lutjet e studentëve dhe as të drejtuesve të fakultetit nuk po e bënin të ndërrojë mendje. Ai qëndronte pranë vendimit të tij, të cilin thoshte se e ka marrë për të mirën e studentëve.

Megjithatë, asokohe ai qe prekur shumë nga kjo letër e studentëve të tij, të cilëve do t'u kundërpërgjigjej me një letër tjetër. Titulli i letrës ishte: "Letër përshëndetëse" dhe në të, veç tjerash, shkruante:


"Të dashurit e mi! ...E thatë se qëllimi juaj është të jeni sa më të mirë në skenë. Por, ky ka qenë edhe qëllimi im, të jeni sa më të mirë në skenë, të bëheni të mëdhenj në skenë... Çdo fitore juaja, çdo triumf juaji në skenë është edhe fitore dhe triumf imi... Secili vend ka kushtetutën që duhet të përfilllet, pasi është baza e asaj shoqërie. Kështu është, apo jo?! Por edhe ky zanat yni ka disa rregulla që duhen përfillur. Kanë ekzistuar që nga antika, e vazhdojnë të ekzistojnë edhe sot, kodet dhe rregullat që bashkë krijojnë atë që mund të quhet 'etikë e aktorit'. Por, jo vetëm etikë e aktorit, por edhe e studentit dhe e pedagogut. Secili profesion ka kodet dhe ligjet e veta, pa të cilat ai nuk mund të funksionojë. Që në orën e parë kur jemi takuar ju kam thënë se aktrimi është 'veprim', është 'aksion'. Por, për të vepruar dhe për të kryer një aksion, duhet punë, duhet përgatitje. E puna dhe përgatitja kërkojnë kushte dhe rrethana, kërkojnë seriozitet, kërkojnë durim dhe shumëçka tjetër. Pa këto cilësi 'veprimi' në skenë nuk mund të dalë i plotë, nuk mund të dalë bindës... Kjo është rruga për të suksesi, kjo është rruga për të mbetur gjatë në skenë..."

Begolli njihet si profesor rigoz dhe „i pashpirtë“ për sa i përket pranimit të studentëve jashtë atyre rregullave institucionale dhe profesionale. Shumë studentë, duke e ndjerë rrezikun nga konkurenca e madhe, përpiqen të gjejnë kanale të tjera për t'u pranuar në Degën e Aktrimit, duke përdorur lidhjet familjare apo edhe duke dhënë rryshfet. Në vitet e para si profesor, Begolli thotë të ketë pasur oferta të shumta, të cilat mandej janë zhdukur me t'u kuptuar se ai (Begolli) nuk është njeri i pazareve të tilla.

„Zakonisht ka intervenca shumë. Në fillim, kur u hap Dega e Aktrimit, filluan plot intervenca, por mandej nuk kan guxue, mbasi e kanë kuptue që unë nuk jam njeriu i duhun. Në vitin e parë ma patën premtue një mercedes. Sidomos mbas lufte kam pasë shumë presione. Më thoshin se, nëse nuk e pranoj këtë ose atë, do të më mbysin... Por, të gjithë e dinë që nuk ka intervenca te unë..."



Aktori Armond Morina tregon se, menjëherë mbas lufte, deri sa po rrinin në një kafene me Begollin, një burrë kishte ardhur në tavolinën e tyre dhe u kishte lënë një letër, në të cilin, siç duket kishte qenë i shkruar emri i një kandidati që ata do të duhej ta pranenin si student të aktrimit.



“Begolli, pa e lexuar fare emrin, e ndrydhi letrën dhe gjuajti. Madje as nuk pranoi të flasë me atë burrin... Ai burri mandej është kërcënuar. Unë i thosha Begollit: pse nuk po i çon këta njerëz në polici, por ai nuk dëshironte të merrej me gjëra të tilla. Nëse ndonjë kandidat ka intervenuar te Begolli, ai, në provim pranues, para të gjithëve i ka thënë: ti ke intervenu, a? la ka marrë fytyrën para të gjithëve...”

Sipas Begollit, povimi pranues i aktrimit është shumë subjektiv dhe shumë vështirë është të bëhet selektimi i më të mirëve, pavarësisht njëanëshmërisë dhe pavarësisht përpjekjeve për të zgjedhur më të mirët.

“Kush e di sa njerëz i kam shpëtu që nuk i kam pranue, po edhe kush e di sa talentët i kam refuzue... Një vit më erdhi një student në provim pranues me një monolog të Ofelisë së Shekspirin. Kur e pyeta se pse nuk e ke marrë Hamletin po Ofelinë, ai më tha: ‘Nuk e kam e gjetë Hamletin kërkund’”.



Studimet janë rruga, njëfarë kanalizimi i dijes së studentëve dhe njëfarë orientimi se si të vihet deri tek dija. Për Begollin kënaqësia kryesore mbeten provat, sepse aty mund të hulumtohet, mund të kërkohet...

“Se mandej, kur del me e dhanë shfaqjen, aty fillon trema, emocioni... s`din ku je... Je si në kllapi... Nuk din çka ke ba... Disa të përqaftin e ti nuk e din pse... Provat për mue kurrë nuk kanë qenë torturë, veç kënaqësi... Po flas për provat si aktor, por edhe si regjisor...”

Gjatë këtyre shumë viteve pune si profesor aktrimi në Fakultetin e Arteve, në Prishtinë, Faruk Begolli ka krijuar reputacionin e një profesori principiell dhe jo oportunist. Në njërin nga mbledhjet e Degës së Artit Dramatik, brenda fakultetit, kur po shqyrtoheshin kandidaturat e të nominuarve për profesor të ardhshëm në këtë katedër, Begolli, i ndodhur përballë „dallaveve” që po gatuanin disa nga kolegët e tij, jep dorëheqje të parevokueshme nga të gjitha postet e deriatëhershme që mbante në fakultet, duke mbetur vetëm profesor. I revoltuar, ai e lëshon mbledhjen dhe kurrë më nuk do të marrë pjesë në asnjë nga mbledhjet që do të mbahen brenda fakultetit.



TEATRIT

“

Me vdekjen e shfaqjes të vdes edhe personazhi, të cilin ti si aktor e ke luejt... Të vdes një pjesë e jetës tande... Kjo asht e keqe për një artist, apo jo?”

I njohur dhe i pranuar si aktor filmi, Faruk Begolli do të ketë shumë pak kontakt me botën e teatrit. Megjithatë, kohë mbas kohe, ai do t'i kthehet teatrit dhe do të realizojë role të shkëlqyera. Karriera e tij në teatër, në të vërtetë, nisi shumë herët. Qysh kur Begolli ishte nxënës në shkollën e mesme, ai do të luajë në komedinë “Makaronat e shejtanit”, në regji të Kristë Berishës. Kjo histori teatri nga fëmijëria do të jetë si një zile shkolle që Begollin, kohë mbas kohe, do ta tërheqë nga bota e filmit drejt skenës së teatrit.

Mbas ardhjes nga Peja në Beograd, ku po studionte Xehtarinë, ai do të jetë publik i shpeshtë i shfaqjeve në teatrot e Beogradit, e vecanërisht në „Jugoslovensko Dramsko Pozoriste“, mbasi në atë teatër ishte i punësuar si aktor i rregullt kushëri i tij, aktori Istref Begolli.

“Çdo shfaqje e shikojsa, se e kisha pa pare. Pra, unë dashtë e pa dashtë, kam qenë çdo natë në teatër, se aty ishte Istrefi, po edhe ishte ma nxehtë... Edhe u kënaqsha tuj ndejtë në byfe me aktorë. Të gjithë e dinin se jam i afërt i Istrefit dhe më respektonin e më donin... Po në atë kohë nuk kisha ndonjë mendim të formuem se një ditë edhe vetë do të shkoj me u ba aktor.”


Më vonë, mbasi do të heqë dorë nga Xehtaria dhe mbasi do të studiojë për dy vite të tjera Ekonominë, ai do të kthehet sërish në Beograd, por tashmë i bindur se një ditë edhe vetë do të ngjitet në dërrasat e skenës së teatrit. Në vitin e parë të studimeve për aktor ai do të njihet edhe me Bekim Fehmiun, një aktor shqiptar i përmasave ndërkombëtare. Tashmë shkuarjet në teatër do të shpeshtohen dhe Begolli do të jetë gati çdo natë publik i shfaqjeve. Për të ishte e rëndësishme të shkonte në teatër. Pavarësisht që një shfaqje mund ta kishte parë 15 herë, atij i pëlqente të ishte afër Istref Begollit dhe Bekim Fehmiut.

Begolli që në vitin e dytë të studimeve do të nisë udhëtimin e tij në botën e filmit, kështu qi në teatër do të luaj rrallë, sado që do të ketë oferta nga të gjitha teatrot e ish



Jugosllavisë. Si student ai do të luajë në "Jugoslovensko Dramsko Pozoriste", por edhe në "Narodno Pozoriste", në Beograd.

Një prej roleve të tij të para të rëndësishme në teatër është Rozenkranci, në shfaqjen "Hamleti" të Shekspirit. Ndërkaq, në Kosovë për herë të parë luan në kino-shfaqjen "Ah Xho" të Beckett-it, në regji të Isë Qosjes. Partner në shfaqje ka ish studenten e vet, aktoren Kumrie Hoxha. Kjo shfaqje ishte punim final me të cilin do të diplomonte regjisori Qosja. Salla e ish Teatrit Popullor Krahinor (TPK) të Kosovës ishte e nxënë me provat e shfaqjes "Hamleti", kështu që provat për "Ah Xho" do të mbahen gjithkrah. Koncepti i regjisorit Qosja ishte mjaft i avancuar për kohën në të cilën po realizohej shfaqja. Mbase për herë të parë në ish Jugosllavi po kombinoheshin filmi dhe teatri dhe, realisht, muri ndarës mes këtyre medimeve ishte i shkrirë. Lojën në "Ah Xho" Begolli e konsideron si një përvojë interesante. Ai e çmon sidomos konceptin e regjisorit Qosja.



"Dramaturgjinë Isa e ka ba asisoji që ne, dy personazhet, hyjmë gabimisht nga filmi në skenë, bajmë një jetë aty, por pastaj na dëbojnë dhe ne ikim përsëri në film..."

Në fillim komisioni i profesorëve që duhej të vlerësonte punën e regjisorit student Isë Qosja do të jetë skeptik, por, mbasi e panë premierën, ata u mahnitën, sidomos nga koncepti se si po funksiononin bashkë filmi dhe teatri.

«Është interesant se Këshilli Artistik i TPK-së filloi të dyshojë në shfaqjen, në idetë e saj... Pasi e panë shfaqjen, ata mbajtën mbledhje dhe na thanë se kjo shfaqje duhet të shtyhet për një herë tjetër, pasi nuk është koha e ku e di se çka... Por ka qenë koha ashtu dhe unë e kuptoj atë gja... Se, realisht, shfaqja edhe pse ishte me metafora, me shenja, e ku ta di unë, disa gjana ishin mjaft të qarta dhe dihej se kujt i referoheshin... Atëherë unë dhe Isa thamë se nuk do ta jepnim në teatër, por para teatrit, aty nuk mund të na pengonin... Dhe me të vërtetë e patëm nda mendjen me e dhanë aty, para shkallëve të teatrit... Ishim me të vërtetë të vendosun. Por, pastaj ata lëshuan pe dhe gjithçka kaloi si duhet, shfaqja u dha me shumë sukses... U shkrua dhe u fol shumë... »

Regjisori i shfaqjes Isa Qosja thotë se Faruk Begolli, apo "çara", sic e cuan ai, është një aktor me reputacion evropian. Ai lavdëron modestinë e Begollit dhe profesionalizimin e tij në këtë shfaqje.

“ ‘Çara’ pranoi të hynte në bërlllog, në deponi të bërlllogut dhe të dalë para publikut nga aty... Ai hyri në bërlllog dhe përnjëherësh shpërtheu prej bërlllogut... Një aktor me reputacion evropian doli prej bërlllogut, pa komplekse... Komunikimi i tij me mua ishte sikur unë jam regjisor me eksperiencë të madhe e ai fillestar, ndërkohë që në realitet ishte e kundërta...”

Tek sa rrëfen se si kjo shfaqje është pritur pozitivisht nga kritika dhe njerëzit tjerë, Qosja tregon gjithashtu edhe për një “konflikt” të vogël me Begollin, që, megjithatë, nuk i ka prishur raportet midis tyre. Përkundrazi, është krijuar si një depozit për humor me njëri - tjetrin.

“Njëherë, gjatë punës në ‘Ah Xho’, e kam sha shumë ashpër ‘Çarën’... Nanën e nanës bre mashkulli i keq. Qeso meshkujsh ka gjithkrah, i thashë, por ai nuk asht hidhëru. Tash vonë ma ka përmendë me humor, por edhe studentëve u ka tregue”.



Mbas “Ah Xho” Begolli do të luajë edhe në disa shfaqje tjera të rëndësishme, si «Dervishi dhe vdekja», e autorit Mesha Selimoviq, në regji të Vladimir Milqinit. Në këtë shfaqje, pos Begollit do të luajnë edhe Abdurrahman Shala, Istref Begolli, Xhevat Qena, Bislim Muçaj, Drita Krasniqi etj. Ishte një ekip i zgjedhur me aktorët kryesorë që kishte TPK. Me këtë shfaqje, pas gati njëzet vjetëve, po kthehej në skenë Abdurrahman Shala. Në shfaqje, pos aktorëve, ishte edhe një grup balerinash polake. Ato nuk kishin fare tekst, por kishin vallëzime dhe shoqëronin skenat e “bohemit”, i cili luhej nga Faruk Begolli.

„Unë në këtë shfaqje e luejsa Hasanin, një bohem që rrinte gjithnjë i shoqnuem nga femnat. Aty asht vërtetë një skenë fantastike. Unë jam i shoqnuem me dy nga valltaret tuj ba qef. Hyn Nuredini (Istref Begolli) dhe mbasi i përzen dy shoqneset që ishin aty, fillon dialogun me mue, dhe aty nis tragjedia e të dyve...”

Kjo shfaqje do të prezantohet thuaja në të gjitha hapësirat e ish Jugosllavisë: në Novi Sad, në Lubjanë, në Sarajevë, në Beograd do të luhet në teatrin e njohor “Atelie 212”, në Zagreb e në shumë qytetete tjera. TPK asokohe ka pasur një ansambël të konsoliduar dhe niveli i produksioneve ishte shumë konkurrues me teatrot tjera në ish Jugosllavi.

Një shfaqje tjetër, në të cilën luan Begolli, është edhe “Bregu i pikëllimit”, me tekst të Teki Dërvishit, në regji të Vladimir Milqinit, që ishte një spektakël i jashtëzakonshëm me rreth 40 aktorë. Shfaqja zgjaste dy orë e njëzet minuta. Dhe pastaj, “Një varr për Boris Davidoviçin”, dramë e Danillo Kishit, në regjinë e Agim Sopit. Në një festival, në Novi Sad, kjo shfaqje do të marrë shtatë nga tetë shpërblimet e mundshme.

„I vetmi unë nuk mora shpërblim, mbasi në komisionin vlerësues ishte një ish profesor i imi. Profesori, duke e njohtë natyrën time, erdhi dhe më tregoi se me qëllim më kishte mënjanue, në mënyrë që të paktën një shpërblim të mbetej për ndonjanën nga shfaqjet tjera“.

Në vitin 1999, mbas përfundimit të luftës, Begolli qe zgjedhur kryetar i Shoqatës së Krijuesve të Teatrit të Kosovës, por dha dorëheqje nga kjo pozitë mbas një kohe të shkurtër. Dorëheqjen ai e pat arsyetuar me „dështimet e të gjithëve, përfshi edhe vehten“.

Begolli, përpos që ka bërë regjinë, ka pasur edhe një rol gati simbolik në shfaqjen emblematike të Teatrit „Dodona“ „Profesor... jam talent se jo mahi“. Në të ai luan rolin e Profesorit, i cili është në komision për selektimin e studentëve që do të pranohen në aktrim. Kjo strukturë do të mbetet përafërsisht e njëjtë në të gjitha 6 versionet e „Profesor...“ I rrethuar nga publiku dhe me tabllën e duhanit afër, ai do të komunikojë me aktorët në skenë.

Shkëlzen Maliqi thotë që ëshë mëkat që Begolli, në këto dy dekadat e fundit, nuk ka pasë më shumë mundësi që të sprovtojë dhe ridëshmojë talentin e tij prej aktori të madh, jo vetëm në film por edhe në teatër. Sipas tij, angazhimet e Begollit kanë qenë sporadike, sikundër që edhe projektet ku është angazhuar kanë qenë jo edhe aq ambicioze.



MBRETI LIR

Begolli do të bëjë një pauzë të gjatë para se të dalë sërish në skenë në vitin 2006. Për mbi 15 vjet ai nuk do të ngjitet të luajë në skenë. Jo pse nuk kishte oferta nga regjisorët, por sepse ashtu kishte zgjedhur. Në një intervistë në vitet e mbas luftës, ai do të deklarojë:

“...Unë nuk kam luajtur gati qe pesëmbëdhjetë vjet, por... Shpesh kur lexoj ndonjë dramë të mirë, gjej ndonjë personazh që më pëlqen, filloj të mendoj se do ta kisha luajtur kështu apo ashtu, se... Gjithmonë mendoj se do ta kisha luajtur mirë... Nuk flej atë natë... E dini, është përshtypja e parë prej veprës, takimi i parë me karakterin... Dhe, e bën një shfaqje, ta nxëmë, të mirë, apo edhe shumë të mirë, dhe ajo shfaqje nuk ka publik! Në këto rrethana, një aktor me eksperiencë, më besoni se e ka vështirë të luajë në teatër, të luajë para një salle të zbrazur... Kjo është ajo kryesorja, po kur i shtojmë edhe tjerat, jo nuk kam luajtur kaherë, jo kjo, jo ajo...”

Me këto dilema ai do të tundohet një kohë të gjatë. Nuk do të vendosë, sado që sytë i ka nga skena... Pret! Pret të ndryshojnë rrethanat, të vijnë kohëra më të mira për teatrin. Vitet kalojnë, por fatqësisht asgjë nuk ndryshon. Jeta teatrore vjen duke u ngrysur. Begolli rri dhe pret.

“Por, pavarësisht krejt këtyre gjërave, akoma nuk i kam thënë lamtumirë kësaj pune... Ende mendoj se do të vijë ai moment që do të luaj në skenë. Dhe ai moment duhet të vijë patjetër... Kjo dëshirë në artistin nuk vdes kurrë, përndryshe ai nuk do të ishte artist...”


Në vitin 2006, mbas disa netëve pa gjumë, mbas disa anktheve e mundimeve prej artisti, Begolli vendos t’i rikthehet teatrit. Regjisori Fadil Hysaj i ofron atë që shumëkush e quan si “mbreti i roleve”. Faruk Begolli si Mbreti Lir!

“...Më pat marrë malli me lujtë. Liri asht rol sfidues! Disa ditë kam mendue, nuk kam flejtë... Asht rol shumë i vështirë... Deri sa nuk e kam bindë vetveten që mundem me e ba. E mandej janë ato shkaqet tjera dytësore: le të më shohin këta studentë që qe sa vjet më kanë profesor e nuk më kanë pa duke luejt në teatër... Asht një rol i shkëlqyeshëm dhe unë kam dashtë me e pa veten se ku jam. Se një kohë të gjatë nuk kam lujtë në teatër... Bash sfidë ka qenë për mue... Sfidë deri sa nuk kam vendosë, por kur kam vendosë e kam ba me kënaqësi... »

Kthimi i Begollit në teatër pas gati 20 vitesh bëri një jehonë të jashtëzakonshme në shtypin dhe në mediat kosovare. Gazetat ishin të mbushura me tituj “Mbreti Lir, një emblemë për Faruk Begollin”, “Faruk Begollit i ka hije froni i Mbretit Lir”, “Kthimi i madh”...

„Për mua ‘Mbreti Lir’ ka dalë ashtu qysh e kam mendue. Se aty, në Teatër Kombëtar, vetëm me hy asht dëshpëruese... Aty veç me hy duhesh me i thanë vetes ‘Faruk, ik prej këtuhit..’ Një teatër i madh, i paorganizuem, pa kushte... Por krejt këto rrethana unë i kam fshi edhe me regjisorin jam mundue me e gjetë një vi për të cilën jemi përcaktue edhe atë vi me e realizue; pa u marrë me regjinë e shfaqjes, pa u marrë me ansamblin, pa u marrë me... Me kërkend nuk jam marrë... E kënaqësinë e kam gjetë... Se provat janë për artistin; hulumton, ke probleme, nuk të shkon këtë ditë, nuk di se si me e zgjed-

...ti do të jesh Liri në
skenë, por vuajtjet e Lirit do
t'i bartësh edhe në jetë...



hë këtë skenë, s'din qysh me e thanë këtë mendim, s'din qysh me i nxjerrë raportet me partnerët... Prandej, teatri e ka këtë kënaqësi që ke prova, dhe gjatë kësaj kohe asht një rrugë hulumtuese, fillon krejt ndryshe dhe vjen te diçka krejt tjetër, pra asht diçka ku e sheh zhvillimin tand si aktor... Çdo provë e kam pasë kënaqësi... Reprizat mandej nuk i kam kënaqësi... Por, reprizat janë çmimi i kënaqësisë që ke gjatë provave..."



Për shumkë kthimi i Begollit në skenë ishte ngjarje e vitit. Begolli u kthye në skenë me atë energjinë e dikurshme, me përgjegjësinë e jashtëzakonshme dhe solli para publikut një lojë të shkëlqyer. Një kthim triumfues dhe një dhuratë e jashtëzakonshme për publikun kosovar, për të gjithë ata që ka herë shpresonin ta shihnin Begollin në skenë. Aktori Armond Morina, që luan në shfaqje, e konsideron veten me fat që i është dhënë rasti të luajë në një shfaqje përkrah profesorit Faruk Begolli. Ai thotë që këtë gjë e ka pasur si një ëndërr jetësore. Ndërsa regjisori Fadil Hysaj e quan përvojën me Begollin si të jashtëzakonshme. Ai thotë se jeta e Faruk Begollit dhe ajo e Mbretit Lir të Shekspirit është e ngjashme në shumë plane.

“Begolli asht Liri në tana planet. Krejt jeta e tij, mënyra se si jeton, asht si e Lirit. Begolli asht një njeri që ka pasë një mbretni, të cilën ia kanë shpërdorue në të gjitha aspektet... Ekziston një analogji mes Faruk Begollit dhe Lirit. Begolli asht njeri që u ka besue shumë njerëzve që iu kanë ofrue, një njeri që e ka nda në mënyrë shumë jo të drejtë mbretinë e tij. Ky asht njeri që nuk ka asgja mbas vetes, përpos vetveten... Unë mendoj që te “Mbreti Lir” Begolli ka ba një lojë të shkëlqyeshme. Jam mundue me e krijue një Lir që veç ekziston në Faruk Begollin, jo me e krijue prej Begollit një Lir të ri.”

“Mbreti Lir” pati disa repriza të suksesshme në Kosovë si dhe mori pjesë ne Festivalin Ndërkombëtar - MESS në Sarajevë. Kthimi në Sarajevë, ku ai kishte jetuar dhe punuar gjatë, do ta emocionojë Begollin.

“Ishte një përjetim që mbahet mend, që nuk do ta harroj kurrë, një përjetim jo i lehtë. Natyrisht, nuk e takova Shibu Krvavcën e as Mirzu Idrizovcën, të cilëve me siguri u asht copëtue zemra prej asaj që ka ndodhë në Sarajevë. Nuk e takova as Davor Popoviqin, të cilin e kam pasë shok të mirë. Por, erdhën shumë shokë të tjerë, të më shohin mua si Faruk dhe mua si Lir.”

“Mbreti Lir” u hoq nga repertori i Teatrit Kombëtar në Prishtinë mbas pak reprizave. Begolli nuk u ngjit më në skenë mbasi shëndeti i tij u rëndua. Dukej sikur një kusht i heshtur që Liri i kishte kërkuar Begollit: ti do të jesh Liri në skenë, por vuajtjet e Lirit do t'i bartësh edhe në jetë...

MBRET NË NJË MBRETERI TE VOGËL- TEATRI “DODONA”

“

Unë jam veç aktor dhe i tillë do të mbetem deri n'fund.

“

Një zyrë pune në katin e dytë, e cila, në të vërtetë, më shumë i ngjante një magaze të zakonshme. Zyra e tij e vërtetë ishte në byfenë e vogël, në hyrje të Teatrit “Dodona”. Ajo kthinë e vogël ishte mbretëria e tij. I rrethuar vazhdimisht nga artistë të rinj dhe nga kolegë, ai humbej në tymin e duhanit dhe në avullin që lëshonin gjygymat e çajit. Aty e gjeje sidomos mbrëmjeve, para shfaqjeve, që zakonisht fillonin në 19:30, e sidomos mbas shfaqjeve, kur të tjera ‘shfaqje’ fillonin, por tashmë jo në sallën e teatrit, por aty, në byfenë e vogël. Fillimi i ndejave të vona aty niste zakonisht me një rreth të gjerë njerëzish, ndërsa më vonë ai rreth vinte dhe ngushtohej në katër, tre, dy... Begolli shpesh mbetej edhe i vetëm me ndonjërin nga punëtorët e byfesë, i cili duhej të vazhdonte t'i shërbente dhe, krejt në fund, edhe ta voziste deri në shtëpi, nëse për këtë gjë i mbushej mendja “mbretit”. Byfeja e teatrit ishte ajo ‘foleja’ ku Faruk Begolli ndiente dhe ushtronte pushtetin e vet prej artisti. Në atë kthinë të ngushtë, që shpesh mjegullohej nga tymi i duhanit dhe dendësohej nga era e rakisë dhe e mezes, Begolli u jepte frymë ideve fillestare për shfaqjet që i realizonte.





„Pa raki kurrë nuk ka. Raki, alkool e shoqni... Alkoolin e kam pasë sikur ajo puna e fëmive, kur ju thue: kryene këtë detyrë e mandej ju japim çokollata. E edhe k'to farë ndejash kanë qenë si pjesë përcjellëse e punës... Se, për shembull, atë ditë, kur luan mirë dhe je i kënaqun me vetveten, duhesh me festue. Por, edhe kur luen keq dhe nuk je i kënaqun me vetveten, prapë... Unë rakinë kurrë nuk e kam pasë nevojë. Gjithmonë ka qenë element i jetës së mirë, e edhe i kënaqësisë, por jo kurrë si nevojë... Edhe kurrë organizmi im nuk asht mvarë prej alkoolit“.

Në zyrë ngjitej rrallë, tepër rrallë, ndërsa punët zakonisht i kryente në byfe. Këto, natyrisht, nuk ishin punë zyrtarësh; shkrime me makinë apo kompjuter, korrespondencë me politikanë apo njerëz tjerë, madje ai nuk kishte të bënte me numra, e as që bënte raporte e kërkesa... Jo, qeverisja e tij ishte e thjeshtë, madje, tepër e thjeshtë, asofare çfarë dinë të bëjnë vetëm artistët.

Melihate Qena, e cila Begollin shpesh e shoqëronte në ndejat deri natën vonë, thotë që Begolli “Dodonën” e ka pasur më shumë sesa shtëpi.

Ndërsa, regjisori Isa Qosja gjen një analogji midis rolit, që Faruk Begolli ka luajtur në shfaqjen e tij “Ah Xho” dhe Faruk Begollit si njeri, dhe si drejtor në Teatrin “Dodona”.

“Personazhi që ‘Çara’ e luajti në ‘Ah Xho’, njeriun e humbur, njeriun me leckë, i pëlqeu shumë; edhe si pamje e edhe si gjendje emocionale. Dhe, ajo e shpjegon në një mënyrë atë njeri: mondanizmi, sallonizmi, fraku, ekstravaganca nuk i përkisnin Faruk Begollit. Atij i pëlqeu ajo që ai luajti në ‘Ah Xho’. Leckat, shpirti i grisur, i pëlqeu përhumbja... Kështu që, kjo e shpjegon ‘Çarën’ në një mënyrë, sado që ai ishte njeri i shkëlqimit, njeri të cilin e adhuronin pikërisht nëpër sallone dhe ndeja të rëndësishme. Por, ai dëshironte një jetë tjetër... Prandaj, edhe ‘Dodona’, e atillë çfarë ishte, një teatër i ‘lecosur’ simbolikisht, i ka pëlqye”.

Historia e kësaj mbretërie teatri është mbase një prej historive më të veçanta të teatrit në botë. Pjesën kryesore të kësaj historie e ka krijuar Faruk Begolli, me të cilin shpesh edhe identifikohet ky teatër. Në ato rrethana, okupimi e dhune të viteve '90-të në Kosovë, një teatër i vogël në margjina të qytetit të Prishtinës ishte krijuar si një oazë kulturore që sfidonte erën e fortë të barotit dhe të tymit lotsjellës.

Teatri i të Rinjve, Fëmijëve dhe Kukullave, ishte themeluar si trupë teatri në vitin 1986. Gjashtë vjet më vonë, në vitin 1992, në Prishtinë, kjo trupë do të vendoset në objektin e sapondërtuar, që më vonë do të njihet si Teatri “Dodona”. Në këtë teatër, përpos skenës për fëmijë, funksiononte edhe skena e mbrëmjes, ku jepeshin shfaqje për të rritur.

“Regjia jeme
n’ato shfaqje
ka qenë
n’funksion
t’plotë të
lojës së
aktorëve”

Enver Petrovci, një aktor i famshëm kosovar, pak kohë mbasi ishte emëruar drejtor i Teatrit “Dodona”, ishte detyruar të largohej, si rezultat i masave të dhunshme, si qeheshin asokohe masat që pushteti serb ndërmerre mbi institucione e individë, gjithandej Kosovës. Pak ditë para këtyre masave, teksa po e ndiente rrezikun e largimit, Petrovci kishte bërë një marrëveshje thuaja të heshtur me Faruk Begollin, në bazë të së cilës firmës së Begollit, FTD, i jepej me qira skena e mbrëmjes. Një kontratë fiktive, e nënshkruar në shpejtësi, kishte vulosur për të mirë fatin e këtij teatri. Faruk Begolli gati piratërisht ishte caktuar sovran i këtij teatri.

Ndërkohë, disa qindra metra më tutje, Teatri Kombëtar i Kosovës ishte spastruar pothuaj krejtësisht nga artistët shqiptarë, ndërsa menaxhimi i tij kishte kaluar në duart e serbëve të regjimit të Millosheviqit.

“Meqë n’atë kohë unë kisha themelue një firmë private - FTD-në, për teatër dhe dizajn, - unë e pata ba një kontratë fiktive me Enver Petrovcin, përmes të cilës ju mundësue FTD-së që të jepte shfaqje në skenën e mbramjes. Ndërsa, Enver Petrovci me atë marrëveshje krijoi një lloj ‘mbulese’, me të cilën do të mund të arsyetohej, në rast se akuzohej nga regjimi... Kjo kontratë mundësoi vazhdimësinë e punës së Teatrit ‘Dodona’.

Shfaqjet e ardhshme në skenën e mbrëmjes do të jenë prodhim i FTD-së, e cila Teatrit “Dodona” i paguante 20 % të të ardhurave nga shitja e biletave. Përpos shfaqjeve, skena e mbrëmjes shfrytëzohej edhe për provime të studentëve, të aktrimit dhe të regjisë së teatrit.

Shumica e aktorëve, të cilët luanin në skenën e mbrëmjes ishin studentë të aktrimit. “Dodona” ka qenë si njëllonj punëtorie për krijimin e përvojës së parë të aktorëve dhe regjisorëve të rinj, të cilët shkolloheshin në Fakultetin e Arteve. Për mungesë të buxhetit, shumica e shfaqjeve në këtë teatër kanë pasur skenografi tejet të varfër, ndërsa kostumet për shumë shfaqje janë përgatitur nga vetë aktorët.

Përballë asaj suate, Begolli, deri atëherë i njohur si aktor dhe si profesor teatri, filloi të bëjë edhe regji shfaqjesh. Më vonë, ai asnjëherë nuk do ta pranojë se këtij ‘zanat’ i ka hyrë për shkak të kredos artistike, porse “nga nevoja që studentët e aktrimit kanë pasur për të luajtur në skenë”. Ky shpjegim natyrisht duket shumë bindës.

“Regjia jeme n’ato shfaqje ka qenë n’funksion t’plotë të lojës së aktorëve. N’ana shfaqjet unë kam ba përpjekje me nxjerr n’pah jo kreativitetin tem si regjisor, por talentin e aktorëve. Krejt ato shfaqje i kam ba për shkak t’nevojës së studentëve të aktrimit”.

Shfaqjet në këtë teatër janë punuar me minimum buxhet ose edhe pa kurrfarë buxheti. Për ato mbi dhjetë vite punë në Teatrin “Dodona” Begolli bëri regjinë e rreth tridhjetë shfaqjeve.



“Edhe pse kam realizue rreth 30 shfaqje, unë nuk i them vetes regjisor. Nuk kam pasë dhe nuk kam kurrfarë pretendimesh me u ba regjisor”

Gjithsesi, nëse ndjekim mendimet e kritikës për këto shfaqje, shohim se disa nga regjitë e Begollit nuk kanë kaluar pahetueshëm, madje janë vlerësuar dhe cilësuar si të arrira.

Disa nga shfaqjet, që kanë për regjisor Begollin janë: “Profesor... jam talent se jo mahi”, “Tregimi zoologjik”, “Heronjtë e kombit”, “Kur kishe mujtë me m’pa, qysh më kishe pa”, “Këngëtarja tullace”, “Dashuritë e Xhorxh Uashingtonit”, “Mbytma burrin”, “Maturantët”, “Stjuardesat”, “Mbreti Ibish”, “Hajnat nuk vijnë gjithmonë për të keq” etj.

“PROFESOR... JAM TALENT SE JO MAHI”

Shfaqja e parë në skenën e mbrëmjes të këtij teatri ka qenë “Profesor... Jam talent se jo mahi”, në regji të Faruk Begollit, e cila është shfaqur 315 herë, në të gjitha trojet shqiptare dhe në diasporë. Shfaqja ishte punuar nga etydet e studentëve të gjeneratës së parë të studentëve të aktrimit të Fakultetit të Arteve, sipas një modeli të njëjtë të një shfaqjeje sarajevase. Kjo komedi e lehtë arriti një popullaritet të jashtëzakonshëm.

“Profesor... Jam talent se jo mahi” konsiderohet si shfaqje emblematike e Teatrit “Dodona”. Premiera dhe mbi 20 repriza të kësaj shfaqjeje janë dhënë në ish-Teatrin Popullor Krahinor, në Prishtinë. Më pastaj, shfaqja është transferuar në Teatrin “Dodona” dhe është shfaqur qindra herë. Si për nga numri i reprizave, ashtu edhe për nga numri i shikuesve, shfaqja “Profesor... Jam talent se jo mahi”, mban rekordin në teatrin kosovar. Aktorët në këtë shfaqje (përpos Luan Dakës) kanë qenë studentë të gjeneratës së parë te profesor Begolli. “Karriera” fillestare e Begollit si regjisor nuk duket të ketë qenë shumë inkurajuese.


“N’fillim e kishim shumë t’vështirë, sidomos me turnetë nëpër terren, ku kishim shumë pak publik, prandaj unë, pak si me humor, shfaqjen fillova me e quejt ‘projekti fiasko’, gja t’cilën, duke mos ia kuptue plotnisht domethanien, disa nga aktorët e shfaqjes e merrnin si diçka afirmative”.

Gjatë një reprize në Skënderaj ishin shitur vetëm tri bileta. Megjithatë, shfaqja ishte dhënë në prani të rreth 50 fëmijëve të tjerë, të cilët ishin lënë të hyjnë falas. Pas reprizës në Skënderaj, shfaqja ishte ndërprerë përkohësisht, për të vazhduar pas tre muajsh me inaugurimin e ndërtesës së tanishme të Teatrit “Dodona”. Me këtë shfaqje në “Dodonë” hapet skena e mbrëmjes, kurse “Profesori...” përjeton kulmin e “ofensivës publike” si në “Dodonë” ashtu edhe në terren. Gati në secilin qytet ku është dhënë kjo shfaqje ka pasur kërkesa për repriza tjera, tri, katër e më tepër. Nga përfitimet, sigurisht jo të majme, që nxirreshin nga kjo shfaqje, aktorët mund të mbanin familjet e tyre.

Një prej gazetave të pakta që dilnin në atë kohë shkruante:



“Këtyre ditëve, kur teatri nuk është mbyllur dhe në të po flitet ende shqip, studentët e Degës së Aktrimit, të drejtuar nga profesori Faruk Begolli, realizuan dhe po shfaqin, me plot sukses, shfaqjen ‘Profesor... Jam talent se jo mahi’, e cila paraqet një freski të vërtetë në jetën tonë të vdekur kulturore...”



Dhe, pa fije dyshimi, jeta kulturore ishte vërtet e vdekur. Teatri “Dodona” ishte ‘dritarja’ e vetme kulturore ku ngjarjet teatrale dhe shfaqjet edhe më të zakonshme vështroheshin dhe perceptoheshin nga një prizëm tjetër.

Kushtet, në të cilat punonin artistët e këtij teatri, ishin minimale, për të mos thënë se nuk kishte fare kushte. Shfaqjet punoheshin falas, ndërkohë që Begolli dhe aktorët pastaj kompensoheshin prej biletave që shiteshin gjatë reprizave.

“Përveç dëshirës dhe vullnetit me punue, s’ kishim asgja tjetër, as edhe një metelik”.

Begolli tregon se për shfaqjen “Tregimi zoologjik” ekipit të shfaqjes i është dashur t’i vjedhë dy bredha në pyllin afër Prishtinës dhe një ulëse druri, të cilën e marrin diku në qytet.



Reputacioni i këtij teatri ishte i jashtëzakonshëm dhe puna e Begollit dhe e të tjerëve që punonin në këtë teatër çmohej shumë nga publiku dhe nga qarqet tjera kulturore. Në kohën kur pritej të jepej premiera e shfaqjes “Heronjtë e kombit”, regjinë e së cilës po e bënte Begolli, në shenjë proteste ndaj dhunës së regjimit serb në Kosovë, gazetarët kosovarë ishin futur në grevë urie. Për këtë arsye, autori i tekstit, Ymer Shkreli, kishte sugjeruar që, në shenjë solidarizimi me gazetarët grevistë, premiera e shfaqjes të shtyhet për një kohë tjetër më të përshtatshme. Por, ndërkohë, grevistët përcjellin tek ekipi i shfaqjes dëshirën që premiera e shfaqjes të jepej në ditën dhe në orën e parashikuar.

Teatri, që po e drejtonte Begolli, kishte një agjendë të ngjeshur dhe, përpos shfaqjeve, ai ishte nikoqir edhe i aktiviteteve të shumta, si, ekspozita, përrurime librash, koncertesh e aktivitete tjera kulturore. Pos komedive të popullarizuara, në “Dodonë” realizoheshin edhe drama dhe shfaqje politike, të cilat, në mënyrë të tërthortë, flitnin për okupimin dhe dhunën që ushtronte pushteti serb mbi shqiptarët. “Duke pritur Godonë”, e regjisorit kosovar Fadil Hysaj, pjesë të skenografisë kishte një mini-tanks të vogël. Mesazhi i saj ishte futuristik dhe kishte të bënte me kobin, që po përgatitej kundër shqiptarëve.

“Dodona”, ishte ajo “copë” lirie, që i ofrohej publikut për ato pak minuta sa zgjaste shfaqja. Nëse jashtë asaj salle publiku duhej të ecte me drojë, brenda në këtë sallë të vogël teatri ai ndihej i lirë; mund të qeshte dhe qante lirshëm.

Shfaqjet e Begollit u popullarizuan aq shumë sa që shpesh salla nuk mund ta zinte krejt publikun. Disa “gangsterë” të rinj ndonjëherë ngjiteshin maje kulmit të këtij teatri dhe futeshin tinëzisht në sallë për t’i ndjekur shfaqjet.

Në ato rrethana, ardhja deri në teatër ishte sfidë në vete. Publiku zakonisht ndiqte rrugët anësore për t’i ikur kështu takimit me policët serbë, që vazhdimisht kontrollonin rrugëve. Këto sfida i përcillnin edhe aktorët dhe njerëzit tjerë që punonin në këtë teatër. Shpesh, kur provat mbaheshin deri natën vonë, disa nga aktorët parapëlqenin të flinin në teatër.

“Kam vendos
me luftue me
çdo kusht, me
mbetë gjallë dhe
me e realizue
edhe shfaqjen
‘Profesor... 8’”

Pjesa më e vështirë, megjithatë, ishte dhënia e shfaqjeve në terren. Kombi-busi, që bartte aktorët, detyrohej të kalonte nga disa punkte policore. E, takimi me policë në asnjë rrethanë nuk ishte i këndshëm. Njëherë, derisa po ktheheshin nga terreni, aktorët ishin detyruar nga policët serbë të digjnin flamurin kombëtar shqiptar, i cili përdorej si rekuizitë në shfaqje.

Këto dhe ngjarje tjera të ngjashme kanë shënuar historinë e këtij teatri. Por, përmasat e vërteta të rolit të jashtëzakonshëm të këtij teatri u kuptuan më vonë, sall mbas përfundimit të luftës. Gjatë asaj kohe, qëllimi themelor i Begollit dhe i të tjerëve ka qenë të bëjnë teatër duke u dhënë kështu mundësi aktorëve të rinj të ngjiten në skenë. Por, të bërit teatër në atë kohë, sot, nga kjo perspektivë, del të ketë pasur edhe një mision më tepër: të mbahej gjallë shpirti i njerëzve, shpresa për të ardhmen, në një kohë kur gjithçka dukej e zymtë dhe e pa-perspektivë.

Begolli është udhëhequr nga instikti i artistit. Puna e tij ka qenë praktike, dhe ai asnjëherë nuk ka dashur të heqë dorë nga ajo që ka bërë. Këmbëngulësinë e vet në atë kohë ai me siguri nuk e ka parë si ndonjë akt patriotik, por si një refleksion prej artisti.

Duke qenë e vetmja “dritare kulturore” në Kosovë, Teatri “Dodona” qe shndërruar në simbol të teatrit kosovar. Faruk Begolli, e identifikon rolin e Teatrit “Dodona” si “protestë kundrejt dhunës dhe shtypjes që vinte nga regjimi i Millosheviqit”.

“Përfundimisht mund t’them se pa ‘Dodonën’ n’Kosovë kishim me e pasë një zbrazti t’madhe kulturore dhe një humnerë t’thellë në mes të gjeneratave t’reja e t’vjetra të artistave... Për ato dhjetë vjet, kur n’Kosovë s’kemi pas as kinema e as televizion, ‘Dodona’ ka qenë shtylla kryesore e teatrit n’veçanti, dhe e kulturës kosovare n’përgjithësi... Mendoj, se aty asht ba një lloj proteste kundrejt dhunës, një lloj manifestimi i krenarisë dhe dinjitetit, një formë e mosnënshtrimit...”

Praktikisht, gjatë asaj periudhe kohore, gjithë deri mbas luftës në Kosovë, Teatri “Dodona” do të mbetej institucioni i vetëm kulturor që lejohej të kishte aktivitete kulturore në gjuhën shqipe.

Ende dhe sot e kësaj dite ka mbetur një lloj misteri, pse pushteti serb lejonte aktivitetet teatrore të artistëve shqiptarë në këtë teatër? Për shkak se ky ishte teatër për fëmijë, dhe se ata nuk shihnin ndonjë kërcënim nga ky lloj teatri? Për shkak se ishte një teatër i ndërtuar thellë në margjina të qytetit dhe ata nuk besonin në forcën e tij? Apo, thjesht, mbase aktivitetet e këtij teatri toleroheshin falë autoritetit të jashtëzakonshëm që gëzonte Faruk Begolli, si në Kosovë, ashtu edhe në Serbi dhe në tërë ish-Jugosllavinë? Apo, mbase, thjesht, nuk u interesonte ajo gjë? Misteri dhe e vërteta ka të ngjarë të mos merren vesh kurrë! Por, ai mister tashmë është edhe jo fort i rëndësishëm. I rëndësishëm mbetet aktiviteti i këtij teatri gjatë kohës së okupimit. Përpos produksioneve teatrore, që ishin kryesisht komedi, ky teatër shërbente edhe si skenë e studentëve të teatrit, të cilët po shkolloheshin bodrumeve të Prishtinës, pasi që, ngjashëm me teatrot, edhe godinat e tyre shkollore ishin mbyllur nga regjimi.

Mbas përfundimit të luftës, Begolli kthehet sërish në mbretërinë e vet. Po ato mure, po ajo skenë, po ajo byfe e vogël... Disa nga aktorët ishin shpërndarë nëpër botë, por ishte Adriana ajo që mungonte përgjithmonë. Mungesa e saj do të ndjehet tek të gjithë. Pas disa vitesh, Begolli do ta inicioje botimin e një libërthi monografik për Adrianën, si dhe do të ndihmonte në organizimin e një përvjetori përkujtimor për të. Po ashtu, Begolli do të jetë edhe iniciator për botimin e një monografie të plotë për aktivitetet e Teatrit “Dodona”.



Edhe mbas luftës, ai vazhdoi me realizimin e komedive tjera, përfshirë edhe vazhdimin e 4, 5, 6 dhe të 7 të hitit - "Profesor...". Komeditë e tij tashmë do të trajtojnë probleme të ndryshme nga ato që trajtonin para luftës. Ndër të tjera, aktorët e tij në këto komedi do të satirizojnë situatat nga lufta dhe nga paralufta si dhe veset e shoqërisë kosovare të sapodalë nga lufta: korrupsioni, ndërtimet e egra, pseudo-patriotizmi, lufta politike etj.



Popullariteti i këtyre komedive me kalimin e viteve filloi të pësojë rënie. Përgjithësisht, interesimi i publikut kosovar për teatrin mbas lufte ka shënuar rënie drastike, nga viti në vit. Begolli, tashmë i zgjedhur zyrtarisht drejtor i Teatrit "Dodona", vazhdoi me të njëjtin ritëm, si përpara. Pra, edhe pse në rrethana krejt të reja, "Dodona" nën drejtimin e Begollit vazhdoi rrugën që kishte trasuar që nga fillimi.

Pas disa mandateve të njëpasnjëshme, vjet (2006) kandidatura e Begollit për drejtor u refuzua. Për shumëkënd, ky veprim i zyrtarëve komunalë u pa si hap jo i qëlluar, sidomos nisur nga fakti se Begolli tashmë veç ishte në prag të pensionimit. Për disa njerëz ky ishte një veprim jo i moralshëm, marrë parasysh kontributin e Begollit për këtë teatër. Një mik i Begollit dhe një bashkëpunëtor i tij, analisti dhe filozofi Shkëlzen Maliqi do të shkruante në njëren prej të përditshmeve tona një editorial, në fund të të cilit Begollit i uronte pleqëri të mbarë. Ky urim Begollit padyshim do t'ia ketë ulur zemërimin që mund ta ketë ndërë.

"Kur u largova nga posti i drejtorit të 'Dodonës', Shkëlzen Maliqi, në një shkrim të tijin, m'pati urue pleqni t'rahatshme dhe kreative. Ky urim i tij u ba për mue si një shtyllë e jetës teme".


Regjisori Isa Qosja, i cili mendon që Begolli reputacionin dhe famën e vet asnjëherë nuk e ka shfrytëzuar për t'i krijuar vetes ndonjë privilegj apo përfitim, e konsideron të padrejtë largimin e Begollit nga "Dodona".



„Kam përshtypjen që, pos 'Dodonës', të cilën e ka dashtë me zemër, dhe e cila i ka dhimbtë në ndarje, nuk njoh vend tjetër të punës për të cilin „çara“ ka pasur aspirata. Ai e ka krijuar atë "Dodonë", i ka krijuar ata njerëz aty. Ka qenë një skutë e tij, që e ka dashtë më së shumti. Një skenë, një kafene... Dhe, kur e kanë heqë nga aty, më duket se i ka dhimbtë, ka krijuar tek ai një pikëllim dhe për një moment është bërë njeri nostalgjik... Dhe më vjen keq që në fund ia kanë dhënë atë mundësi të pikëllimit dhe të nostalgjisë... Unë mendoj që ai është dashur të mbetet aty. Ai e ka ndërë veten mirë aty, si mbret i vogël, si perandor... Dhe atë perandori nuk është dashtë t'ia marrin".

Por, lidhja e Begollit me "Dodonën" nuk është shkëputur asnjëherë. Nga shtëpia e motrës së tij, ku aktualisht është duke qëndruar i shtrirë me rekomandim të mjekëve, ai ia kishte dhënë dikujt automobilin e tij dhe i kishte thënë që të bëjë një "xhiro" rreth "Dodonës" dhe pastaj ta parkonte aty përballë, mu siç bënte ai vazhdimisht përpara.

Disa muaj më pas, kur mjekët e diagnostifikuan me kancer, ai gjen përsëri forcë dhe zbrit në Teatrin "Dodona" për të udhëhequr shfaqjen e tij. Me një pjesëmarrje simbolike, nga salla e vogël e "Dodonës", ai komunikoi me personazhet në skenë. Ky vërtet qe një kthim triumfues! Mediumeve, që po prisnin ta takonin mbas aq kohësh, u tha shkurt: "Kam vendos me luftue me çdo kusht, me mbetë gjallë dhe me e realizue edhe shfaqjen „Profesor... 8".



TA

Fillimi i luftës, më 1998, Faruk Begollin e gjeti në Kosovë. Edhe pse lufta bëhej gjithnjë e më e hovshme, ai vazhdonte të punonte me studentët e tij. Pak ditë para se aeroplanët e NATO-s të fillonin bombardimin mbi forcat ushtarake serbe, ai do të ballafaqohej me një ngjarje tragjike. Një nga studentet e tij, aktorja e re Adriana Abdulahu, e cila sapo kishte diplomuar, gjersa po pinte kafe me kolegët e saj në një nga kafiteritë e Prishtinës, do të qëllohej për vdekje në një sulm terrorist.

“Atë ditë patëm një provim studentor në sallën që posa na e kthyen serbët, në Shkollën e Lartë Pedagogjike. Ishte provimi i studentëve që ishin në klasën e Luan Dakës. Ky ka qenë provimi i fundit i studentëve para lufte. Pas provimit, Adriana më ka kapë për të dy duart dhe m’ka lutë: ‘Profe, e di që nuk vjen në kafiteri, por, kësaj radhe, të lutem hajde, ‘vec ka një kafe ta pimë’. E unë, si gjithmonë, ia ktheva duke qeshur: ‘Ik bre çikë, çfar kafiterie, nuk jam unë për kafiteri... Ik, ik...!’ Ajo më kishte lutë edhe herave tjera me shku me të në kafiteri, por atë ditë ishte ndryshe. Nuk e dijsa që ai ishte momenti i fundit që po shihesha me të. Kurrë nuk e harroj atë moment, kur unë nuk shkova me të me ia plotësue dëshirën... Ndodhi... Nuk mujsha me e besue... Aty e kam pa se çka don të thotë ta humbasësh fëmion tënd...”

Vdekja e Adrianës vinte si një kumt i trishtë për njerëzit. Ishte si një alarm për të keqen që do të pasonte. Të nesërmen e vrasjes së saj, Faruk Begolli, bashkë me artistë të tjerë, ishin përpjekur të organizonin në Teatrin “Dodona” një mbledhje përkujtimore për Adrianën, por ishin penguar nga



drejtori i dhunshëm serb. “Ata që po na vrasin, po na pengojnë edhe sot ta mbajmë këtë mbledhje komemorative”, kishte thënë zëshëm Faruk Begolli. Por, mbledhja, megjithatë, ishte mbajtur në oborrin e vogël të këtij teatri. Me fjalime të shkurta, profesorë, artistë dhe ish kolegë të Adrianës po rikujtonin me pietet kujtimin e aktores së re e të talentuar dhe po mallkonin vrasësit e saj.

Në ditën kur duhej të bëhej varrimi, ish kolegët e Adrianës po bëheshin gati të udhëtonin për në Ferizaj, në qytetin e saj të lindjes. Por, mbas një dileme, Begolli u kishte sugjeruar të mos udhëtonin: “Një fëmijë m’u vra, mos t’i humbas edhe të tjerët”, kishte menduar ai, para se të kërkonte nga studentët e tij, ish kolegë të Adrianës, që të mos udhëtonin për në Ferizaj.

“Shtetrrrethimi” i Prishtinës, sic e quan Begolli, kishte filluar sapo bombat e aeroplanëve të NATO-s kishin nisur të bijnë mbi forcat serbe. Në këtë teatër tragjik, shqiptarëve u ishte ndarë roli i viktimës. Prishtina kishte filluar të zbrazet nga njerëzit. Paramilitarët serbë po i nxirrnin njerëzit nga shtëpitë e tyre dhe po i deportonin për në Maqedoni e Shqipëri. Rreth një million njerëz (gjysma e popullatës së Kosovës) qenë deportuar me dhunë. Në Prishtinë pak njerëz kishin vendosur të rrinin, tepër pak, sepse nuk kishin mundur të iknin, ndërsa, në të rrallë, mund të gjindeshin njerëz që, për motive të tjera, kishin vendosur të rrinin. Faruk Begolli me familjen e tij të ngushtë ishin ndër ata të paktët që kishin vendosur të rrinin. Ai ishte frikësuar ta lëshonte Kosovën, jo nga frika e luftës, por nga frika e vetmisë dhe e ‘shpërbërjes shpirtërore’ që do të mund të pasonte pastaj. Kishte vendosur të rrinte me çdo kusht, duke besuar se, nëse do të largohej, më nuk do të ishte askushi dhe se do të mbetej vetëm numër...

„Unë, me eksperiencën teme e di që njeriu jashtë vendit të vet, njeriu refugjat, e ka shumë të vështirë... E humb identitetin... Ma nuk je kërkushi... Edhe shoku ma i ngushtë kur ta jep një cigare ti mendon: po ta jep se po i dhimbesh... Pra, unë e kam ditë se, nëqoftëse dal nga këtu, nuk do të jem më kërkushi... Nuk jam ma as nga Kosova, nuk jam ma Faruk Begolli, nuk jam ma njeri... Unë, mes krejt atyne dilemave, u përcaktova të rri këtu... Sepse mendoja, asht njisoj: nëse largohem e humbi identitetin, nëse rri këtu ndoshta e humbi jetën... Cila asht ma e randësishme: jeta apo identiteti... Përderisa njeriu asht gjallë, identiteti dhe vendi i vet asht ma i randësishëm... E, vdes ose nuk vdes ajo asht shumë pak e randësishme. Njeriu jeton mos me u gjuhëzue, mos me e prur veten në rrethana ku mbetesh kërkushi, nuk ke identitet, bahesh vetëm ‘numër’... E unë nuk kam dashtë me u shëndrrue në numër“.

OPERACIONI BEOGRAD


Në ditët e para të bombardimeve të NATO-s, në televizionin e Beogradit emitoreshin filmat e luftës, në shumicën e të cilëve luante edhe Faruk Begolli. Dhe, ndërkohë që në filma ai luante partizanin trim që lufton fashistët gjermanë dhe tradhëtarët e vendit, në realitet ai po priste se kur do të vinin policët serbë që ta largonin dhunshëm nga shtëpia. Dhe, policët do ta largojnë dy herë nga shtëpia, por ai, përsëri, bashkë me motrën e vet, do të kthehet te vëllau, Adili dhe nuk do të pranojë të largohet.

„Një ditë, derisa në televizion jepej filmi „Operacioni Beograd” i regjisorit Zhika Mitrovic, ku unë luaj çlirimtarin e patrembur të qytetit të Beogradit, policët serbë erdhën dhe na larguen nga shtëpia”.

Shokët e tij, nga Beogradi dhe qytetet tjera jashtë Kosovës do t’ia dalin ta gjejnë numrin e tij. Josif Tadiq – Jataganac, njëri nga shokët më intimë të Begollit, do ta mbajë vazhdimisht lidhjen me të. Ai do ta thërrasë në telefon Begollin çdo të dytën apo të tretën ditë. Jataganac dhe disa shokë të tjerë, duke e kuptuar atë që po ndodhte në Kosovë, do të bëjnë përpjekje të mëdha që ta “nxjerrin” nga Prishtina. Ata vërtet do të merakosen për Begollin. Do t’i hulumtojnë të gjitha kanalet e mundshme dhe madje do të përpiqen të nisin edhe një autobus, i cili do të evakuonte jo vetëm Begollin por edhe familjen e tij. Përpjekjet e shokëve për ta shpëtuar nga ferri, do ta gëzojnë dhe trimërojnë Begollin, por ai nuk do të bindet që të largohet nga Kosova.

„ ...Ata banin plane e plane, ndërkohë që unë thojsha: mendo tash, me ikë për Serbi... Ata gjithmonë gjenin variante për me më shpëtue. Ata ishin shokët e mi, që propaganda nuk ka mujtë me i infektue asnjëherë. Shoqnia nuk ka fe, etnitet... Shoqnia e ka njeriun... Shoqnia e ka njeriun e zhveshun nga gjithcka tjetër...”

ÇELJA E LULEVE NË KOHË LUFTE



Afër shtëpisë, ku gjatë luftës do të rrinte Begolli, gjindej një kopsht. Lagjja “Taslixhe”, që tashmë ishte thuaja e zbratur tërësisht nga njerëzit, ishte mbuluar nga bari dhe gjelbërimi i pashkelur. Dukej, siç e quan Begolli, “si një oazë në shkretëtirë”. Begollit i pëlqente të dalë në ballkon, t’i dëgjojë lajmet, të mbushë fjalëkryqe dhe ta shikojë kopshtin me lulet e barin që po rritej. Në kopsht ishte edhe një pemë e bukur qershie, të cilën Begolli e vëzhgonte gjatë kohës së lulëzimit të saj.

“Sikur nana që i rri fëmijës afër, unë i shikojsha lulet e qershisë tuj çelë; si dilke sythi, si zgjerohej ngadalë... Vëzhgoja me kujdes se cila lule ka nisë sot me dalë, cila asht gati me çelë, cila ka çelë dje...”

Dukej se e tërë shpresa për jetë ishte shfaqur në atë pemë qershie, në aromën e luleve që po çelnin. Mbas luleve, qershia kishte filluar t’i piqte ngadalë edhe kokrrat. Si një ekspert bimësh, që është duke kryer një hulumtim mbi qershitë, Begolli do ta vëzhgojë me kujdes pjekjen e qershive, degët, madje edhe kokrrat secilën veç e veç. Më vonë ai do të fillojë të ushqehet me kokrrat e pjekura.

“...Mandej kam fillue me hypë, në fillim në degët aty poshtë, por, mbasi çdo ditë hypsha në qersh, në fund e kam pa veten në maje të qershisë, si dikur kur isha fëmijë e kur hypsha në maje të majës... I kam pasë do kojshi këtu afër e ju qojsha edhe atyne... Pra, e kam pasë një veprim fizik... Fizikisht mu forcuen kambët... U bana si majmun, prej degës në degë...”

Frutat e kësaj qershie do të kryhen thuaja në të njëjtën kohë me përfundimin e luftës. Por, tregimi i luftës ka edhe një episod tjetër të frikshëm. Faruk Begolli, bashkë me të vëllain, Adilin, po kryenin ritualet e një dite të zakonshme lufte. Në banesën e tyre hyjnë dy policë serbë, të cilët po kryenin regjistrimin e popullatës së paktë që kishte mbetur në Prishtinë. Policët e njohin Begollin.

“ ...Ishte e tmerrshme. ‘Hajde, e keni lypë Shqipninë, qe, veshu e nisu...’ Unë fillojsha me u veshë. Në fillim u dridhsha, normalisht. E ata vazhdonin: ‘Jo, deshu? Mandej, a ke pare?’ Unë i nxora krejt paret çka i kisha. Ata i gujshin nëpër dysheme. Ata mandej: ‘Eh, tash, ju të dy na keni sulmue neve dhe ne tash ju vrasim’. Nja dy orë ka vazhdue ky lloj maltretimi. Por, dikur po i vike njeriut një fuqi krejt tjetër. Në fillim u dridhsha, i ndigjojsha, dikur më kërciti filmi edhe i lutsha unë: ‘hajde, çomni, ku po doni, çka po doni... Hajde, vramëni...’ Krejt me një fuqi tjetër dhe një qetësi ndoshta mbinjerëzore...”

Por, fatmirësisht, e gjitha kishte përfunduar pa ndonjë epilog tragjik. Policët kishin kërkuar nga Begolli t`ua paguante një drekë. Kishin marrë 200 marka gjermane dhe mandej ishin larguar, duke i lënë porosi Begollit, “Mos na nem, se pale na mbetet dreka në fyt!”

Gjatë ditëve të luftës, Begolli zgjohej rreth orës 5 të mëngjesit që t`i dëgjonte lajmet. Nga dritarja bri shtratit shihte kulmet e shtëpive tjera të mbuluara nga sorrat. Mëngjesi dukej i zi. Krrokamat e egra të tyre i kuptonte si një shenjë e zezë, se diçka edhe më e tmerrshme do të ndodhte... Çdo mëngjes e njëjta pamje: kulme të mbuluara nga sorrat që krrokatnin.

Asokohe, gjatë ditëve të luftës, Begolli do të ndahet plotësisht nga “miku” i tij i përhershëm - alkooli. Për disa muaj, ai nuk do të shtjerë në gojë alkool, sado që shtëpinë e kishte të mbushur me raki. Kishte vendosur ta mbante veten nën kontrollë dhe t`i përjetonte në gjendje esull ato çaste ankthi e tmerri. Kishte vendosur ta shihte luftën dhe tmerret e asaj lufte në sy, ashtu siç kishte bërë dikur nëpër filma. Dallimi, padyshim, ishte i dukshëm. Ajo që po ndodhte nuk ishte lojë. Përpara nuk ishin kamerat që po xhironin. Ai ishte Faruk Begolli, jo artisti, jo profesori... Ishte Faruk Begolli, njeriu.

Mbasi përfundoi lufta dhe hynë trupat e NATO-s, Begolli do të ndihet si i humbur. Një kohë të gjatë nuk do të dalë fare nga shtëpia. Nuk do ta besojë se gjithcka kishte përfunduar me aq “lehtësi”.

Ai nuk mendon se vendosmëria për të qëndruar në Prishtinë ishte shenjë trimërie. Ai nuk mendon se ka qenë trim. Ka ndejtur në Prishtinë ngase e ka dashur vetveten dhe se nuk ka dashur të shndërrohet në “numër”.

“Kam ndejtë këtu si një qenie njerëzore, e pambrojtun dhe pa mundësi ndërmarrjeje të diçkasë... Përpos me ndjenjën e frikës... Kjo nuk ka qenë trimni... Trimnia asht

krejt dicka tjetër... E sa i përket jetës, unë nuk e di a kam qenë a nuk kam qenë trim. Unë nuk di me e spjegue fjalën trimni. Por, nëqoftëse përcaktohesh dhe punon atë që do dhe atë e ban me kënaqësi dhe nëse kjo quhet trimni, atëherë unë jam trim. Se kam shkue në studime me kushte ekonomike tepër të vështira, se mes 500 e sa konkurruesve për aktorë jam zgjedhë ndër 12... Pra, kam kalue shumë sfida në jetë... E nëse këto kanë ndonjë lidhje me trimninë, atëherë kam qenë trim. Ndonjëherë, kur lexojsha ndonjë skenar a dramë, thojsha me vete: kjo asht e pamundun me u ba... Por, atëherë e 'lutsha' veten: mirë, filloja, mandej e sheh... E çdo send që fillon e ka, faktikisht, edhe fundin... Tjetër trimni unë nuk di për veten..."

Mbas luftës Begolli rrallë do të dalë jashtë Kosovës. Nuk do të shkojë më në Beograd, por as në Zagreb apo Lubjanë. Në Sarajevë do të shkojë shumë më vonë, me "Mbretin Lir".

"U krijua në mua njëfarë ndjenje... Dhe as që provoj ta rikthej dashurinë që e kam pasur. Dua që ta ruaj me dashuri atë jetë të mrekullueshme që kam pasë dikur, ata shokë të mrekullueshëm, ato dashuri të mrekullueshme dhe atë kreativitet të mrekullueshëm, pa të cilin, natyrisht, as këto tjerat nuk do të kishin ekzistuar. Nuk guxoj të mendoj për Beogradin. Shokët më thërrasin. Madje ata mendojnë se unë kam frikë. Por unë e kam ndërprerë një jetë të mrekullueshme. Tash e kam ndërtuar një mur dhe nuk dua më të mendoj, ngaqë e kam dashur shumë Beogradin. Kam frikë. Dua të më mbeten kujtimet e mira që kam."

Ende edhe sot, mbas sa vitesh që lufta ka përfunduar, Faruk Begolli vazhdon të zgjohet në orën pesë të mëngjesit, kohë kjo kur gjatë luftës jepeshin lajmet në radio. Zgjohet dhe, ashtu si në kllapi, lëviz pak rrotën e frekuencave të radios. Dëgjon pak 'zhurmë' e mandej përsëri e merr gjumi... Një ritual i pavetëdijshtëm, si kujtim i një kohe të shkuar, i asaj kohe kur në lindje të diellit pullazet nxinin nga sorrat që krrokatnin frikshëm...

ARTISTËT E RINJ FRYMËZIM PËR ARTISTËT E RINJ FRYMËZIM PËR ARTISTËT E RINJ

Mbas shumë përpjekjesh, më duket që kam arritë me i mbledhë bashkë ato copëza më të rëndësishme nga jeta dhe krijimtaria e Faruk Begollit. Padyshim ka shumë gjëra të tjera që kanë mbetë jashtë këtij libri, me dashje ose pa dashje. Nuk qe e mundur të udhëtoja deri në Beograd dhe të takoja disa nga njerëzit me të cilët ka punuar Faruk Begolli. Me të vërtetë kam dashur shumë të shkoj atje. Vetë Begolli nuk ishte i pëlqimit për një gjë të tillë. Thoshte se nuk ka nevojë dhe se nuk do të mund të 'nxirrnim' ndonjë gjë të vlefshme për sa i përket librit. I kemi përfillur shumë mendimet dhe dëshirat e tija në lidhje me këtë libër.


E Hënë. 4 Qershor. Mbas mesit të natës.

Herën e fundit që e kam taku profesorin Begolli ka qenë e diela e shkuar. Të dielave zakonisht ia çoj gazetatat, mbasi të dielave shitoret afër shtëpisë ku jeton ai nuk shesin gazeta. Ditëve tjera gazetatat ia sjell motra, Aslihaja, një grua e mrekullueshme, e cila po kujdeset për Begollin qe sa muaj. Të dielën e shkuar, kur e takova profesorin, nuk po ndihej mirë. Kishte dhimbje. "Kam dhimbje", tha, asgjë më shumë.

Po shpresojmë që për pak ditë ky libër do të jetë gati për shtyp. Është fundi, koha kur po ua jap "dorën e fundit" pjesëve të shkruara. Padyshim, shumë nga "lëshimet" do të kuptohen më vonë. Do të mungojnë shumë gjëra. Por, prapë, shpresoj se lëshimet dhe "gjërat që mungojnë" janë të vogla në krahasim me ato që gjinden në këtë libër.

Shkrimi i këtij libri u nis pak kohë para se Faruk Begolli të sëmurëj. Sëmundja e tij u tregua shumë e pabesë. Më duhet të them se në fillim të gjithë ne, që ishim të përfshirë në përgatitjen e këtij libri, ishim të hutuar. Por, nga kjo huti na nxori vetë profesori, që, edhe pse i sëmurë rëndë, këmbëngulte që ky libër të bëhej.

Ky libër po bëhet. Shpresoj që historia e jetës së Faruk Begollit, këtij njeriu dhe artisti të madh, do të shërbejë, para së gjithash, si frymëzim për artistët e rinj.



FARUK BEGOLLI - FILM

FARUK BEGOLLI - FILM

(Përzgjedhje)

1. "SHIKIMI NË BEBËZËN E DIELLIT" (POGLED U ZJENICU SUNCA") - (1966)
Regjisor: Veljko Bulajic
Skenarist: Stevan Bulajic, Veljko Bulajic
Në rolet kryesore: Faruk Begolli, Milena Dravic, Mladen Ladika, Velimir 'Bata' Zivojinovic.
2. "ËNDRRA" (SAN) - (1966)
Regjisor: Mladimir 'Purisa' Djordjevic
Skenarist: Mladimir 'Purisa' Djordjevic
Në rolet kryesore: Ljubisa Samardzic, Mihailo 'Misa' Janketic, Olivera Vuco, Velimir 'Bata' Zivojinovic, Mija Aleksic, Ljuba Tadic, Faruk Begolli, Sinisa Ivetic.
3. "FËMIJËT E DUKËS SMIT" (DECA VOJVODE SMITA) (1967)
Regjisor: Vladimir Pavlovic
Skenarist: Vladimir Pavlovic
Në rolet kryesore: Miodrag Andric, Faruk Begolli, Slobodan Djuric, Desa Dugalic, Renata Freiskorn, Radmila Gutesa, Jovan-Burdus Janicijevic, Milan Jelic, Ingrid Lotarius.
4. "MËNGJESI" (JUTRO) - (1967)
Regjisor: Mladimir 'Purisa' Djordjevic
Skenarist: Mladimir 'Purisa' Djordjevic
Në rolet kryesore: Ljubisa Samardzic, Neda Arneric, Milena Dravic, Mija Aleksic, Ljuba Tadic, Faruk Begolli, Neda Spasojevic, Jelena Zigon.
5. "OPERACIONI BEOGRAD" (OPERACIJA BEOGRAD) - (1968)
Regjisor: Zika Mitrovic
Në rolet kryesore: Dusan Bulajic, Aleksandar Gavric, Faruk Begolli, Dusica Zegarac.
6. "VËLLAU I DOKTOR HOMERIT" (BRAT DOKTORA HOMERA)- (1968)
Regjisor: Zivorad 'Zika' Mitrovic
Skenarist: Zivorad 'Zika' Mitrovic
Në rolet kryesore: Velimir 'Bata' Zivojinovic, Voja Miric, Jovan Milicevic, Ljuba Tadic, Pavle Vujisic, Zdravka Krstulovic, Jelena Zigon, Faruk Begolli, Istref Begolli, Abdurrahman Shala, Minja Vojvodic.
7. "ATENTATI I SARAJEVËS" (SARAJEVSKI ATENTAT) - (1968)
Regjisor: Fadil Hadzic
Skenarist: Fadil Hadzic
Në rolet kryesore: Lucyna Winnicka, Bert Stolar, Janez Rohacek, Predrag Finci, Faruk Begolli, Svetolik Nikacevic, Maks Furijan, Majda Potokar.

MOGRAFIA

MOGRAFIA

8. "MESDITË" (PODNE) - (1968)
Regjisor: Mladimir 'Purisa' Djordjevic
Skenarist: Mladimir 'Purisa' Djordjevic
Në rolet kryesore: Ljubisa Samardzic, Neda Arneric, Faruk Begolli, Dusica Zegarac,
Mija Aleksicm, Ljuba Tadic.
9. "ANA IME E BOTËS" (MOJA STRANA SVETA) - (1969)
Regjisor: Vlatko Filipovic
Skenarist: Vlatko Filipovic
Në rolet kryesore: Faruk Begolli, Izet Hajdarhodzic, Iva Marjanovic, Olivera Markovic,
Radmila Radovanovic, Pavle Vujisic, Dragan Zaric, Jelena Zigon.
10. "BETEJA E NERETVËS" (BITKA NA NERETVI) - (1969)
Regjisor: Veljko Bulajic
Skenarist: Stevan Bulajic, Veljko Bulajic
Në rolet kryesore: Sergei Bondarchuk, Anthony Daëson, Milena Dravic, Boris Dvornik,
Curd Jürgens, Franco Nero, Hoëard Ross, Lojze Rozman,
Ljubisa Samardzic, Oleg Vidov, Orson Êelles, Faruk Begolli,
Velimir 'Bata' Zivojinovic, Abdurrahman Shala.
11. "E DASHURA IRENË" (DRAGA IRENA) - (1970)
Regjisor: Nikola Stojanovic
Skenarist: Nikola Stojanovic
Në rolet kryesore: Faruk Begolli, Petar Bozovic, Dragomir Cunic, Magda Fedor,
Dina Rutic, Marinko Sebez.
12. „MANIRET TONA" (NASI MANIRI) - (1970) (TV)
Regjisor: Jovan Konjovic
Skenarist: Ljubinka Bobic Faruk Begolli, Milan Gutovic, Olga Ivanovic, Ljiljana Lasic,
Toni Laurencic, Olivera Markovic, Branko Milicevic.
13. "REKUIEM" (REKVIJEM) - (1970)
Regjisor: Caslav Damjanovic
Skenarist: Caslav Damjanovic
Në rolet kryesore: Ty Hardin, Giorgia Moll, Abdurrahman Shala,
Danilo 'Bata' Stojkovic, Faruk Begolli, Dusan Janicijevic.
14. "DASHURIA E PARË" (PRVA LJUBAV) - (1970)
Regjisor: Zoran Calic
Skenarist: Zoran Calic
Në rolet kryesore: Faruk Begolli, Aleksandar Gavric, Ljiljana Lasic, Vesna Malohodzic,
Miodrag 'Ckalja' Petrovic.

15. TË NGUJUARIT - (1971) (TV)
 Regjisor: Ekrem Kryeziu
 Skenarist: Ekrem Kryeziu
 Në rolet kryesore: Melihate Ajeti, Faruk Begolli, Istref Begolli, Shani Pallaska.
16. "FAMILJA WERNER NË UDHETIM" (FAMILIE WERNER AUF REISEN) - (1971)
 Regjisor: Karl-Heinz Bieber
 Skenarist: Hannes Dahlberg, Heinz Oskar Eüttig
 Në rolet kryesore: Faruk Begolli, Djordje Nenadovic, Rut Rex, Inge Eöloffberg, Gerhard Wollner.
17. "SI TË VDISET" (KAKO UMRETI) (1972)
 Regjisor: Miomir 'Miki' Stamenkovic
 Skenarist: Branimir Scepanovic
 Në rolet kryesore: Faruk Begolli, Xhevat Qorraj, Jelena Lakovic, Abdurrahman Shala, Xhevat Qena, Istref Begolli, Bogdan Jakus, Enver Kaçaniku, Fatmir Lama, Shani Pallaska, Sabedin Shahiqi.
18. „VALTERI MBRON SARAJEVËN“ (VALTER BRANI SARAJEVO) - (1972)
 Regjisor: Hajrudin Krvavac
 Skenarist: Djordje Lebovic
 Në rolet kryesore: Velimir 'Bata' Zivojinovic, Rade Markovic, Ljubisa Samardzic, Neda Spasojevic, Dragomir 'Gidra' Bojanic, Slobodan Dimitrijevic, Rolf Römer, Pavle Vujisic, Faruk Begolli.
19. „BUKA“ - (1973) (TV)
 Regjisor: Ekrem Kryeziu
 Skenarist: Azem Shkreli
 Në rolet kryesore: Faruk Begolli, Istref Begolli, Arianit Çela, Milutin Jasnica, Milot Kryeziu, Snezana Niksic, Shani Pallaska, Josif Tatic, Dusica Zegarac.
20. „VETËM“ (SAM) - (1973)
 Regjisor: Radomir Saranovic
 Skenarist: Radomir Saranovic
 Në rolin kryesor: Faruk Begolli.
21. „BIOGRAFIA E JOZEF SHULCIT“ (BIOGRAFIJA JOZEFA SULCA) (1973)
 Regjisor: Predrag Golubovic
 Skenarist: Predrag Golubovic, Danko Popovic
 Në rolin kryesor: Faruk Begolli.
22. "SB MBYLL RRETHIN" (SB ZATVARA KRUG) (1974)
 Regjisor: Miomir 'Miki' Stamenkovic
 Skenarist: Dragan Markovic, Dusan Perkovic
 Në rolet kryesore: Slobodan Dimitrijevic, Dusica Zegarac, Rade Markovic, Voja Miric, Faruk Begolli.

23. "DERVISHI DHE VDEKJA" (DERVIS I SMRT) - (1974)
Regjisor: Zdravko Velimirovic
Skenarist: Borislav Mihajlovic-Mihiz
Sipas romanit të Mesa Selimovic
Në rolet kryesore: Voja Miric, Velimir 'Bata' Zivojinovic, Boris Dvornik,
Olivera Vuco, Faruk Begolli, Branko Plesa, Abdurrahman Shala.
24. "SULMI I KUQ" (CRVENI UDAR) - (1974)
Regjisor: Predrag Golubović
Skenarist: Branislav Bozovic, Ratko Djurovic
Në rolet kryesore: Bata Zivojinovic, Boris Dvornik, Abdurrahman Shala,
Xhevat Qena, Bert Sotlar, Faruk Begoli, Olivera Katarina.
25. "UKA I BJESHKËVE TË NEMUNA" (VUK SA PROKLETIA) (1968)
Regjisor: Miomir Stamenković
Skenarist: Abdurrahman Shala, Murteza Peza
Në rolet kryesore: Abdurrahman Shalja, Josif Tatic, Vesna Krajina, Branko Pleša,
Melihat Ajeti, Darko Damevski, Dragutin Felba, Faruk Begolli.
26. "PAVLE PAVLOVIC" - (1975)
Regjisor: Mladimir 'Purisa' Djordjevic
Skenarist: Mladimir 'Purisa' Djordjevic
Në rolet kryesore: Mija Aleksic, Dusan Antonijevic, Stole Arandjelovic,
Faruk Begolli, Ljubinka Bobic, Bekim Fehmiu, Olga Jancevecka,
Skender Radotina, Bozidar Stosic, Ljuba Tadic, Josif Tatic.
27. "POSHTË ME ARMËT" (DOLE SA ORUZJEM) - (1975) - (TV)
Regjisor: Mario Fanelli
Skenarist: Drago Kekanovic
Në rolet kryesore: Stole Arandjelovic, Miha Baloh, Faruk Begolli, Vojislav Brajovic,
Mirko Bulovic, Zvonimir Crnko, Dragomir Cumic, Branko Cvejic,
Aleksandar Hrnjakovic, Jovan Licina.
28. "MEDUZA E SAJANIT" (MEDUZA SAJANA) - (1976)
Regjisor: Slavko Almazan
Skenarist: Slavko Almazan
Në rolet kryesore: Faruk Begolli, Mirjana Nikolic
29. "MAJAT E ZELENGORËS" (VRHOVI ZELENGORE) - (1976)
Regjisor: Zdravko Velimirovic
Skenari: Mladen Oljaca, Curica Labovic, Zdravko Velimirovic
Në rolet kryesore: Alain Noury, Bozidar Pavicevic-Longa, Dragomir Bojanic-Gidra,
Velimir (Bata) Zivojinovic, Faruk Begolli, Rados Bajic, Josephine Chaplin,
Gordana Kosanovic.

30. "ROJE E PLAZHIT NË PERIUDHË DIMRI"
(CUVAR PLAZE U ZIMSKOM PERIODU) - (1976)
Regjisor: Goran Paskaljevic
Skenarist: Gordan Mihic
Në rolet kryesore: Irfan Mensur, Danilo 'Bata' Stojkovic, Dara Calenic,
Velimir 'Bata' Zivojinovic, Faruk Begolli.
31. "VIZITA NATËN" – (1978)
Regjisor: Isa Qosja
Skenarist: Isa Qosja
Në rolet kryesore: Faruk Begolli, Ankica Milenkovic, Fatmire Osmani,
Shani Pallaska, Ahmet Spahiu.
32. "FATET" (SUDBINE) - (1978)
Regjisor: Predrag Golubovic
Skenarist: Predrag Golubovic
Në rolet kryesore: Faruk Begolli, Miroљjub Leso, Veljko Mandic, Bert Sotlar,
Mirceta Vujcic, Zoran Zindovic.
33. "EPOKA PARA GJYQIT" (1978) - (TV)
Regjisor: Ekrem Kryeziu
Skenarist: Ekrem Kryeziu
Në rolet kryesore: Faruk Begolli, Hadi Shehu, Istref Begolli, Afrim Kasapolli, Xhevdet Lila,
Ragip Loxha, Ramadan Malaj, Hazir Myftari, Shani Pallaska, Ahmet Spahiu.
34. "TË ARRISH PARA AGIMIT" (STICI PRE SVITANJA) (1978)
Regjisor: Aleksandar Djordjevic
Skenarist: Vlastimir Radovanovic (adaptim sipas romanit të Pasko Romac)
Në rolet kryesore: Velimir 'Bata' Zivojinovic, Zlata Numanagic, Ljubisa Samardzic,
Bekim Fehmiu, Faruk Begolli, Velimir Zivotic, Slobodan Dimitrijevic.
35. „ERA DHE LISI“ - (1979)
Regjisor: Besim Sahatçiu
Skenarist: Petrit Imami
Sipas romanit të Sinan Hasanit
Në rolet kryesore: Abdurrahman Shala, Faruk Begolli, Melihate Ajeti, Qemajl Ajdini,
Istref Begolli, Fehmi Grubi, Masar Kadiu, Sylë Kuqi, Xhevdet Lila,
Sylejman Lokaj, Ragip Loxha, Ramadan Malaj, Shani Pallaska,
Antigona Qena-Kaçaniku, Xhevat Qorraj, Muharrem Shahiqi,
Adelajde Sopi, Ahmet Spahiu.
36. „ESKADRILA PARTIZANE“ (PARTIZANSKA ESKADRILA) - (1979)
Regjisor: Hajrudin Kravac
Skenarist: Djordje Lebovic, Miljenko Smoje
Në rolet kryesore: Bekim Fehmiu, Velimir 'Bata' Zivojinovic, Ljubisa Samardzic,
Faruk Begolli, Branko Djuric.

37. „VITE TË VËSH TIRA“ (ZESTOKE GODINE) - (1979)
 Regjisor: Zivko 'Zika' Ristic
 Skenarist: Zivko 'Zika' Ristic
 Në rolet kryesore: Faruk Begolli, Bora Bozanic, Vesna Cipcic, Cane Firaunovic,
 Almira Ismailova, Mikhail Kononov.
38. „KUR PRANVERA VONOHET“ - (1980)
 Regjisor: Ekrem Kryeziu
 Skenarist: Azem Shkreli
 Sipas romanit të Fadil Hoxhës
 Në rolet kryesore: Hadi Shehu, Melihate Ajeti, Abdurrahman Shala, Faruk Begolli,
 Skender Tafaj, Enver Petrovci, Istref Begolli, Elhame Hasani,
 Xhevat Qorraj, Muharrem Qena, Ismail Gami, Sabri Fejzullahu,
 Hazir Myftari, Jahja Shehu, Josif Tatic.
39. „GJURMË“ (Trag) - (1981)
 Regjisor: Darko Bajic
 Skenarist: Darko Bajic
 Në rolet kryesore: Faruk Begolli, Gorica Popovic, Minja Stevovic, Nada Vojinovic.
40. „PËRROI VËRSHUES“ - (1981)
 Regjisor: Besim Sahatçiu
 Skenarist: Petrit Imami
 Në rolet kryesore: Faruk Begolli, Istref Begolli, Xhevat Qorraj, Abdurrahman Shala.
41. „13 GUSHT“ (13 JUL) - (1982)
 Regjisor: Radomir Saranovic
 Skenarist: Milo Djukanovic, Ratko Djurovic
 Në rolet kryesore: Petar Bozovic, Miki Manojlovic, Petar Banicevic, Petar Rajevic,
 Rade Serbedzija, Velimir 'Bata' Zivojinovic, Faruk Begolli,
 Ljiljana Dragutinovic, Josif Tatic.
42. „DIH“ - (1983)
 Regjisor: Bozo Sprajc
 Skenarist: Zeljko Kozinc
 Në rolet kryesore: Ivo Ban, Faruk Begolli, Demeter Bitenc, Ranko Gucevac,
 Angelca Hlebce, Zvone Hribar.
43. „KRYENGRITJA E TIMOKUT“ (TIMOCKA BUNA) - (1983)
 Regjisor: Zivorad 'Zika' Mitrovic
 Skenarist: Zivorad 'Zika' Mitrovic
 Në rolet kryesore: Ljubisa Samardzic, Velimir 'Bata' Zivojinovic, Ljuba Didic, Faruk Begolli,
 Jadranka Selec, Vesna Cipcic, Irfan Mensur.

44. "PROKA" (1984)
 Regjisor: Isa Qosja
 Skenarist: Eqrem Basha
 Në rolet kryesore: Faruk Begolli, Masar Kadiu, Çun Lajçi, Ragip Loxha, Adem Mikullovc, Hazir Myftari, Muharrem Qena, Xhevat Qena, Xhevat Qorra, Abdurrahman Shala.
45. „GJURMA E RREZIKSHME“ (OPASNI TRAG) - (1984)
 Regjisor: Miomir 'Miki' Stamenkovic
 Skenarist: Milutin Jankovic, Dragan Markovic
 Në rolet kryesore: Milan Strljic, Vladica Milosavljevic, Velimir Bata Zivojinovic, Alen Nuri, Enver Petrovci, Faruk Begolli, Xhevat Qorra, Petar Arsovski, Abdurrahman Shala, Danco Cevrevski, Istref Begolli.
46. "BARAKA E KUQE" (CRVENA BARAKA) - (1985) (TV)
 Regjisor: Aleksandar Mandic
 Skenarist: Milenko Vucetic
 Në rolet kryesore: Rados Bajic, Faruk Begolli, Milutin Butkovic, Ivan Jagodic, Dubravko Jovanovic, Erol Kadic.
47. "BËJE ATË SI DUHET" (UCINI TO SVOJSKI) (1986) (TV)
 Regjisor: Miroslav Lekic
 Skenarist: Jelica Zupanc
 Në rolet kryesore: Faruk Begolli, Predrag Ejdu, Olivera Markovic, Cvijeta Mesic, Zlata Numanagic, Josif Tatic.
48. "VUK KARADZIC" - (1987). Në dy episode:
 Regjisor: Djordje Kadijevic
 Skenarist: Milovan Vitezovic
 Në rolet kryesore: Miki Manojlovic, Faruk Begolli, Aleksandar Bercek, Branimir Brstina, Dragana Varagic, Marko Nikolic, Velimir 'Bata' Zivojinovic, Dragan Zaric, Vladan Zivkovic, Ljuba Tadic.
49. "SHTËPIA PRANË HEKURUDHËS" (KUCA PORED PRUGE) - (1988)
 Regjisor: Zarko Dragojevic
 Skenarist: Zarko Dragojevic
 Në rolet kryesore: Ljubisa Samardzic, Slobodan Bestic, Andjelka Milivojevic, Faruk Begolli, Dusica Zegarac, Zaim Muzaferija, Meto Jovanovski, Dubravko Jovanovic, Vasja Stankovic.
50. "NATA NË SHTËPINË E NËNËS TIME" (NOC U KUCI MOJE MAJKE) - (1991)
 Regjisor: Zarko Dragojevic
 Skenarist: Zarko Dragojevic
 Në rolet kryesore: Radoslav Andjic, Stole Arandjelovic, Faruk Begolli, Snezana Arunovic, Olja Beckovic, Ivan Bekjarev

51. "OPERACIONI CARTIER" (OPERACIJA CARTIER) - (1991)
 Regjisor: Miran Zupanič
 Skenarist: Miha Mazzini
 Në rolet kryesore: Borut Veselko, Faruk Begoli, Haris Burina, Srečo Špič, Judita Zidar, Brane Grubar, Ratko Polič.
52. "BULEVARDI I REVOLUCIONIT" (BULEVAR REVOLUCIJE) - (1992)
 Regjisor: Vladimir Blazevski
 Skenarist: Vladimir Blazevski
 Në rolet kryesore: Bojana Maljevic, Branislav Lecic, Miralem Zupcevic, Miroљjub Leso, Olivera Markovic, Dusan Janicijevic, Anita Mancic, Dragan Petrovic, Uliks Fehmiu, Marija Savatic, Faruk Begolli, Haris Burina, Kapitalina Eric, Enver Petrovci.
53. "DASHURIA E BJESHKËVE TË NEMUNA" - (1997)
 Regjisor: Ekrem Kryeziu
 Skenarist: Ekrem Kryeziu
 Në rolet kryesore: Faruk Begolli, Diellza Kolgeci, Donat Qosja, Adhurim Demi.
54. "FOTOGRAFIA" - (2003)
 Regjisor: Jeton Ahmetaj
 Skenarist: Jeton Neziraj
 Në rolet kryesore: Faruk Begolli, Blerim Krasniqi dhe Emine Toska.
55. "METROPOLET" - (2005)
 Regjisor: Sunaj Raça
 Skenarist: Zymber Kelmendi
 Në rolet kryesore: Blerim Destani, Sunaj Raça, Faruk Begolli, Blerina Binaku, Faik Gashi, Isa Kurtishaj, Ardita Lala, Basri Lushtaku.
56. "Etjet e Kosovës" - (2006)
 Regjisor: Sunaj Raça
 Skenarist: Sunaj Raça, Vath Koreshi
 Në rolet kryesore: Rajmonda Bulku, Blerim Destani, Faruk Begolli, Meto Jovanovski, Bislim Muçaj, Sheqerie Buqaj, Tinka Kurti, Basri Lushtaku, Ermela Teli.

BURIMET E LITERATURËS DHE INTERVISTAT

Për shkrimin e këtij libri mbi jetën dhe krijimtarinë e Faruk Begollit janë intervistuar artistë dhe bashkëpuntor të ndryshëm të tij, si: Isë Qosja, Fadil Hysaj, Melihate Qena, Kumrie Hoxha, Armond Morina, Shkëlzen Maliqi dhe Enver Petrovci.

Janë shfrytëzuar edhe shumë gazeta, revista (vitesh të ndryshme) e faqe interneti, ndër to:

Ars Poetica (një intervistë e Nebi Islamit me Faruk Begollin, e cila ka qenë shumë e vlefshme sidomos për shkrimin e kaptinës mbi fëmijërinë e Faruk Begollit),

Dodona – 1992 – 2002 (Jeton Neziraj, Shkelzen Maliqi),

Rilindja, Koha Ditore, Lajm, Zëri, Zëri Javor, Teuta, Express, Nada, Bota e re, Ekspres, Novosti, Oslobodenje, Bilten-Pula, Politika, Dnevnik, Tv Revija, Tv Novosti, Svijet, Zdravo etj.

Radio Evropa e Lirë (Dy intervista: Branka Mihajloviq- 29.10.2005 dhe Bekim Lumi - 02.02.2004)

The Internet Movie Database – IMDb.

inTegra



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

KOHA




BONITA[®]